

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga tre muaj - Trimestrale della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Spedizione in A.P. - TAXE PERÇUE - art. 2 comma 20/c - L.662/96, Aut. n. DCO/DC/CS/101/2003, valida dal 06/03/03

Përmbajtja / Sommario

RËNIA DHE RI-STISJA E NJI KATUNDI ARBËRESH

Carmine Stamile (*Katundi i Kajvericit qe bën i ri / Kajverici i ri*) faqe 2

KRYEARTIKULLI

Drejtori (*Arbëreshët dhe Bashkimi i Italisë*) faqe 3

KA 150 VJET TALLJA U BASHKUA

Kostandin Bellushi (*Arbëreshët e Pllatanjotët për Njësinë e Talljas*) faqe 4/7

Nando Elmo (*Garibaldini Rrafell De Marco ka Ungra*) faqe 5

Giudice papa Janni (*Njosi artidjanale*) faqe 6/7

Giuseppe Chiaffitelli (*Lluixhi e Ruzari Giura*) faqe 8

Nicola Alfano (*Tetëmbëdhjetët ka Shën Pali*) faqe 8

Lucia Cardamone (*Itallja thonë se është një*) faqe 9

KORRESPONDENCA NGA KATUNDET ARBËRESHË

Maria Lucia motër e vogël (*Kujtim i motrës së vogël Maria Delfina*) faqe 10

Daniela Moccia (*Pë sindëkun e Shën Benedhitit*) faqe 10

Maria Assunta Fazzano (*Dita Gjuhs mëms ta gjithë shkui*) faqe 11

Mario Massaro (*Një rrugë e një pistë*) faqe 12

Kostandin Bellushi (*K'shtu a fjasmi na Shin Vasil*) faqe 12

Moti Madh/Mario Giuseppe Miracco (*Moti zbulon z dramet*) faqe 13

TEKSTE POPULLORË/SHKOLLORË, ZAKONE NGA KATUNDET ARBËRESHË

Giuseppe Chiaffitelli (*Të ngrënë e njëhershëm*) faqe 13/32

Anita Markut (*Kënka Djepe*) faqe 14

Mariateresa Coraggio (*Karravali*) faqe 14

Zef Beccia (*Kuruljat*) faqe 14

Giuseppina Demetra Schirò (*Tekste nga një Skollë Arbëreshe*) faqe 15

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

protopapas Emanuele Giordano (*Epistollari Arbëresh*) faqe 16-17

POEZI ARBËRESHE

Marg Scilippa, Giuseppe Gallo, Tommaso Campera faqe 17

POEZI SHQIPE

Nebih Bunjaku, Zhaneta Ogranaja Habazaj, Jusuf Zenunaj, Bajame Hoxha Çeliku faqe 18

STUDIME / RECENSIONE / ARTIKUJ / TEKSTE MBI BOTËN ARBËRESHE

Imri Badallaj (*Pikëpamjet e Kolë Kamsit mbi Italo-Arbëreshët dhe gjuhën e tyre*) faqe 19

Alisa Velaj (*Mes imazheve dhe mirazheve në poezinë eliptike të Buzëdhelprit*) faqe 20

Laura Smaqi (*Mjegulla, si pjesë e imazhit poetik i Vorea Ujkos*) faqe 21/31

David Young (*Vangjeli i pjerrë arbërisht*) faqe 22

Klara Kodra (*Poetika e Kate Xukaros*) faqe 23

Florika Bushi (*De Rada në rreshtat e një novele*) faqe 24

Hamit Xhaferi (*Zef Skirò Di Maxho, individualitet dhe krijues i fuqishëm*) faqe 25

Denisa Tare (*Françesko Krispi ishte shqiptar i cilësuar*) faqe 26-27

STUDIME / RECENSIONE / ARTIKUJ / TEKSTE MBI BOTËN SHQIPTARE

dom Nikë Ukgjini (*Fishta në dokumente të panjohura*) faqe 28

Kolec Topalli/Gjovalin Shkurtaj (*Konferenca e Ale-së*) faqe 29

Zymer Neziri (*Epika gojore shqiptare*) faqe 30

LIBRE e REVISTA faqe 31

Agostino Giordano (*Bibliografi Arbëreshe - 1*) faqe 31

JO VET ARBËRISHT

Pierfranco Bruni (*Albanesi, Italo-Albanesi e Regno di Napoli*) faqe 32

Katundi i Kajvericit qe bën i ri

Carmine Stamile

ka Shën Japku (Cs)

Thomse shumë gjindë nëng e kanë besë, po Kajvericin e bën të ri. Çë kur Kajverici u franar, shkuan pesë vjet, po nikoqirja publik mbajti besën e katundin e bëri. 264 shpi janë të sosura e krietari i Bashkisë të Qanës, arkiteti Giuseppe Rizzo, është e i jep qiçet pronarevet. Më dimbëdhjetë nga muaji i Fjovarit, u kam qënë ndë Kajvericin e ri, pse mora pjesë te manifestimi kur krietari i dha qiçet e shpisë mikut Bernardo Lento, i cili më kish mbituar sa të venja. Miku Bernardo bëri një festë vurtet e madhe, ku ishin shumë gjëri e miq. Ndë këtë manifestacion mund pe me sit e tim se katundin e bën e banorët mund zënë të venë tek shpitë e tire.

Kajvericin e ri e bënë një cik më posht se Qana, e kundrela të vjetrit, ku edhe duken shpitë të sholarne. Katundi i ri është shumë i bukur: shpitë janë gjithë të bardha e shumë shpi kanë edhe një tap lulisht përpara derës. Udhët janë të gjera, ku mund ngitet me makina. Mangon Qisha, po vendi ku ka të bëhet është, e, sa furnoin shpitë, bëin edhe Qishën. Shpia e mikut Bernardo nëng është shumë e madhe, po nëng i mangon faregjë. Sa hin, është qëndrimi, kuçina e banji, e përsipra janë katër kamera sa të fjen. Diert e dritaret janë druri, e ndë dritare janë di vitrine.

Kajvericjotët janë shumë të lumtë sa të venë tek shpitë të rea e hiripsin me gjithë zëmër istitucionat çë i bënë katundin e ri.

IL PAESE DI CAVALLERIZZO E' STATO RICOSTRUITO

Forse molti non ci credono, ma il paese di Cavallerizzo è stato ricostruito. Dal giorno della frana che ha fatto crollare diverse case, sono passati cinque anni, ma l'amministrazione pubblica ha mantenuto la promessa e il paese è stato interamente ricostruito. 264 appartamenti sono già pronti e il Sindaco del Comune di Cerzeto, arch. Giuseppe Rizzo, sta consegnando le chiavi ai proprietari. Giorno 12 del mese di febbraio, io sono stato a Cavallerizzo per partecipare alla cerimonia della consegna delle chiavi all'amico Bernardo Lento, che mi aveva invitato. Per l'occasione l'amico Bernardo ha organizzato una grande festa alla quale hanno partecipato molti amici e parenti. Durante questa cerimonia ho potuto vedere con i miei occhi che il paese è stato realmente ricostruito e gli abitanti possono cominciare ad andare a vivere nelle nuove case.

Il nuovo paese di Cavallerizzo è stato ricostruito sotto Cerzeto, di fronte al vecchio paese diroccato. Il nuovo paese è molto bello: le case sono tutte bianche e molte hanno anche un piccolo giardino davanti la porta. Le vie sono larghe e possono essere percorse con la macchina. Manca la Chiesa, ma il posto dove deve sorgere è stato già stabilito, e, appena le maestranze avranno ultimato le case, incominciano a costruirla. La casa dell'amico Bernardo non è molto grande, ma non le manca niente. Appena si entra, al pianoterra, c'è il soggiorno, la cucina e il bagno, e al piano di sopra ci sono quattro stanze da letto. Le porte sono di legno massiccio e le finestre hanno il doppio vetro. Gli abitanti di Cavallerizzo sono felici di andare a vivere nelle nuove case e ringraziano con tutto il cuore le istituzioni che le hanno costruite.

Kajverici i ri

Sa është i bukur, sa është i hjesur ki katund i ri, i tërë i veshur; puntorët gjithë shpitë janë e furnoin e presin gjindjen sa të venë t'e banoin.

Krietari Qanës me fashë ndë gjii qiçet i jep me shumë hajdhii e banorëvet i thot me gaz ndë gojë: "Gëzohij, moti i lig per ju shkoi".

Katundi i ri banorët pret ku mund mbidhen pameta vurtetë, si qenë një herë gjithë bashkë e mosnjari më ka të rrier jashtë.

Shpit të rea janë vurtetë te bukura e nëng janë mëngu shumë të ngutura; edhe udhët janë të gjata e të gjera e nëng i sholarën më no shiu e no era.

Shpive nëng i mangon faregjë: kanë gasin, lletrikun edhe më gjë; diert janë druri e dritësoret me di vitrin sa të mos të i bënë shumë tëtim.

Vetë qisha ndë qacë nani mangon por kjo bëhet e shumë mot nëng shkon; edhe Shën Gjergji ka të vinj ndë katund sa të bekonj banorët çë ndë krie njera ndë fund.

Carmine Stamile

BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE

protopapas Emanuele Giordano:

<i>Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230</i>	€ 10
<i>Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160</i>	€ 10
<i>Himne Bixantinë – 2005 – ff. 217</i>	€ 10
<i>Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.)</i>	€ 10
<i>Fjalor (Dizionario Arbëresh-Italiano / Italiano-Arbëresh) - edic. 2000 - ff. 715</i>	€ 30
<i>Shpata e Skanderbekut di B.Bilotta – 1967 - ff. 217</i>	€ 15
<i>Folklore albanese in Italia (1957) (fotok.)</i>	€ 10

Jeta Arbëreshe:

<i>(nëndë vjet: 2002-2010) € 400; për Institucionet</i>	€ 600
<i>Pajtim vjetor (abbon. annuale) € 30; për Institucionet</i>	€ 60

Jeta Arbëreshe (abonim)

+

Fjalor i Arbëreshëvet t'Italisë

i Emanuele Giordano - s

Euro 50

Arbëreshët dhe Bashkimi i Italisë

Italia, te ky vit, feston 150vjetorin e Bashkimit të saj. Arbëreshët zunë e erdhëtin te ky dhë te shek.XV, pesë shekul e gjimës prapë, kur Italia ish adhë e ndajtur. Thërritej Itali, gjeografikisht, po nëng kish njësi politike. Arbëreshët vunë rrënjë ndë Mjездitë, te Rregjëria e Napolit, ku zotërojnë Aragonезtë, miqtë e Skanderbekut.

Sa bënë Arbëreshët për vetëhenë e tyre? Nderuan historinë e tyre, Mëmëdheun ka vijin, Fatosin e math Gjergj Skanderbekun; nëng i lejuan mosnjeriu t'i shajin o t'i turpërojin; i trashëguan bilvet gjuhë e kujtesë historike, rit bixantin e zakone. Rruan me nderë te Dheu i Huaj, ture u hapur daledalë gjitonvet lëtinj. Zunë e krijuan një Letërsi arbëreshe. Me motin patëtin Istitucjone Qishtarë e Kulturorë. Luftuan me duar e me fjalë për të drejtat e tyre.

Sa bënë Arbëreshët për Italinë? Ripopulluan vende të shkretë o të shkatërruar ka lufta e ka tërmete o ka kolera. Zotëruan shpatën, shërbyen dhera, kullotëtin dhen. Rruan të lirë, sepse Skanderbeku ashtu i kish mbësuar. E lirinë, demokracinë e pavarësinë ja mbësuan edhe Italianëvet: në çdo luftë, më parë e më pëstaj se Garibaldi, derdhëtin gjakun e tyre për Italinë. I dhanë burra të urtë Italisë, në çdo Istitucionë: politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, qishtarë. Tek Parlamenti italian, çë ka viti 1861 njera sot, hyjtin dhjetra deputete e senatorë arbëreshë: dica qenë nënsegretarë e ministra, një qe kryeministër. "Krahu e mendjen" i dhanë Arbëreshët Italisë. Sa bëri, e bën, Italia për Arbëreshët? Pak, për sa patë ka Arbëreshët. Vetëm "jetrën ditë", Pakicavet të saja etno-gjuhësore Italia i dhuroi Llexhën 482/99 dhe të tjera Llexha Krahinore. Po Llexha 482 si punon? Ndër shkollat e katundevet arbëreshë jipet vërtet mësim i gjuhës arbëreshe? (Sportellistët arbëreshë si shkruajën? E kush i formon mësuesit dhe sportellistët? E kush kontrollon Formuesin?). Llexhat Krahinore si e ruajën gjuhën arbëreshe? Sa vlejën Shoqatat kulturore dhe Revistat arbëreshe për këto Llexha? Sa turesë i jipen atyre për mos të vdesen?

150vjetori i Bashkimit të Italisë ka të jetë një pikë nisjeje ndër raportet Itali-Arbëri. Arbëreshët janë Italianë, po edhe Arbëreshë. Nëng duan të rrojnë ndër "rezerva indiane", po të trajtuar si gjithë, e të nderuar. Gjaku e tyre e derthtin për Italinë, po gjuhën e kulturën e tyre s' duan t'i bjerën. S' duan t'i shesën. Rrënjët e tyre arbëreshe s' i ndërrojnë me faregjë. Pas pesë shekul e gjimës, shembulli i tyre qëndron Skanderbeku. Gjuha e tyre, dje, shpata. Shpata e tyre, sot, gjuha.

150vjetori i Bashkimit të Italisë ka të jetë një moment meditim. Arbëreshët qenë mjeshtra liriye, demokracije dhe pavarësiye për Italianët: nëng meritojnë ka ata, sot, mësimë shkllavëriye. Pështuan ka Dheu i tyre për mos t'ishin shkllavë të Turqvet.

Pesë shekul e gjimës s' janë pak për mosnjeri, aq më shumë për një Pakicë etno-gjuhesore çë rron jashtë Mëmëdheut të tij me fuqinë e kujtesës. Me kujtesën e Skanderbekut.

Kush e di ndëse, tek 200vjetori i Bashkimit të Italisë, Arbëreshët do të jenë të gjallë e të zgjuar si sot! O mos do të jenë personaxhe të njëi Rapsodije...

Drejtori

GLI ARBËRESHË E L'UNITA' D'ITALIA - L'Italia quest'anno festeggia il 150° della sua Unità. Gli Arbëreshë cominciarono ad arrivare in questa terra nel sec.XV, cinque secoli e mezzo addietro, quando l'Italia era ancora divisa. Si chiamava Italia, geograficamente, ma non aveva unità politica. Gli Arbëreshë misero radici nel Mezzogiorno, nel regno di Napoli, dove signoreggiavano gli Aragonesi, amici di Skanderbeg.

Quanto fecero gli Arbëreshë per sé? Onorarono la propria storia, la Patria da dove venivano, il grande Eroe Giorgio Skanderbeg; non permisero a nessuno di offenderli o disonorarli; trasmisero ai figli lingua e ricordo storico, rito bizantino e tradizioni. Vissero con dignità in Terra Straniera, aprendosi lentamente ai vicini italiani. Cominciarono a creare una Letteratura arbëreshe. Nel tempo ebbero Istituzioni Religiose e Culturali. Lottarono con le mani e con la parola per i loro diritti.

Quanto fecero gli Arbëreshë per l'Italia? Ripopolarono zone disabitate o distrutte da guerre, terremoti o colera. Usarono la spada, lavorarono terre, pascolarono armenti. Vissero liberi, perché Skanderbeg così aveva loro insegnato. E la libertà, la democrazia e l'indipendenza gliela insegnarono anche agli Italiani: in ogni guerra, prima e dopo Garibaldi, hanno versato il loro sangue per l'Italia. Hanno dato uomini illustri all'Italia, in ogni Istituzione: politica, economica, sociale, culturale, religiosa. Nel Parlamento Italiano, dal 1861 ad oggi, sono entrate decine di deputati e senatori arbëreshe: alcuni furono sottosegretari e ministri, uno fu presidente del consiglio. "Il braccio e la mente" hanno dato gli Arbëreshë all'Italia.

Quanto ha fatto, e fa, l'Italia per gli Arbëreshë? Poco, rispetto a quanto ha avuto dagli Arbëreshë. Solo "l'altro giorno", alle sue Minoranze etno-linguistiche ha regalato la Legge 482/99 e altre Leggi Regionali. Ma la Legge 482 come funziona? Nelle scuole dei paesi arbëreshë si insegna veramente la lingua arbëreshe? (Gli Sportellisti arbëreshë come scrivono? E chi li forma gli insegnanti e gli sportellisti arbëreshë? E chi controlla il Formatore?). Le Leggi Regionali come salvaguardano la lingua arbëreshe? Quanto valgono le Associazioni culturali e le riviste arbëreshe per queste Leggi? Quanti soldi gli si danno per non farle morire?

Il 150° dell'Unità d'Italia dev'essere un punto di partenza nei rapporti fra Italia e Arbëria. Gli Arbëreshë sono Italiani, ma anche Arbëreshë. Non vogliono vivere nelle "riserve indiane", ma trattati come tutti, e onorati. Il loro sangue l'hanno versato per l'Italia, ma la lingua e la loro cultura non le vogliono perdere. Non vogliono venderle. Le loro radici arbëreshe non le scambiano con niente. Dopo cinque secoli e mezzo, il loro esempio resta Skanderbeg. La loro lingua, ieri, la spada. La loro spada, oggi, la lingua.

Il 150° dell'Unità d'Italia dev'essere un momento di meditazione. Gli Arbëreshë sono stati maestri di libertà per gli Italiani: non meritano da loro, oggi, insegnamenti di schiavitù. Fuggirono dalla loro Patria per non essere schiavi dei Turchi.

Cinque secoli e mezzo non sono pochi per nessuno, tanto più per una Minoranza etno-linguistica che vive fuori dalla propria antica Patria con la forza della memoria. Con la memoria di Skanderbeg.

Chissà se, al 200° Anniversario dell'Unità d'Italia, gli Arbëreshë saranno vivi e svegli come oggi! O non saranno, invece, personaggi di una Rapsodia...

Arbëreshët dhe Pllatanjtët për njësinë e Talljas

Kostandin Bellushi, malsjoti

ka Pllatëni (Cs)

Zun, ndërper gjithë Talljas, kujtimat për Risorxhimentin talljan, doç sivjet bia qindinepesëdhjetëvjetori ç' kur u bë Njësia e Talljas (1861-2011) e për nganjë nesh është një drejtë a mirë dhe a madh t' kujtojmi dhe t' nderojmi gjithë atë atëdhetarë ç' me shpirtmadh dhe me mall prej Atdheun, lën/vran jetan e tira për t' bëhi një Tallje a bashkuar, a lir dhe pa t' huajin, ç'kur u nis a para luftë e vitit 1844, ajo e vitit 1847 (me kriangrajturit kallabriz dhe me nënshtipurit ç' kle) dhe me Tundjat luftar e vitit 1848 (ndër njëzetënend të vitit 1848 rregji borbon Ferdinand i dit, nën t' shtipurit e kundat ç' u bën, kle i shtrënguar t' jip Kostitucjona dhe psana ndër tetëmbëdhjetë të falvarit muar ben mbal asaj) njera ka viti 1861. Ndër atë ishan shumë Arbëreshë të katundvat tanë: ka Çifti, Purçilli, Ferma, Firmoza, Frasnita, Kastërnxhi, Maqi, Mbuzati, Picilia, Qana, Spixana, Strigari, Shën Benedhiti Ullan, Shën Martiri, Shën Mitri, Shën Sofia, Shën Vasili, Ungra, Vakarici, ka katundat arbëreshe t' Siçilljas dhe ka gjithë tjerat katunda arbëreshe (ç' erdhtin ka rregjëria e Napulit ka sekulli pesëmbëdhjetë andi ka Shqipëria dhe ka Grecia (Arvanitra), më shumë ka Pelloponesi (Morëa) dhe ka Atika, dhe klian mirëpritur ka rregjërët dhe ka Papa t' ahiarthin), ç' dhan t' madhin kontribut e tira për Atdheun, me jetan e tira. Po atë nëng jan shumë t' njohur psë, mëkeq, nëng jan mbrenda ka storia madha sepse jan vetam ka "storia vokarr" e ashtu s' bëjan nutixja; me gjithë atë, jan "storiat e vokrra të llokat" ç' i dhën jetë "storias s' madh" sepse shumë ndër atë u bashkuan t' madhin ushtërin e Garibaldit për t' mirrjan pjesë ka Nisja e Milvat dhe ki, plot me mirënjohja, i thritti "lliunra ndër luft" sepse a dij mirë se sa zëmëfort ish shpirti i Arbëreshëvevet. Atë klian çdoherë afër "Eroit i di jetëve" njera ka lufta e Voltturnit, ndër një dhe ndër di t' shën Mitrit, kumanduar ka kollonelli Mink Damis ja Ungrës, tue bënur sharbisa ç' vlejjan. Ahiarthin Garibaldi i tha Kollonellit: "Damis, Arbëreshët e tënd jan si lliunra!".

Shumë ndër atë ishan t'urta dhe kishan p'nxira t'lira dhe t' ngrëjtura (risorxhimentallra). U kishan mësuar aq ka Kulexhi "Corsini" i Shën Benedhiti Ullan, i stisur ndër njëmbëdhjetë t' shën Mitrit 1732, se ka Kulexhi Itall-Grek

(ec te faqja 7)

IL CONTRIBUTO DEGLI ARBÈRESHÈ E DEI PLATACESI ALL' UNITÀ D'ITALIA - Sono già iniziati, in ogni ambito e luogo d'Italia, le celebrazioni sul Risorgimento Italiano, dato che quest'anno ricorre il 150° Anniversario dell'Unità d'Italia (1861-2011), e per ognuno di noi è doveroso ricordare ed onorare tutti quei patrioti italiani che, con generosità e amor patrio, sacrificarono la loro vita per creare un'Italia unita, libera ed indipendente a partire dai fermenti irredentisti del 1844, del 1847 (con l'insurrezione calabrese e la repressione che ne seguì) e dei Moti rivoluzionari del 1848 (Prima Guerra d'Indipendenza: il 29 gennaio 1848 il re Ferdinando II di Borbone, sotto la pressione degli avvenimenti, fu costretto a concedere la Costituzione, giurandola poi solennemente il 10 febbraio successivo), fino al 1861. Tra di essi c'erano anche tanti volontari Italo-Albanesi delle nostre piccole Comunità Arbëreshe: Acquafornosa, Castrolibero, Cerzeto, Civita, Eianina, Firmo, Frascineto, Lungro, Macchia Alb.se, Plataci, San Basile, San Benedetto Ullano, San Cosmo Alb.se, San Demetrio Corone, San Giorgio Alb.se, San Martino di Finita, Santa Caterina Alb.se, Santa Sofia d' Epiro, Spezzano Alb.se, Vaccarizzo Alb.se, dei paesi arbëreshë della Sicilia e di tutti gli altri paesi arbëreshë (giunti nel Regno di Napoli nel XV sec., provenienti da tutta l' Albania e da varie regioni della Grecia (greco-albanesi), in particolare dal Peloponneso (Morëa) e dall' Attica, ed accolti benevolmente dai Sovrani e dal Papa dell'epoca), che hanno dato il loro grande e prezioso contributo patriottico, con l'alto sacrificio della loro vita. Essi non sono conosciuti da tutti perché, purtroppo, non vengono menzionati nella storia ufficiale in quanto appartengono alla cosiddetta "microstoria" e quindi non fanno notizia; eppure, sono proprio le "piccole storie locali" che hanno generato la "grande storia", anche perché molti di essi si allearono ad incrementare l'esercito di Garibaldi per partecipare alla leggendaria Spedizione dei Mille; e questi, pieno di ammirazione, li definì "leoni in battaglia" perché ben sapeva quanto fosse ardimentoso l'animo patriottico degli Arbëreshë. Essi furono sempre al fianco dell' "Eroe dei due mondi" fino alla battaglia del Volturno, l'1 e il 2 ottobre del 1860, comandati dal colonnello Domenico Damis di Lungro, compiendo azioni di valore. Fu, infatti, allora che Garibaldi, colmo di orgoglio,

Jeta



Trimestrale di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Arbëreshe

Revistë tremujore e Shoqatës Kulturore "Jeta Arbëreshe", Purçill/Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: Agostino Giordano
Drejtori, Redaksi dhe Administratë / Direzione, Redazione, Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)
 Tel. 0981-32539 / 340-8452364; e-mail: jetarbreshe@libero.it – <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Shërbim grafik / Lavoro grafico: Antonio Giordano
Ku shtypet / Stampa: AGM srl, Telefax 0981-483001 – e-mail: info@agm.calabria.it

Abonime / Abbonamenti: (4 numeri): Italia €30 (Institucjona €60), Europa e America €40

Ku dërgohen turresët / Versamenti: sul ccp. n.12994760, intestato a: Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina/Purçill (Cs)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografji, edhe ndëse s' botohen, nëng jipen prapë /Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtorja nëng është përgjegjëse për përmbajtjen e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Garibaldi Rrafelli De Marco ka Ungra

Tatëmadhi im, Çesarini De Marko i Rraçapës, herë e herë, kur më vrenej të helmuar, vej ture më thën:

–“Ty këtë çerë e vrëjtur e ke marr ka ati im Rrafelli i cili ishë i njohur më shpi si “i vrëjturi”. Po ai kish ligjë t’ishë i vrëjtur. Ti çë ke? Të hëngri bukën gadhuri? Ose bie e vërtetë se, si thuhet, ju Elmo e kini tek kazati fatën tuaj? E di ka vjen Elmo? ka shqipi Helm, Helmi; për këtë ju Elmo jini të helmuar”.

Ish’e rronja ahirna një djalëri pa lumësi, për të ndryshme akunde, dashurije, skollëje, e papërshtatmje e padurimi për ngajë, e pandefja se edhe stërtatëmadhi do të kishë pasur, mund t’jet, helmet tim. Po një ditë çë kisha ritratin e tij ndër duar, ndërsa vrenja atë fytyre serjoze e e rreptë, i lipa tatëmadh Çesarinit:

–“Pse ati i strisate ishë kështu i vrëjtur?”.

E tatëmadh Çesarini zu fill:

–“Ati im Rrafelli çë kur ishë i vogël batonej ket pëllas’i Damësravet, të cillët ishin t’urtë, karbunelë e mazunra. Gjegjënej fjalimet e tyre mbë Italinë e re, pa rregje e pa Papë, të cilët vaxhdojin e prisjin kryet o varjin o shkuptetjasin atë çë dojin lirin’ e mendimit e e ndërgjegjes e edhe lirin’ e popujvet e sidomos republiken e demokratinë. Gjegji te ai pëllas ëmërin e Mazzini-t e të Garibaldi-t. E u dhezë i magjepsur për mësimet e turve, sidomos të Mazzini-t. Kështu kur kle hera, gjashtmbëdhjetvjeçar, u nisë si fjamur me pesqindët ka Ungra çë dojt’ të lirojin Italinë ka rregjet e ka Papa. Këndoj edhe ai “Addio mia bella addio” e “La bella Gigogin”, xu “Va pensiero” e gjithë këndimet ç’i ngrohjin zëmërin atyrve zëmërorë çë ëndërrin “Lirin” me “Rivolucionin” përposh mbrojtjen e Hyjnitvet Mazzini e Garibaldi.

Rrafelli, gjatë një luftim ndër malet e Basilikatës, patë, pra, fatin e mir t’i shtringonej Garibaldi dorin e t’i kariconej kalin e bardh. I marrë ka entusiasmi thërriti: “Generale, la repubblica. Viva Mazzini, viva la liberta, viva il popolo”. Gjenerali i çudijtur i buzqeshi pa kujdhes, ndërsa cingërdhisnej kalin e spavej ndëmost këmishat të kuqe, sikur se do të fshehej

i ngarë ka fjalët e atij trimi ç’i mbajin mend një premëtim të kujit ngë kish si t’i mbanej benë. Një klogjer frangjiskan ka Murana, ture e shtitur ndënjane, u nxitua t’i thoj: “A Repubblica? Raffe”, urre avimu àutru a chi pinsà”.

Rrafelli luftoj me pesqindët ungrinjotra me zëmërim, sidomos mbë Volturnit e kur xu se rregji i Napulit kish ikur Gaetë ngrëjti fjamurin me tri ngjyret ture thërritur: “Romë. Nani Romë, ungrënjotra, vem’e përzëmi Papën ka Roma, rroft republika, rrofshin popujët të lirë”.

Ngë pandefnej akoma se kush do rivolucionin është e gaton humbjen e vetëhesë së tij, pse shkuar rivolucjona është i gatuar tash njetër pushtet, jo më i mir e jo më pak i egër e cinik se ai kundër të cilit ë e lufton. E xu kur Tean pa Garibaldi ç’i shtringonej dorin rregjit Vitor e e thërrit: Re d’Italia. I ran të veshurat Rrafellit e i ra magjepsia e Garibaldi: e sesi një Itali pa rregje, si thoj Mazzini? e ki Vitor kush është? Ng’është një rregjë? Ç’është kjo lozje e Garibaldi? Do të shosh se do të gjëndemi pupani edhe përposh Papës? Damësrat i spjeguan se nëng ndëlgonej “la politica e, soprattutto, le opportunità politiche”. Ja spjeguan litish, edhe pse ata si gallandomëra ç’ishin arbërishtjen pak e flisjin: “La politica ha le sue ragioni, che tu non puoi capire. Më mir se, dita sot, ty prire Ungir”.

E u pruar Ungir Rrafelli e nga dita, gjat vitrat e gjelles së tij, i vrëjtur, i pienej vetëhesë ket mbrëndja e ndërgjegjes: “Çë na dha Vitori çë ngë kishim me Ferdinandrat e me Frangjiskrat? Populli është ngamon i vapëk e i ngratë. Gallandomërat jan te pëlleset më frymëdhenj se ngamon. Populli malpaton e është rop’i gallandomëravet si përposh Borbonëravet. Përkundra, me këtë diskursë e brigandravet, Vitori

Nando Elmo
ka Firmoza (Cs)

është e e na bën më të vdekur uri se mënjehere...

Kur xu se një arbëresh si Krispi i kish bën “ipopodhi”, si thoj, ose skanieli i këmbëvet, i Lartësivet e tyre, Margarita e Umberti, e persekutonej punëtort, vu rrethë xerkut një skolë, e zezë si të veshurat, sikur t’ishë më lip e ngë deshë të dinej më as Garibaldi, as mazunet, të cilëvet ai ishë “il Gran Maestro”.

Vej ture thën: “Atdeu ynë e muar ndë llunjët par se të lefej. E njera sa është një çë kumandon, Liria, Populli, Dimokratia, jan fjalët të sëmurta, të mira vet për ata çë mastrojin e farmakosjin po puajt. E politika është mbledhja e intereseve të shemëtuamë mashkaratur jetërsimi”.

Tatëmadh Çesarini përfundoj rrëfyemen e tij: Ti çë studhjon, çë thua, kishë o s’kishë ligjë stërtatmadhi it? E pe çë bën pra Savojrat, më par, me të kotën Guerr’e madhe, e pra me gallandomrat e fashizmit? Ndose kishin pasur si, na kishin skriatur gjithëve me një guerrë sot e një menat. Ti bë si stërtatmadhi, rri llargu ka politika e ka shteti, mir njerën e të tjetrën si motin e lig, si breshërin, si borën, si një monostrof. Mos ju shit mos njeriu, sidomos atyrve çë duan të të magjepsjin me fjalë të mëdhë e të sëmurta e të kota, si thoj ati im, i vrëjturi. Ndose mundin, bë mir e harrë. Rro i fshefur, llargu ka gjithë, ture shkaptuar ngamon ka shumizat të farmakosura ka propaganda të njerit e të tjetrit. Gjegjë vet ndërgjegjen tënde. E shkaptë ka ndonjë pozicjon e sterët, sidomos ndose ka të sterksurit e shumisë.

(Nando Elmo ngë do as të përkthenj litisht shkrimet e tij arbëreshë as do se t’ja përkthejin të tjerët)

Djovasni
Jeta Arbëreshe

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Njosi artidjanale

Giudice papa Janni

ka Shën Kolli (Kr)

1) Jany italian, kombytar, vylàu i gjithyve, ty bardhyve e ty zhive!... Sott fjitet shumy kka “federalizhmi”. Kattane-i e Djoberiti, mypany ty vritejin vylezhyrit ndyr ata, ddejin kyta e dhe jetryt i kishin gegjur shyrbeset ngky kishin ardhur si kany ardhur. Thuhet edhé sot: “ E bony Italia, nani kety bohenjin talianyit!”. Edhé sott thuhet: “terroni e polentoni”, “Italia kka lla e Italia kka po”. Kyta se gjindiet ngky kany marr pjesy sa ty bohox njoisia. Shyrbesi vati te ddotar e massonyravet e borghezhravat ty ndzirryjin sinoret “comerciali”. Mezhdita pra o’ boony ngy “kolonie” e Nordit. Kyta ty folur muny ty vex gjaty: “piemontesizziona”, Gharibaldi, Verga, Bronty, Manes i dyrgkuer sa ty shuex ato çy vijin syrritur “brighantra, kusary?”. Fjalyt ty ngkretura e ty mbrazhta ngky na pyrkehjen; storia rryfihet si ka kjoony e gjo si ka kjoony mysuer nejr pakk vjety prapa.

2) Mezhdita gjehet kyshtu ppy ata çy kemi thoony e ppy stesnjn e bujaryt ty Mezhditys se shyrbeyin dherat ny manera estensiva (giatore) gjo intensiva ty bojin turrese me gruryt e vrejtin ty vejtin te kjaveria Romy; ngky vrejtin ty ngkrejin shataryt e dherat te moti i industrializazionys. Kush ddex ty ddix kka Mezhdita? Brighantyr, o kusaryt ty zzyllit, veçç kka ndonjo çç’ish dhony te mallet sa ty ikix kka shiptjet ty bujaravet ty likj, çy ngky kish sa ty hajin e ty mbax gjakun ty tix, ishin veta çy mbajin me Borbonyt çy kishin bony ty paren udhy hekuri, mypar se te gjithy jetrat vende (Napul-Portiçi, 1815).

3) Gharibaldi “haprifra”, pishottavet, ty urym kka bukky e kka dhe, sa t’i vejtin prapa e ty derdhyjin gjaku, i kish taksur dherat. Kkury pra ja kyrkuetin, pas çy te ngy tajur kish marh Siçighyjen, bori t’i shkrehy shataravet Bronty e t’i mbax pjesy Verghes çy trombex se i mirryjin dherat çy kish. Atix Gharibaldi i vex miry. Mosy Ingklesyt ngky kishin mbatur “flottin” e Borbonyravet llark te proi e Ghaetes, “i mille” ngky kishin roony ndonjy héry te gjo te Siçighja, gjo Napul.

4) Sa brighantra ka vrary Manes i dyrgkuer kka Torini! Sa veta ka diegkur ty ngjaghy te shpity e me bixt kka mbroda! sa katunde ty tory ka diegkur! Priftrat, veçç kka ndonjo, ngky kishin haré kka kio Italie e massonyravet e antikleralravet. Ata ndihyjin gjithy ty shkretyt. Pjaka e prifrit Mendicino kkuury kishin pruony e dhillur Shi’ Nikoh ty birin kupil, gjithy te ngy hery, te mn’ja çy shkrehyjin ty birin u vu ty syrrityx, ty kjax e ty shkullyx llesht: “Jany çy my vrasnjn tim biiry!”. Gjo njo vett ka kjoony vrar Karfizz, Shi Nikoh e te ato hory ndandizh... E pra ka bony nteru kyshtu njer kkuury ka rruer. Karfizz oshty ngy vend çy kjihet “Prifti” ppy kyty shyrbes, si thonjin. Ppy Italian pra kany llony shokjet, shpity, bixt, momat e dherat sa ty vejtin ty bohejin mish vuççerije te Italia e Nordit. Muny ty jety se ppy kyta shyrbese, ngky kuitohet shumy Gharibaldi. Po Karfizzi te vandili i maites oshty volia e tix çy te viti 1948 njer sott!

5) Gjuha jony? Arbyresht jany nteru ty paryt kkur kety bohenjin kriengkretje...Dhe Skanderbeg kety kish vrar gjithy ato çç’e shityjin, ish vjetur pa gjindie! “Timeo Danaos e dona ferentes!”, “Ab uno disce omnes!”. Shkruten Ghangakali: “Italia ka ngy dytir me arbyresht, me gjuhin e tire! Me piemontesidzazionen (burokradzia e dyrgkuer kka lla, mysuezhit, shkruetaryt, ecc.) ka shuer gjuhin t’atire, si pra ka boony Musughini e ndonjetyr te shkoghyt sott. Sott shpity e kyture horave jany ty mbrazhta, ngky kany ngy udhy hekuri e miry “lknjin mo fo’ musicet se trenet”, kany udhin e vdekies, ngky shyrbeyjin dherat; “Edhe shpresa e prasma xastyr ikin verrat!”. Po ngky birnjn shpresin, se politickantrat thonjin se ndyrroiny! Po stesnjn edhe arbyreshty pse hahenjin njeri me jetrin! Ty vjetenjin pakk pakk bishtrat!

UNITÀ ARTIGIANALE - 1) Sono italiano universale, fratello di tutti, dei bianchi e dei neri. Oggi si parla molto di federalismo. Cattaneo e Gioberti, prima che i fratelli si scannassero tra di loro, volevano questo e se gli altri li avessero ascoltati i fatti non sarebbero avvenuti come sono avvenuti. Ancor oggi si dice: “Fatta l’Italia bisogna fare gli italiani!”. Ancora oggi si parla di “terroni e polentoni”, dell’Italia del Nord e dell’Italia del Sud (del profondo Sud).. Ciò perché il popolo non ha preso parte all’unificazione. La cosa è andata nelle mani della massoneria e della borghesia per togliere i confini doganali. Il Mezzogiorno è diventato poi una colonia del Nord. Questo parlare ci porterebbe lontano: “piemontesizzazione”, Garibaldia, Verga, Bronte, Manes mandato a spegnere definitivamente quelli che venivano chiamati “briganti”. Le esaltazioni e le vuote parole non ci piacciono; dobbiamo raccontare la storia come è veramente avvenuta e non come è stata insegnata fino a pochi anni addietro.

2) Il Mezzogiorno si trova in tali condizioni per quanto abbiamo detto, ma anche per colpa dei signorotti del Mezzogiorno: lavoravano le terre in modo estensivo non intensivi, arricchendosi col grano, cercando di andare al governo a Roma; non si curavano di alzare la vita ai contadini e a coltivare la terra in maniera intensiva nel tempo dell’industrializzazione. Chi si interessava veramente del Mezzogiorno? I briganti, o i ladroni, all’infuori di qualcuno che si era dato alla montagna per sfuggire le oppressioni dei cattivi signorotti locali, che non avevano da mangiare e di sostenere la sua famiglia, erano persone che parteggiavano per i Borboni che avevano costruito la prima ferrovia (Napoli-Portici, 1815, prima di tutti gli altri).

3) Garibaldi “mangiapreti”, ai picciotti affamati di pane e d’itera, perché gli andassero dietro e spargessero il loro sangue, aveva promesso le terre. (Occorreva prima la riforma sociale, come diceva Mazzini). Quando poi gli chiesero le terre, dopo aver preso la Sicilia sopra un piatto, fece sparare ai contadini e proteggere le terre di Verga. A Bronte fece sparare ai contadini e ai picciotti. Verga, quando i contadini gli chiesero le sue terre, a Bronte, fece sparare sui contadini. Se gli inglesi non avessero bloccato la flotta borbonica al porto di Gaeta, i Mille non sarebbero mai giunti né in Sicilia né a Napoli (cfr. Montanelli).

4) Quanti briganti ha ucciso Manes inviato da Torino! Quante persone bruciate vive assieme alle case con dentro i loro figli! Quanti paesi completamente bruciati! I sacerdoti, all’infuori di qualcuno, non avevano piacere per questa Italia dei massoni e degli anticlericali. Loro aiutavano tutti i disgraziati. La vecchia madre del giovine prete Mendicino di Carfizzi, quando avevano portato il figlio a S. Nicola, all’improvviso si è messa ad urlare piangendo strappandosi i capelli dalla disperazione e dal dolore: “Mi stanno uccidendo il mio bambino!”. E poi ha fatto sempre così finché è vissuta. A Carfizzi poi, per tale fatto, c’è un luogo chiamato “il Prete”. Varie sono le persone trucidate in quel Carfizzi, a S. Nicola e nei paesi vicini! Per l’Italia poi hanno lasciato le mogli, i figli, le madri, la terra, per andare ad essere fatti carne da macello nell’Italia del Nord. Può darsi che per questi motivi non c’è una viva memoria di Garibaldi. A Carfizzi nella bandiera della sinistra c’è il suo volto dal lontano 1948 fino a tutt’oggi!

5) La nostra lingua? Gli albanesi sono sempre i primi nelle

(ec te jetra faqe)

Arbëreshët dhe Pllatanjotët për njësinë e Talljas

(vjen ka faqja 4)

"Shën Adrian" i Shën Mitrit, ç'u stis t'parin e marsit 1794, dhe ishan ndër njerzit më t' urta t' Kallabrias. Dhe Pllatëni, ka t'tijat, dha nj'kontribut giaku shumë i madh për Risorxhimentin dhe për Njësinë e Talljas, ç'kur ka "Alto Jonio" i Kusenxës zun Tundjat luftar t' lirisë t' vitit 1848, për t' nxirjan ka Tallja rregjin borbon Ferdinand i dit, me k'ta suldet: : Nicolantonio Marchese, Salvatore Ferdinando Trojano, Francesco Busicchio, Angelo Basile, Giacinto Bellusci, Giovanni Trojano Costa, Pietro Brunetti, Rocco Cartolano, Giovanni D' Agostino, Giovanni Dramissino, Pietro Stamato Fino, Angelo Brunetti, Giuseppe Dramissino, Giovanni Costa, Francesco D' Agostino, Nicola D' Agostino, Pietro D' Agostino dhe Giovanni Crisostomo Trojano, bir i nj' zot pllatanjot, Dhën Fangjisku, ç' bëni priftin Farnetë.

Ndër njëzetë t'gushtit 1860 njetar tredhjetëdi pllatanjotë hijtin ka Ushtria e Talljas e, pas ç' rregji i Talljas, Tor Manoli i dit, me dekretin e katërbëdhjetit të Shën Ndreut 1860, bën Ruajtjan Nacionalle, i ndihtin Nisjas s' Gariballdit. Ruajtja Nacionalle pllatanjota, ç' luftoni Borbonët dhe brigantët, ish a bër ka dimbëdhjetë ndarja me shtatëdhjetëeshtatë suldet, gjashtë serxhendra, dimbëdhjetë kapurel, nj' lluogotenent (Dhën Anxhulli Basile), di tenendra t' ditë (Dhën Viçenxi Bellusci dhe Dhën Kratisti Trojano), nj' serxhend mbashatur, nj' kapurall mbashatur dhe krei i suldetvat (Dhën Ferdinandi Troiano) ç' bëjan Këshillin e Drejtësisë, kish t' rujan pasdrejtësisë s' gjindjas dhe t'i jipjan kaçan brigandvat, ç' me t' ndihurit e katundarvat i jipjan fuqi rregjit borbon, Fangjisk i dit. Tek ai vit ish sink i katundit, dhe krei i Këshillit t' Njohjas s' Ruajtjas Nacionalle t' katundit Moisë Troiano.

Dhe i nipi t' zotit Pllatën, Dhën Anxhulli Basile (prifti gjëlit), ç'kuar pjesë Anapal ka Tundjat të vitit 1848 kundar Borbonvat, ka dhënia e Kostitucjon's dhe ka t' bënurit e Parllamendit napullitan, muar nj' pjesë a rënd ka Tundjat risorxhimentallra.

Tue mbillur k'tët stor' a vokarr, po mirë a shkruar, i dërgonj nj' lutje shpirttravet t'k'tira Arbëreshë, tue i uruar l'ken njohjan storika ç' i duhat dhe, atë, t'ken dhoksan t' drejt pas vdekjas si i duhat gjithëva martirat dhe trimat.

rivoltosi al condottiero albanese esclamò: « Damis, questi tuoi albanesi sono leoni! ».

Molti di costoro erano intellettuali ed avevano idee liberali e risorgimentali. Si erano formati sia nel Collegio "Corsini", eretto a San Benedetto Ullano l'11 ottobre del 1732, che nel Collegio Italo - Greco "Sant' Adriano" di San Demetrio Corone, eretto il 1° marzo 1794, e costituivano l' "intelligenza albanese" di Calabria.

Anche Plataci, nel suo piccolo, ha dato un rilevante e generoso tributo di sangue al Risorgimento Italiano e all'Unità d'Italia, a partire dal 1848 allorché nell' Alto Jonio Cosentino scoppiarono i Moti rivoluzionari liberali per scacciare il regnante Borbone, e vi partecipò con un gruppo di soldati volontari: Nicolantonio Marchese, Salvatore Ferdinando Trojano, Francesco Busicchio, Angelo Basile, Giacinto Bellusci, Giovanni Trojano Costa, Pietro Brunetti, Rocco Cartolano, Giovanni D' Agostino, Giovanni Dramissino, Pietro Stamato Fino, Angelo Brunetti, Giuseppe Dramissino, Giovanni Costa, Francesco D' Agostino, Nicola D' Agostino, Pietro D' Agostino e Giovanni Crisostomo Trojano, figlio del sac. platecese Don Francesco parroco di Farneta. Il 26 agosto 1860, inoltre, trentadue platecesi risultano volontariamente arruolati nell' Esercito d' Italia e, dopo che il re d'Italia, Vittorio Emanuele II, con decreto del 14 dicembre 1860, istituì la Guardia Nazionale, sostennero la spedizione di Garibaldi. La Guardia Nazionale platecese, che combatteva i Borboni ed i briganti, era costituita da 12 sezioni con 77 militi, 6 sergenti, 12 caporali, 1 luogotenente (D. Angelo Basile), 2 secondi tenenti (D. Vincenzo Bellusci e D. Cratisto Trojano), 1 sergente foriero, 1 caporale foriero e 1 capitano (D. Ferdinando Troiano) che formavano il Consiglio di Disciplina e avevano il compito di controllare l'ordine pubblico e quello di dare la caccia ai briganti che cercavano con l'aiuto dei contadini di dare forza a Francesco II di Borbone. In quell'anno era sindaco del paese e presidente del Consiglio di Ricognizione della locale Guardia Nazionale Moisë Trojano.

Anche il nipote del sac. Angelo Basile (prifti Gjëliti) di Plataci, che partecipò ai Moti del 1848 a Napoli contro i Borboni, alla promulgazione della Costituzione e alla formazione del Parlamento partenopeo, prese parte attiva ai Moti risorgimentali.

Terminando questa breve, ma dettagliata cronistoria, rivolgo una fervida preghiera alle anime di costoro, augurandomi che i nostri confratelli Arbëreshë ricevano il giusto riconoscimento storico e che, anch'essi, possano assurgere, dignitosamente, alla giusta gloria postuma che tutti i martiri e gli eroi meritano.

Njosi artidjanale

sollevazioni. Se Scanderbeg avesse dovuto uccidere tutti quelli che lo tradivano, sarebbe rimasto senza popolo! "Ho paura dei Danai e dei loro doni!" "Da uno conosci tutti!". Scive Gangale: "L'Italia ha un debito con gli Arbresh, con la nostra lingua!". Con la piemontesizzazione (burocrazia, insegnanti, segretari inviati dal Piemonte ecc.) ha spento la nostra lingua...; come ha fatto Mussolini e qualche altro responsabile nelle scuole oggi. Oggi le case sono vuote, non hanno una vera ferrovia, "corrono più veloci i moscerini che i treni", hanno la strada della morte, non lavorano le terre, "anche la speme ultima dea fugge i sepolcri!". Ma non perdono la speranza, perché i politicanti dicono che cambierà! Ma di tutto questo sono anche responsabili gli Arbresh perché ci mangiamo l'uno l'altro. Che rimangono almeno le code!

Jeta Arbëreshe

(9 vjet: 2002 - 2010)

68 numra, 1.216 faqe

Gjuhë, Kulturë e Lajme ka Arbëria
e ka Bota Shqiptare

400 euro

(për Institucionat, 600 euro)

Lluixhi e Ruzari Giura

Giuseppe Chiaffitelli

ka Mashqiti (Pz)

Lluixhi e Ruzari Giura klenë dy vëllezër që nderuan shumë Arbërinë.

Lluixhi u le Mashqit ta viti 1795, kle një nga të parët nxënës të skollës “Ponti e Strade” a kriuar Napul nga Xhakini Murat ta viti 1811; duall arkitet i shkëlqier ta viti 1814 e hiri sa më shpejt ta “Corpo dei Ponti e Strade” që kle burimi i parë i “Genio Civile”.

Stisi, ta viti 1832, të parën urë hekuri ta Italia (Ponte Real Ferdinando), varrur ma kamastra ta lumi Garigliano; e, ta viti 1835, njetër urë hekuri a varrur (ponte Maria Cristina) ta lumi Calore.

Ndreqi Napul kupolën e klishës së Xherolomitëvët; kle kreu së bënursë a ferrovisë Napoli-Portici (a para a Italisë); stisi stacionen e Ferrovisë Napoli-Nocera- Castellammare.

Pat ndjenja patriotik të forta e, ta viti 1860, kur ish drejtor i nderuar i skollës “Ponti i Strade”, u bashkua sa më shpejt ma tjerët garibaldinë arbreshë të gjegjur. I zgjedhur nga Garibaldi, muar pjesë aktivë ta qeverria a përkohshem si ministër i Shërbëtrivet Publikë.

Muar vesh ma njetër ministër arbresh garibaldin, xhurekonsullti i math Paskuale Skura, e leçiti Napul Plebishitin që adhe Garibaldit nëng i pëlqei kaq e më sa ndonjë i ish kundër. Vdiq Napul ta viti 1865 i dashur e nderuar nga gjithë ata që a njohtin.

Ruzari (1774-1854) kle xhurekonsulltë shumë i vlershëm e maxhistrat i ndershëm, deputatë ta Parlamenti Napulitanë ta viti 1848. Pëstana, kur rregji nëng mbajti besan që kish dhënë tura shpërndajtur Parllamentin, iku jasht shtetit e vdiq Nicë, ta viti 1854, ma helm të madh llargu nga dheu e nga katundi i tij i dashur.

LUIGI E ROSARIO GIURA - Luigi e Rosario Giura furono due fratelli che onorarono molto l'Arbëria.

Luigi nacque a Maschito nel 1795, fu uno dei primi alunni della scuola “Ponti e Strade” creata a Napoli da Gioacchino Murat nel 1811; si laureò architetto nel 1814 ed entrò presto nel Corpo di Ponte e Strade, che fu l'origine del Genio Civile. Fabbricò, nel 1835, il primo ponte di ferro d'Italia (Ponte Real Ferdinando), sospeso sul fiume Gargliano; e nel 1835 un altro ponte di ferro sospeso (ponte Maria Cristina) sul fiume Calore. Riparò, a Napoli, la cupola della Chiesa dei Gerosolimitani; fu a capo della costruzione della ferrovia Napoli-Portici (la prima d'Italia); costruì la stazione ferroviaria Napoli-Nocera-Castellammare. Ebbe forti sentimenti patriottici e nel 1860, quand'era direttore onorato della Scuola “Ponti e Strade” si unì presto agli altri garibaldini arbëreshë conosciuti. Scelto da Garibaldi, prese parte attiva al governo temporaneo come ministro dei Lavori Pubblici. Si conobbe con l'altro ministro arbëresh garibaldino, il grande giureconsulto Pasquale Scura, e pubblicò a Napoli il Plebiscito, che anche a Garibaldi non piacque molto, e più di qualcuno era contro. Morì a Napoli nel 1865, onorato e amato da quanti lo conobbero.

Rosario (1774-1854) fu giureconsulto molto valido e magistrato onorato, deputato nel Parlamento Napoletano nel 1848. Poi, quando il re non mantenne la promessa e sciolse il Parlamento, uscì fuori dallo Stato e morì a Nizza, nel 1854, addolorato per la lontananza dalla Patria e dal suo amato paese.

Tetëmbëdhjetët ka Shën Pali

Nicola Alfano

ka Shën Pali (Pz)

Sivjet kultonjem një qind e pesdhjet vjet që u bë Tallja; e kultonjem dhe arbëresht që i dhanë Katundit që i mbijodhë trimat më të mirë e më me vullndatë. Dhe Shën Pali paguaqi me gjakun e trimavet e tij amurin pir libërtaten, ai amur që bën e i pështoj ka Turkërat tre sekul më parë; ai amur e ajo vullndatë që një ditë e feristjut 1848, tri ditë pas Shëkosënjotravet, bënë e u nistin tetëmdhjetë kishterë pir të vejnë tek malet e Pulinit, tek llaka Kampotenese e të kumbatirin pir libërtaten. Aqë vdin gjith, frëng një; aqë vdin pirëTallien, akjë vdin pir ne:

I DICHIOTTO DA SAN PAOLO ALBANESE - Quest'anno si ricordano i 150 anni dell'Unità d'Italia; e li ricordano anche gli arbereshe che donarono al Paese che li ha ospitati i suoi giovani migliori e più audaci.

Anche San Paolo ha pagato con il sangue dei suoi giovani più valorosi l'amore per la libertà, quell'amore che li ha spinti a fuggire dai Turchi tre secoli prima; quell'amore e quella volontà che un giorno di giugno 1848, tre giorni dopo gli abitanti di San Costantino, fece partire diciotto persone per andare sulle montagne del Pollino, nella piana di Campotenese e combattere per la libertà. Lì morirono tutti, eccetto uno, lì morirono per l'Italia, lì morirono per noi:

Vincenzo Smilari, kapitan; Francesco Smilari, zot e letrar/prete e letterato; Stanislao Smilari pronar/proprietario; Crispino Smilari, bulk/contadino; Francesco Smilari, bulk; Alessandro Tamburri, jatrua/medico; Benigno Blumetti Mullunar/mugnaio; Francesco Donargo, bulk; Michelantonio Troiano; Costantino Blumetti, bulk; Scipione Buccolo, kopshtar/giardiniere; Francesco Buccolo, bulk; Francescsantonio Visaggi, furxhar/forgiaio; Domenico Buccolo, bulk; Giuseppe Buccolo, bulk; Costantino Chidichimo, bulk; Salvatore Stamato, bulk; Frate Antonio, Këllogjer Kallavric që shumë motë mbet Shën Pal/ monaco calabrese che stette molto tempo a San Paolo.

Atire, e kujtimit tire, vete falënderimi të bilvet e Shën Palit, atire që dertin gjakun pir të rrojim libru sod, atire që mosnjeri i kulton, i vaft falënderimi Shën Palit, një katund që nek do të harronjë kishteret që e sallvuan, një katund që rriret dhe me punjen e tire.

A loro e alla loro memoria vada il ringraziamento dei figli di San Paolo, a loro che versarono il sangue affinché noi vivessimo liberi oggi. A loro, da tutti dimenticati, vada il ringraziamento di San Paolo, un paese che non vuole dimenticare le persone che lo salvarono, un paese che vive anche grazie alla loro opera.



Itallja thonë se është Një

Lucia Cardamone

ka Shën Sofia (Cs)

Itallia thonë se është një, po tallianët nëng më duken shumë të bashkuar. Nëng sosnjen 150 vjet sa të bin' e thomi se jemi vëllezër. Mënd jerë edhe se jemi vëllezër, po jëmat tona janë ndrishe e njerkat nëng duhen mirë si një jëmë. Mbi Bashkimin e Itallisë shumë u shkrua e shumë u tha: çdo fillele janë vërteta, çdo janë të rreme; shumë janë fillelet që na mbajtin shehura, po dihet se historin e shkruan kush vinxhon, e na (Mjezditë) buartim. Mbi librave gjëmi Garibaldi e Cavour, po mosnjeri njuh ëmrat e atyre që, ka nga vend e Itallisë, vanë e i ndihtin të bëjin atë që bënë (ndë të mirat e ndë të ligat), ne ëmrat e atyre që nëng i dohin (e ç'ata thërrisin brihendë), e për këtë qenë të vrar o vënur filaqi o dërguar të vdisin llargu shpive e fëmilëve të tite. Mosnjeri na tha se sa pasuri na vjodhtin, sa gjindë pa mbëkate vranë, sa djalra, sa grave i muartin nderen. Historia do ruajtur me sytë e atyre që vinxhuen, po edhe me sytë e atire që buartin, tue njohur liqen e tortjen e nganjërit, njëmos Bashkia qindron vetim një fjalë e mbrazët. Tek komunitetet arbëreshë shumë qenë ata që muartin pjesë tek Bashkimi i Itallisë, e që nëng gjëmi te librat e historisë, po që me gjithë zëmer kërdhirtin vërteta tek atë që bëjin e për këtë na kem t'i bëmi nderë.

Ka Shën Sofia:

Baffa Aniceto, Baffa Antonio – Sacerdote, Baffa Atanasio – Sacerdote, Baffa Bruno, Baffa Demetrio , Baffa Domenico , Baffa Francesco di Giacomo, Baffa Francesco di Pietro, Baffa Giacinto, Baffa Giovanni – Capitano, Baffa Giuseppe Maria – Tenente, Baffa Luigi – Luogotenente, Baffa Nicola, Baffa Pietro, Baffa Pietro Paolo, Baffa Vincenzo, Barci Carlo, Barci Gennaro, Barci Michelangelo, Becci Giuseppe – Tenente, Becci Stefano, Bugliari Nicola, Bugliari Stella Alessandro, Brunetti Nicola, Canadë Gaetano, Caravona Andrea, Cardamone Domenico – Sacerdote, Cardamone Gaetano, Cardamone Giuseppe, Cortese Gaetano, Cortese Giacomo, Cortese Giovanni, Cortese Pietro, Fabbriatore Vincenzo, Ferriolo Giovanni, Frontera Atanasio, Guido Angelo, Lopez Benedetto, Maimone Antonio, Marchianò Francesco, Marchianò Giuseppe di Francesco, Marchianò Giuseppe di Fiore, Marchianò Nicola, Masci Domenico, Masci Giuseppe, Mazzei Francesco Maria, Micieli Giuseppe, Miracco Antonio, Miracco Atanasio, Miracco Domenico, Miracco Gabriele, Miracco Giovanni, Miracco Giuseppe, Miracco Paolo, Murano Angelo, Murano Paolo, Murano Carlo, Pizzi Giovanni, Pizzi Giuseppe – sottotenente, Rizzuti Francesco, Rumanò Francesco, Sapia Gennaro, Sica Giuseppe, Sica Salvatore, Trotta Giuseppe ¹.

Bëmi sa mundmi pse këta nëng kanë jenë vet ëmra mbi një copë kartë o ëmra të nxjerr ka buhoj për festat të madhe, po njerez që kam mbami mend e që kam nderomi ngamot pse luftuen për atë ku kërdjirjin. Uronj se nga arbëresh mënd njoh historinë e katundit i tij e edhe burrat ç'e bënë. Uronj se te katundi tyre këta burra mënd mbahen mend tue intitolluer atyre qacat e udhat tona, kështu nganjë i sheh e pyen kush ishin .

Facciamo quanto è in nostro potere affinché questi non siano solo nomi su un pezzo di carta, o nomi da rispolverare per le grandi occasioni , ma persone da ricordare e onorare sempre, perché hanno combattuto per ciò in cui credevano. Auspicio che ogni arbëresh possa conoscere la storia del proprio paese e degli uomini che l'hanno fatta. Auspicio che nei loro paesi questi uomini possano essere ricordati intitolando loro le piazze e le nostre strade, così che ognuno li veda e chieda chi fossero.

1) *Ëmre të marrë ka librat /tratti dai libri: "L'utopia popolare della Repubblica - Gli Arbëresh e la grande corte criminale" , di Giuseppe Carlo Siciliano - Falco Editore; "La diversità Arbëreshe" di Giuseppe Carlo Siciliano e Damiano Guagliardi – Amministrazione provinciale di Cosenza, Assessorato alla Cultura; "Dizionario bibliografico degli italo-albanesi" di Giovanni Laviola – Edizioni Brenner.*

JETA ARBËRESHE

KËRKON KORRISPONDENTË NDËR KËTA KATUNDE:

Sëndahstinë (Pa), Kastërnexh, Qan, Marr, Fermë, Strigar, Shën Mitër, Mbuat, Picili, Vakarie (Cs), Barill, Zhur, Shën Kostandin (Pz), Portkanun (Cb), Karfic (Kr), Vinë, Andall (Cz)

Telefononi o shkruani Drejtorit: 0981-32539 / e-mail: jetarbreshe@libero.it

Kujtim i motrës së vogël Maria Delfina

Maria Lucia, motër e vogël

ka Tirana

Pë sindëkun e Shën Benedhitit

Daniela Moccia

ka Shën Benedhiti (Cs)

Po ju dërgoj një kujtim të Maria Delfina Rossano-s, që shkoi në shtëpinë e Atit më 31 mars 2010. Pas një operacioni shumë të vështirë në nëntor 2007, me këmbënguljen që e ka karakterizuar gjithnjë, e mori veten dhe deshi të kthehej në vendin e saj të dashur të Akuaformozës, ku edhe vitin e shkuar vajta ta takoja. Me atë rast zbritëm deri në Eianina për të takuar Zotin Emanuele Giordano dhe së bashku kaluam momente të paharrueshme.

Maria Delfina, e lindur më 1933 në Akuaformoza, një nga lokalitetet arbëreshe të Kalabrisë, ku shqiptarët u pritën për të shpëtuar nga pushtimet turke në gjysmën e dytë të shekullit XV, kishte hyrë në Vëllazëri më 8 dhjetor 1968. Një ko incidencë, që për motrën e vogël Magdaleine ishte një shenjë: ndërsa motra e vogël Odette Louise shprehte dëshirën për t'u përgatitur për në Shqipëri, një letër e famullitarit të Maria Delfinës, Papas Matrangolo, e bën motrën e vogël Magdaleine të zbulojë praninë e shqiptarëve në Itali. Vendoset atëherë që motra e vogël Carla dhe Odette Louise të shkojnë të njohin disa nga këto bashkësi arbëreshe dhe si pasojë e këtij udhëtimi, më 1969, u hap vëllazëria e Eianinës. Maria Delfina, pas kushteve të para, mbërriti vëllazërinë e Prishtinës, e cila sapo kishte nisur, dhe këtu qëndroi disa vjet, duke marrë përsipër me kurajë një punë shumë të rëndë në mensën e të rinjve universitarë dhe duke ndërtuar kudo miqësi të forta me këtë popull, të cilin ndiente se i përkiste.

Pas disa vjetësh, në kërkim të një jete të Nazaretit më të rreptë dhe rrënjësore, kërkoi ta linte Vëllazërinë e Motrave të Vogla dhe jetoi disa vjet në Longobuko (Kozenca), pranë një zonje, duke ndarë kohën e saj për mbledhjen e ullinjve (punë kjo që i lejoi pastaj të kishte një pension të vogël) dhe shumë punë të vogla kërkimore për arbëreshët, të cilat i shtypte me shaptillograf dhe i shpërndante me kursimet e veta. Kam mbetur gjithnjë shumë e befanasur nga stili i rreptë i Nazaretit, që ajo jetonte në përditshmërinë e saj dhe nga përlutësia që rrezatonte puna e saj falas. Gjatë viteve të fundit ishte shumë pranë priftërinjve punëtorë dhe po ju përshkruaj dëshminë e njerit prej tyre. I kishte rrajuar lidhjet me Vëllazërinë, sidomos me Tre Fontane dhe me ne, motrat e vogla të Tiranës. Maria Delfina, sidomos gjatë periudhës së fundit, ka jetuar lidhjen mes pranimit të dobësisë dhe bindjes ndaj jetës pa zhurmë, me shumë thjeshtësi.

Dëshmi e nipit Pietro: Teto Maria ka qenë për ne një pikë e rëndësishme referimi. Na ka mësuar të shohim botën me sytë e zemrës, jo vetëm të arsyes. Na ka mësuar se një gëzim i vogël i bashkëndarë bëhet një gëzim tejet i madh. Na ka transmetuar shijen e përkormërisë... Na ka nxitur të luftojmë gjithnjë kundër padrejtësisë "pa humbur butësinë". Dhe, nëse thuhet rëndom se, kur humbet një person i dashur, humbet edhe një pjesë jona, për ne nuk ka qenë kështu. Ne e ndiejmë edhe më thellë të rrënjësor në gjestet dhe mendimet tona. Dhe, në dëshmi të saj, në ballkonin tonë valëvitet Flamuri i Paqes, një nga simbolet që ajo donte më shumë.

Dëshmi nga don Mario Signorelli – prift punëtor: Të Enjten e Madhe u zhvillua funerali i Delfinës, mikes sonë shumë të

I dashur sindak të Shën Benedhitit, kush të shkruan është njeri që do të jarë vuxhë gjithë atirë fëmijë që rrinë ndë këtë katund e që kanë bezonjë nga pakë shërbise sa t'jenë kutjendë e sa të rriten më mirë se si u rritin printet e tite, po ata pak mangojin sod si mangojin dje.

Penxove ndonj herë që vjen me thën për një kriatur pak vjeçshi të mos t'kerë një jardin publik ku mund ver e bredh ndë kongalë o ndë një nga ata joke të penxuara për kriaturat sa të shkojin motin ture i ndihur të rriten me kurmin e me krien? Të ngas i trëmbur mbrënd katund përçë ndë gjithë udhat e katundit makinat mund kurririn sa duan, e mund pundaren ku duan, pa mos një rregul, edhe përçë ndë shumë vende nëng ka parkexhe? Të mos t'njor mos një monument që mban mend gjë nga storia e katundit të tij? Të shorë ngadita, e ku vete vete, municë udhës e udhës e shkalla publike me shkallunet tape tape? Të shorë dritat publike të shuajtura natën e natën? Të shkonj ndë udha të pjota me fose ture vatur përjashtë katundit? Të mos t'kerë një bibliotekë e hapur? Të mos t'kerë një kamp sportiv ku mund bredhë ndë pallun, e jo vetëm? Të shorë balde munici të bardha, ble, xhallu e grixhe: megjithëkëtë të diar se municia nëng vjen stajuar? Mund jerë kutjend ngatund tekuri rri? Çë mund penxojin nga një llok kështu i posovisur?

Sindak, penxoje një cik e dhopu thuajm ndëçë është i bukur atë që she e ndëçë nëng stesim një cik gjithë. e ti i pari, ndëçë je si deshtin më shumtë shënbenedhitiotet, i pari katundar të Shën Benedhitit? Çë sod e parë penxo ndëçë do t'jesh mbajtur mend sin sindëku që bëri gjë të mirë për katundin o si ai që bëri si tjerat, e la katundin të posovisij pak e pak.

Një shënbenedhitjot

ALFABETIZZAZIONE ARBËRESHE

(Abetare, Gramatikë, Histori, Letërsi, Folklor, Rit, Muzikë, Glosar)

2 libre - euro 5,30

(editor Shoqata Aiadi, Ungër; botues "Il Capitello", Torino 2000; Redaktorë: I.C.Fortino (koordinatori), V.Bruno, A.Giordano, p.E.Giordano, C.Stamile, E.Tocci)

Telefononi Antonio Uberti-t

0982 - 582241

dashur, që gjatë këtyre viteve na ka shoqëruar gjatë takimeve tona kombëtare. Kam qenë në shtëpinë e saj para tri vjetësh dhe kam parë ku jetonte, në Akuaformoza, një lokalitet që shtrihet mbi malet e Silës, me traditë shqiptare. Në thjeshtësinë e saj dinte të thoshte gjëra të thella. Këto tri vitet e fundit kanë qenë për të një Kalvar, po ka ditur ta pranojë me dinjitet sëmundjen. Madje ka zbuluar thesare në të, sidomos me aftësinë e saj për t'u përkulur mbi ata që kishin të njëjtin problem. Nga letrat e saj shihet shpirti i thjeshtë dhe i pasur me mendime, që janë pranë mistikës, me shumë dëshirë për të luftuar dhe me një ftesë ngulmuese për ne priftërinjtë punëtorë që të mos dorëzohemi.

Dita Gjuhs Mëms ta gjith shëku

Maria Assunta Fazzino

kana Këmarinit (Cb)

Të shtunë 26 i fëlvar u mbah Këmarin Dita Gjuhs Mëms ta Gjith Shëku, ta Auditori Skoghs e Mesmë, bëjtur ta Komuna Këmarinit bashk ma Shoqatet Kulturor Hora Vjetër të Këmarinit e Gjaku Shprisht të Rurit, e ma Rëxhuna Molize dhe Unesko.

Kjeti shum bukur ma gjith ke ishti të timt i keq.

U buta duk filmi të Daniela Giammarino e Riccardo Bruni ma embër “E nesër?” sipër Arbëreshëvet Molizit, e pas mbrëma u sos ma këngzat të Yllez të Rëgjënda të Rurit. Edhe Asesorit i Kulturs Këmarinit, Pasquale Francesco Di Giulio, ju kënd filmi e muzkat, ashtu tha ke dot’ e rëbënj ta staxhuna. Filmi aruri i dit ta kungorsi Internacional Babel Film Festival, sipër pakicat gjuhësor; gjindrat ta “E nesër?” kushonjen vetëm arbrishtin, ma ndën jan të shkruorit ma lëtiun, ashtu edhe ata që ng’ a flasënjën mund e kuptojnën.

Shum a ndietur ishtë poezia “Gjaku Shprisht” të **Xhani Frate**, kana Rurit, që e lixhon ma gjithë zëmër.

Filmi soseset ma një plak që kushon ta veshi njëja djali i vogël, si pë t’ i lënj gjuhën arbreshe, ma sprënxën ke djali a vlon.

GJAKU SHPRISHT

Sonde u një prrëghez do thom
niset p’atejë ku jan printe e tonë
Kur të kërshtert sa kishen harë
e Skanderbegu striohshi pë ne.
Pas... pas erdhi e sosura shekughit
gjindjat pa Krisht na hirën nga cip
IkJën kapilet mos gjëndshën pë ndën
burrat dërvitshën me thikën ka dhëmbt
Bi te hipëm ka deti at’ natë
sit na burtohshën më prap ke përparë
Dharasu ka moti sa dukshi gjithë tim
me koçën e vargur ngë ndejëm vëndim.
Ngisjëm ka deti qet qet
hënza na qei ku dishi vet
Mëmën e tatën i llura pë rdhë
sa dish vdisja me zëmren e prer.
Errurëm që sa bëri drit
atë që paç ti mos m’e lip
Derdhur ka rëra rëkojëm pa ngrën
kura një burr ngë kaghovi më ndën
Xathur u ndam për drelart
brënda njëja kishë na prun një cop djath
Faqet ng’ i njihja ke foljën lëti
ma Krishti ka kriqja ki t’ishi ai
Ngeja na e pruri ca hjat
e njohëm të njom e njohëm të that
Ndonjë lëti që na mblushi me fjal
koçën ja shtrëmbëm na pas dal e dal
U sutuvuòm caz më mirë
vajtëm përparë me aq shubërtir
Ngrivëm di shpi, rëmovëm shumë dhe
Horën e bukur e bërëm të re.
Shkovi ai mot aq i lig
rraja na u vjet ma mëse një pik
Nani mësovëm ke pë t’ bjeç but but
ka folsh e ka shkruoç e ka tundesh me trut
Sonde u’ jam ktu që këndonj

LA GIORNATA INTERNAZIONALE DELLA LINGUA MADRE - Sabato 26 febbraio si è festeggiata a Campomarino la Giornata Internazionale della Lingua Madre, nell’ Auditorium della Scuola media, organizzata dal Comune di Campomarino in collaborazione con le associazioni culturali Borgo Antico di Campomarino e Gjaku Shprishtë di Ururi, col patrocinio della Regione Molise e dell’ Unesco. E’ stata una serata molto intensa, nonostante il freddo pungente. Nell’ occasione è stato proiettato il film di Daniela Giammarino e Riccardo Bruni dal titolo “E domani?” sugli Arbëresh del Molise, e la serata si è conclusa con le musiche del gruppo “Le stelle d’ Argento” di Ururi. Anche l’ assessore alla cultura del Comune di Campomarino, Pasquale Francesco Di Giulio, ha gradito molto sia il corto che i canti, tanto è vero che ha manifestato la volontà di inserire la manifestazione nel cartellone dell’ Estate Campomarinese. Il film proiettato è arrivato secondo al concorso internazionale Babel Film Festival, sul cinema delle minoranze linguistiche; gli attori in “E domani?” recitano in arbëresh, ma i sottotitoli in italiano permettono anche ai non parlanti di seguirne i contenuti. Molto intensa è la poesia “Gjaku Shprisht” di Gianni Frate, di Ururi, da lui stesso declamata con una interpretazione magistrale. Il film si conclude con la scena di un anziano che parla nell’ orecchio di un bimbo, con l’ intenzione di trasmettergli l’ arbëresh, in modo che il bimbo lo custodisca gelosamente.

SANGUE SPARSO - Oggi una favola voglio raccontare / Comincia di là... dove si trovano i nostri padri / Quando i cristiani vivevano felici / E Skanderbeg si struggeva per noi. / Poi... poi venne la fine del mondo / Genti senza Cristo ci hanno invaso in ogni punto / Scappavano le ragazze per non trovarsi sotto / Gli uomini lottavano col coltello tra i denti. / Dovemmo salire sul mare quella notte / Gli occhi ci si contorcevano più all’ indietro che in avanti / Lontano nel cielo si vedeva tutto fumo / Con la testa china non sentivamo il vento. / Camminavamo nel mare... zitti zitti / La luna ci portava dove essa voleva / La mamma e il papà li ho abbandonati a terra... / Vorrei morire col cuore tagliato. / Arrivammo che s’ era appena fatta luce / Ciò che ho visto non me lo chiedere / Buttati sulla sabbia gemevamo affamati / Mai un uomo non è sceso più in basso. / Scalzi ci avviammo all’ insù / Dentro una chiesa ci portarono un pezzo di formaggio / Le fece non le conoscevo perché parlavano latino / Ma Cristo in croce doveva essere lui. / Il tempo ci ha portato un po’ di respiro / Abbiamo conosciuto il molle, abbiamo conosciuto il duro / A qualche latino che ci ha riempito di male parole / La testa gli abbiamo storto poi piano piano. / Ci siamo sistemati un po’ meglio / Siamo andati avanti con tanto lavoro / Abbiamo costruito due case zappato molta terra / Il paese bello l’ abbiamo rifatto nuovo. / È passato quel tempo tanto malvagio / La rabbia ci è rimasta ma solo un goccio / Ora abbiamo imparato che per cadere sul morbido / Bisogna parlare bisogna scrivere bisogna muoversi col cervello. / Oggi sono qui che canto / Il “Sangue sparso” non posso dimenticare / Io voglio lanciare il bando e voi statemi a sentire / Nel nostro paese noi tutti siamo Arbëreshë.

“gjakun i shprisht” ngë mund e’ haronj
U do t’ drinj bëndin e ju marmëni vesh
ka hort e ton na gjith imi Arbreshë.

Xhani Frate, ka Ruri (Cb)

Qeft, një rrugë e një pistë

Mario Massaro

ka Qefti (Fg)

Pruxheti rikualifikimi të rrugës historike-simbolike që i përket “Të Rrjedhurit të qerrëvet” të Qeftit, vëjtur në pjanin e zvilimit teritorjal të Bashkive të Serës dhe të Qeftit dhe në pjanin rigeneraçjuni urban pë një spizë të plot të Euro 925.000,00 ka të jetë shpejt realizuor.

Pruxheti përveçon ndërtimin e një pistë pë çikliste dhe një rrugë me këmbë që rrjedh pë dica here gjatë udhës provinçale, ajo që lidhën horën me detin, pë të vazhdonjë pastaj paralelisht rrugës komunale “Inforchia-Maresca”, gjatë së cilës mbahet me datën 22 Prill tradëcjuna e Të Rrjedhurit e qerrëvet, njera te vendi ku nisen qerret të rrjedhnjën.

Ki pruxhet do të valorizonjë tradëcjunën jone shumë e njohur dhe i jep mundësinë edhe gjithëve atire që vinjën te hora jone pë të marrënjën pjesë dhe të varenjën me shumë qejf, darasu, veçoritë e Të Rrjedhurit e qerrëvet.

Ki pruxhet do të jetë, po, shumë i rëndësishëm pë gjithë ata që duonjën të ecnjën me qetësi mbë këmbë dhe me biçikletën pa trëmbësirë të jenë vëjtur ndën nga makënat, që gjatë kësaj rrugë rrjedhnjën shumë, pa rëspet p’ ata që ecnjën mbë këmbë dhe me biçikletë.

Isht, vërtet, një të mirë që ka një vlerë historik-kulturor dhe ambjental, që do të jetë i përdorur nga të gjithë gjindjat të Qeftit dhe nga shumë të tjera që e duonjën mirë tradëcjunën e Të Rrjedhurit e qerrëvet, dhe që vinjën Qeft nga shumë vende të Puljes dhe të Molizit.


CHIEUTI, UN PERCORSO PEDONALE E UNA PISTA CICLABILE

- Il progetto di riqualificazione del percorso storico-simbolico interessato dalla Corsa dei carri del territorio di Chieuti, inserito nel Piano integrato di sviluppo territoriale dei Comuni di Serracapriola e Chieuti e nel Piano di rigenerazione urbana per un importo complessivo di Euro 925.000,00, sarà presto realizzato.

Esso prevede la costruzione di una pista ciclabile e di un percorso pedonale che si snoderanno per un tratto lungo la provinciale che collega il centro urbano con la marina per poi proseguire parallelamente alla strada comunale Inforchia-Maresca, lungo la quale si svolge il 22 aprile la tradizionale Corsa dei carri, e fino al luogo della partenza dei quattro carri in gara.

Tale intervento non solo mira alla valorizzazione della rinomata tradizione, in quanto permetterà a tutti coloro che si danno appuntamento a Chieuti di partecipare ed ammirare più da vicino la singolarità dell’evento, bensì sarà di grande utilità per quanti desiderano passeggiare serenamente e circolare in bicicletta senza il pericolo di essere investiti dalle auto, che in quel tratto sfrecciano a grande velocità incuranti di pedoni e ciclisti.

E’ veramente un’opera di grande valore storico-culturale e paesaggistico, che sarà utilizzata da tutta la popolazione chieutina e dai numerosi sostenitori della tradizionale Corsa dei carri, provenienti da diverse contrade della Puglia e del Molise.

 <p>VANGJELI</p>	<p>i pjerrë arbërisht nga zot Emanuele Giordano 230 faqe Euro 10,00</p>
--	--

K'shtu a fjasmi na, Shin Vasil

Kostandin Bellushi

ka Pllatëni (Cs)

Ditan e Pefanisë e t'Inzotit të k'tij viti, ka Muzeu i Ikonvat të Shën Vasilit, plot me t' dashura miq dhe bashkëpunorë, shfaqtin librin e Vasilit Pugliese (Silli për miq't), "K'shtu a fjasmi na", që qelli përpara i vllau, Franco Pugliese, me mikun e tij, Kostandin Bellushi ka Pllatënit, pas vdeksjas së tij, dhe kle i shtipur me kontributin e Bashkisë së Shën Vasilit, që dish t'a kllini ka Programi i fundit për nënshkrimin e Kapitullvat të katundit me Munsinjurin e Kasan's, Imzot Marino Tomacelli (1510-2010).

Muartin pjesë ka paraqitja, mirë a mbajtura ka prof. Nunzia Pandolfi, bashkëautorët e Sillit, sindku i katundit, av. Vincenzo Tamburi, prof. Mimmo Rizzo, prof. Tina Uva, që bëri skoll Sillit, dhe Asesori i Bashkisë, dott. Maria Giovanna Masci. Ki interesant libar është i shkruar arbërisht (gluha e Shën Vasilit) e lëtitsh, dhe është i ndar ndër katër kapitul e mban: fjalë t'urta, kënga, poesi dhe, nd' fund, nj' fjalor i madh, arbërisht-lëtitsh, ka gluha e Shën Vasilit.

Mbrëmja a bukur, që vata përpara me kujtimita dhe me poesi (një ndër atò ish ja Lluixhit Bellizzi - Kopulliçi - që ja bëri Vasilit), kle shumë a ndiar dhe a ngrohur ka gjindja e katundit, që për ca orë u bashkua ture kujtuar trimin Sill, i dashur mirë ka gjithë Shënvasilotët. Ai, për amurin që i kish katundit ku u le, doj t' i jip kontributin e tij per t' njohi më mire dhe më shumë kultura që ka (nën aspetin popullor - gluhësor), mos t' birat dhe mos t' farnohat, e nani, dhe me librin e tij, mënd t' jet më a vlerëzuar dhe më a ruar. Falëminder Vasil!

COSÌ PARLIAMO NOI, A SAN BASILE

- Il giorno dell'Epifania del Signore di quest'anno, è stato presentato, nella sala del Museo delle Icone di San Basile, affollata di tanti cari amici e collaboratori, il libro postumo di Basilio Pugliese (Silio per gli amici), "K'shtu a fjasmi na" (Noi così parliamo), curato dal fratello Franco, dall' amico Costantino Bellusci di Plataci e finanziato dall'Amministrazione Comunale di San Basile, che l'ha inserito nel programma finale della celebrazione del V Centenario della stipula dei Capitoli tra questa ridente Comunità arbëreshe alle falde del Pollino e il Vescovo della Diocesi di Cassano, da cui prima dipendeva, Mons. Marino Tomacelli (1510-2010). Hanno preso parte alla presentazione, ben coordinata dalla prof.ssa Nunzia Pandolfi, oltre ai curatori, il sindaco del paese, avv. Vincenzo Tamburi, il prof. Mimmo Rizzo, la prof.ssa Tina Uva, insegnante di Basilio, e l' Assessore comunale alla Cultura, dott.ssa Maria Giovanna Masci. Questo interessante testo è diviso in quattro capitoli e contiene: proverbi, canti, poesie e, in appendice, un ricco dizionario in bilingue (arbërisht - italiano) della parlata di San Basile.

La bella serata, svoltasi in una commovente e calorosa atmosfera di vita paesana, tra nostalgici ricordi e recite di belle poesie (tra cui quella di Luigi Bellizzi - alias Kopulliçi - dedicata al giovane Basilio) che, per qualche ora ha riunito, cordialmente, la Comunità ha permesso di commemorare, affettuosamente, il giovane Basilio, amato da tutti i compaesani. Egli, per amore verso il suo paese natio, desiderava tanto dare il suo modesto e valido contributo a farne conoscere il patrimonio culturale - sotto l'aspetto demologico e linguistico, purtroppo sempre più a rischio di estinzione, che ora con il suo libro può, almeno in parte,

Të ngrënë e njëhershëm

Giuseppe Chiaffitelli

ka Mashqiti (Pz)

"Do hami do pimi do rimi e të shurbemi nëng do dimi; kur arren muaji Janarit do t'hami kriana a karit, kur arren Maji na dalan morrat ta kulari": ashtu rrëfij një kënkë a vjetër arbreshë që dëfton shumë mirë si a ndian gjellan Mashqitani.

Ta gjella e atirva që shurbjejan dherat të ngrënë pë të rrohet ishan e jan adhe të lidhur ngusht ma atë pak që dheu e animaltë jipjan ma dorë të shtrënguar e vetam pas shërbëtirva të rënda e ma atë pak që mundjan të vlojan pë dimrin që ish shumë i glatë e i ftohtë.

Ta tryeza a të vapkut, si ta ajo a bularit, kaq ndë ditat shërbëtirja sa ndë kremtat, rregjërat klenë, janë e do të jenë adhe nesar buka e vera: do thom më mirë buka mielli gruri pjekur ta furri ma drutë,e jo ta ai alëtku si nani,e vera a zezë nga rrushi Alënëku.

Ja lëjan gravat e djelmërvat pë ditat festja verat a bardha:Muskatin a ëmbël e Mallvasinë që të diglizan grikan.A dijjan shumë të glatë loshrat e pleqt kur thojan:"Bukë e verë e ve tryezan".

Tatëmadhi im, Sepalia Dhuminkut,thoj ma ca gazë tura qeshur ndën musteqvat:"Vër adhe lëkëngan".

Prana adhe Bibja, Libri i librëvat, Libri Shejt, i shkruar pas të thënsurë së Perndisë, na rrëfian sa Patriarku i madh Abrami ,i lodhur e i dërsijtur, pas luftës që ngavnjeu, bashka ma Melkisedekun, prifti më i madhi i më Të Lartit, hëngri bukë e verë e u drosisi.Pa lëkënga, pë mos të kamaroj tura ngrënë derkun që atëhera ish një animall i përljar!

Na djelmra të ardhur nga lodrat a udhës,të dërsijtur, të esur e pa ngrënë, kisham shumë nu e hajam ma oreksë një të bukur e të madh thellë bukë ma ca val e krypë o, ndo një rallë herë,ca cukër o ca kunxevë a shtruar mbi, si "nutella", o një pumbëdhora a shtridhur mbi.Na pëlqej kaq sa nëng do t'a ndrrojam ma "Brioshat" a sodshëm që nëng ishan.Bukë ma djathë o lardhë o qepë a hajan të mbdenjëjt. Bukë e lëkënga na taksjan të a hajam kur përmirij pulja o bëj venë gjeli.Nga ditë na ndëndij buka që nëng ndodhij gjithë herë e pë gjith: ajo ish shumë a mirë e oreksëshem si dilij nga furri, a njomë, a ngrohtë e a kërcëlmë pë që kërcëllisij (bëj kërcë kërcë) kur përtipja skorcan;tultë vej poshtë më parë sa t'a përpjia.Si shkojan ditet bëhij a thatë e të pëlqej adhe më shumë.Të njoman ëngja ja jipjan kurrë shërbëtorvat pë mos të hajan shumë! A thata ish a mirë pë të bëj përseshin ma"xërrin, thënur ashtu sa bëj"xërrë" kur ti i shtija mbi valtë, pepdhinat e hudhran të diganisur.Ajo ish a mirë adhe pë të bëja përseshin ma rrapa, rapesta o tjera lakra të egra o kopshiti, e adhe pë t'a haja ma.fazulat, fjerat, qiqrat groshtë,bathë e rripulit të njoma o të thata, o ma sufitrin a derkut.Kur bëj vapë lagshij ma "akuasallin"bënur ma ujë, val, kripë, pumdhora të njoma, qepë, thelba hudhrash, rigan, një karkaveca, një pepdhinë e ca açë të prera thellë thellë; o bëhij "supa"ma veran a ngrëna Abramit e Mellkisedekut.Kur nëng kisha mosgjë tjetër, pë idhëz a lagëja e a njomja vetëm ma ujëtë sa urti ish më i miri idhëz!

Pa dijjan loshrat zbuluan të ngrënat që nani "djetollogjit",ata që thonë që kë t'hami e që ka t'pimi po nëng na thon ku ka t'i marmi turrestë pë të i blemi, i thërresan "djetan mediterrane"; kjo ish bënë (e vjen bënë adhe sod) tura mruajtur mbi një

Moti zbulon zdramet

Moti Madh/Mario Giuseppe Miracco

ka Shën Sofia (Cs)

Doja t' dija: pse Arbria qan? Doja të kapirja: pse Arbria qan?

Pse ngadita shkelmi boten që na duket jona, pa u adunartur se ngadita shkelmi një bot e re? Pse fjala arbresh së të vjen e prjerë prap ka vllau, pa u adunartur se vllau thot: "Ësht turp të fjaç një gjuh e vjeter"? Pse bën një lexhë sa t' pajtonj kullturen arbresh; cë bzonj ish, nd'ajò pa një pajtje duroj qindra vjet pa lexhë (482)? Pse Qisha arbresh qëndroj pa Eparki, pa Peshk, pa Zotra arbresh? Më turpia, pa t' mirr zotra ghua, mbrazet qisha për ftesen e atire ç'bën një qishë piësjë! Pse kullexhi Shën Ndranit, drita kulltures arbëresh, mbullin mbsimat, "gjuh e letërsi arberesh"? Të bien lloret kur shkon përpara kullexhit e she at shkreti. Pse mosnjeri ka nikoqiret e dhates së dunaret se kur gjindja bir gjuhën, qishen e istorin biret àmures? Manat që vlen të shporlovarç griken tue thën "Kishim kët, kishim atë"?

Pse ata burra të ndiajtur, që qen të zgjedhur sa të shurbijin të bi t'vein përpara gjith këta shurbise, u gharruan kur u ultin te shexha?

Ai burr ngamat që vllau do t'e poshtonj njera t' bjerë àmures, gjellë e kulltur, se ka t'e jetapërzienj te një mot që ai thot i ri.

Ai burr që së do t' mbjaket, që së bën pas prap, të lërenjë bilave të rriten, të ngasen me këmbet e tire. Ai burr, i biri trizet e tetit (68), i biri lulave, ai që thot se ndrroi moti, shllloi te pjëgjt kullturat të vjetra, pa pënxuar të stisnij një e re, tue vat marr ghua copa ktu ktjë. Ai burr që thot se she largu, po së ndien atë që she, pse ato shurbise që sot i duken të rea, ditën apriasu jan të vjetra, markati ja shtie apriasu t'i mbanj trut t'penguera.

Ai burr që lartësoghet, pa bën studima të shkëlqiar, po u gharrua ku ka rrënjat, ka turp, thot t'rrema gjelles tij, kur do t'qughet lëti.

Qan gjella arbreshit kur she se katundi mbrazet, mosnjeri nget mbë këmbë, pundar ndë qac, së përpqet me njeri të ndrroj një fjalë. Bilt e Arbrisë prjeren kraht kulltures që leghet me fjalën.

dërrasë,"tuvulliuiri", mialltë gruri pë të i bëjan:tumacët, riqtelat, fërretat që mirrjan emrin nga "fërreti"hekuri ma kë shurbjejan lëmshin leshi,drmosat,droqët,dorzat thënur ashtu sa ishan bënur vetam ma dorë, shtridhëlat, llazanat, çingulit, rrashkatjelat, kaucunxhjelat, vesh maçja bënur ma copat pastja të vogla që mbetshin kur bëjan kaucunxhjelat e vijan pjerrë e dredhur si një vesh maçja,vesh prifti, veshlat e ndonjeter që nani nëng më vjen ndë mendë. Ma emrin "makaruna" thërrisjan çdo pastë a blerë që a hajan vetëm bulartë.Gjithë hahshin ma lëng mishi të kuqë o ma fazula fjerrë, groshë, qiqra, bathë ma skorcan o pa skorcë, e rripulë të ziara ta vatra dalë dalë ma pak zjarr ta një poçë bashka ma dy thellë hudrash, dy fletë llaudhja e, ndonjë rrallë herë, ca lëkurë o një vesh o një këmbë derku. Pastët hahshin adhe ma lakra kopshiti çimarapa,çimakungulli,seskul o lakra të egra vërrajna, labotë, mëraj i egër, sparënj e këpurdha o ma valë dy pepdhinë të thatë, dy thellë hudhër të diganisur.

Më sa gjithë hahshin lakrat ato kopshiti e më adhe ato të egra. Lakrat të blera nëng i gjeja kurrë sa mosnjeri i shsjij e mosnjari i blij pë që turrestë ishan pak o fara. Adhe ata që shurbjejan ta hora, artiart o më mirë gratë e atirva, vejan të i mblihdhjan jasht

(ec te faqja 15)

Kënka Djepje

(te rrëfajtura ka) **Anita Markut** (1919-2010)

ka Purçilli (Cs)

Kur m' u leve ti, nerënç,
mbjatu ka ti u mbajta sprënç,
e të ruajta nat e dit
se mosnjari kish të t'ngit.

Kur m' u leve ti, m' u leve vet
ka ai sheshthi Rrubert:
mamiejen t' e bëri ai lal Vasil;
jat' em, si çotarele, i harroj dit' t.

Vashez çë te djepja rri,
faqet i ke si Shën Mëri:
bilza mëmes më je ti.

Bir, sa mir t' rriten j e t' mbanj,
mëma kët e bën nutar:
oj bi, oj bi,
nutarthi mëmes më je ti.

“Nina nana” m' e bën mëma
nga menat e dhe nga mbrëma,
njera, birith, ç' e bën t' math,
të t' shoh t' mir e krirenxat;
oj bi, oj bi,
krirenxat' thi mëmes ti.

Vashez t' bukur çë m' ka mëma,
nëng m' e ka nemenu hëna:
është si dialli kur del,
bukuria e mëmes vet.

Vash e bukur dhaj si fat,
mëma t' nxier ka ajo fash;
nat e dit ajo të kndon,
vashez mbjatu të t' martonj;
oj bi, oj bi,
fata mëmes më je ti.

Kur ki bir ndë skollet vete,
Mëma i bjen molla e pirete:
oj bi, oj bi,
molla aduri mëmes ti.

(Tekste të vitit 1973, çë gjënden tek teza e llàures e të birit
Agostino Giordano: “Poezi Popullore Frasnitë e Purçill” (1975).

Sen. Basilio Giordano

3ª Commissione - Affari Esteri, Emigrazione
Vice Presidente Comitato Italiani all'Estero

Piazza Madama, 1 – 00186 Roma
Tel. (+39) 06.6706.3174 • Fax (+39) 06.6706.6174
basilio.giordano@senato.it • www.basiliogiordano.com

Karravali

Mariateresa Coraggio

ka Fallkunara (Cs)

Nga vit vjen Karravali e nga vit gjith vemi tue gjetur një
masker të pushtroim faqen; e, kur soset Karravali, thomi na
se e nxjerm e jemi njetër gherë na. Ma maskern çë mbam
ngadita, kur e nxjerm? Mah!

Karravali vete e vjen,
vishe maçe o vishe qen?
Vishe burr o vishe grua?
Tundu, vishu e ea me mua.
Vemi, shkoim gjith katundin,
vemi te ku ma mundim.
Kush na jep buk, kush ver,
kush thot “Eni njetër gherë”.
Tue ditur mbidhemi mu shpi
e të shurbenj ngë vete far njeri.

IL CARNEVALE - Ogni anno arriva il Carnevale, e tutti
cercano una maschera per coprirsi il volto, convinti che, una volta
finita la festa e tolta la maschera, ognuno ritorna ad essere se
stesso. Ma la maschera che portiamo tutti i giorni, quando la
toglieremo? Mah!

*Il Carnevale va e viene, / ti vesti da gatto o ti vesti da cane? / Ti
vesti da uomo o da donna? / Sbrigati a vestirti e vieni con me. /
Andiamo in giro per tutto il paese, / fin dove possiamo arrivare.
/ Chi ci dà pane, chi vino. / Chi ci invita a ritornare. / All'alba
rientreremo a casa / E nessuno andrà a lavorare.*

Kuruljat

Zef Beccia

ka Kazallveqi (Fg)

Ka udha çë qen mbë Katundri (= Katund i ri), ta qana Beçit, ta një
copë dhë dhë, çë loshi i lju tëtës e çë tata më lju mua, isht një pus,
çë gjith njohijn si gjall pusi Beçit.

Ki pus, kur çë bëi shumë të ngroht, shuei etën të shumë gjënjra.
Ki pus isht i vogël e pak funu, ma viell ujë dhë dimbër e dhe kur
bën shum të ngrohët. Ujtë rriedhë ta një kanaliq. Këtù, ndëmest a
di qupa ishin katër kurulja të medhenjra çë duhshin di burra pët i
zëin. Kur bëi të ngrohët, gjith deljat, dhit e derrat çë vein a patisin,
rriin ndën mureias tëkuruljat. Sipër kuruljat zogit bëin falet. Ma
baketat të kuruljat bëin shportat, panarat, rrateljat e kanistrat.
Shkoti moti, kuruljat u thaitin e i vun ta zjarri. Nani u mbiet një
cung i that.

I SALICI - Lungo la strada che porta a Casalnuovo, nella piana dei
Beccia, in un pezzo di terra che il Nonno ha lasciato a mio padre e
che mio padre ha lasciato a me, c'è un pozzo che tutti conoscono come
il “pozzo dei Beccia”. Questo pozzo, d'estate, spegneva la sete di molta
gente. Questo pozzo è piccolo e poco profondo, ma vomita acqua
d'inverno e d'estate. L'acqua scorre lungo un rigagnolo. Qui, in mezzo
a due pioppi c'erano quattro salici giganteschi, occorrevano due
uomini per abbracciarli. D'estate, tutte le pecore, le capre ed i maiali
che si abbeveravano, si riposavano all'ombra dei salici. Sopra i salici,
gli uccelli nidificavano. Con le bacchette dei salici si
confezionavano le ceste, i panieri, i graticci ed i canestri. E'
passato il tempo, i salici si sono essiccati e sono finiti nel fuoco.
Adesso è rimasto solo un tronco secco.

Tekste nga një skoghë arbreshe

Giuseppina Demetra Schirò

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Serra te ku Peleghrinët punojën gjellën, dashurin, ëndrrën edhe Çampërat

Serra te ku Belamantërat i mësojën Dadunëvet e Tabunelëvet të dashurojën

Gjithë këto mënd i gjesh sipër Tavullinit, ndanëz Ricëvet përposh Struballëvet e përpara Ogjasolëvet

Po bun bëzonjë një Frungarel që të qell te strata ku rri Dubarelja

Të jarrënit përpara Tavullinit isht një Tutunie që shet suvenir e isht ajo që ruan Qavetën sa të zbillënj Serrën e zgjuar nga Pagjacërat

(Piana degli Albanesi, Istituto Comprensivo Skanderbeg - Scuola Media - Classe 2C)

Maries

Ishe e vogël e vogël e nani ngë je më me ne.

Më lipse shumë por je me t'ën'Zonë.

Ti ki t'ishe në mes neve

Por gëzzone me mjegulliçëlet.

Nga qielli më vren me siun i zgjuar kur los

e je një skaj e trishtuar

se dishëpëlqenem për tij.

Më vjen të kla ndersa shkruanj,

por pranë mendonj se edhe ti je e trishtuar

e bunj një gaz i lagur nga lotët time.

(Alfredo Venturella, Istituto Comprensivo Skanderbeg,

Scuola Media, 1 B)

Hora jime

Shtruar tek ajo fushë

hapet ka një mal e njetër

ndanëz të motrës së vogël

thërritur me embër tjetër.

Lagur nga brigje

e ki isht nder të math

isht një horë me prapa

një mal që i nget

një pamje pa fjalë.

Me klishët e monumentet

i jep mësim edhe të keqëvet.

Ka pesëqind vjet që nduris kjo ëndërr

isht një horë që të thërret.

Gjithë këto me një fjalë:

Hora e Arbëreshëvet.

(Pennacchio Andrea, Istituto Comprensivo Skanderbeg,

Scuola Media 1 B)

Të ngrënë të një hershëm

vjen ka faqja 13)

ndër dherat o ta kopshti që gjithnjari ndë i kasha qëruar mirë mirë e brënda ndodhij tultë a ashtit, veshët, buzan, kocan, këmbët, bishitin, brinjat e kurrizin ma ca pepdhinë të fortë që të djegë e të përvëlone grikan e i pëlqenë shumë kujt di të a duronjë e do pirë shumë verë për të shuanjë të djegurane e të përvëluar a grykës. Kur bij dhëbora e mblidhij rela rela, bëjan shpejt shpejt "surbetin"

La Serra dove i Pellegrini coltivano la vita, l'amore, il sogno e persino i Ciampa

La Serra dove i Bellamanti insegnano ai Dadoni ed ai Tabunelli ad amare

Tutto questo lo puoi trovare sopra i Tavullini, accanto i Riz, sotto gli Struball e davanti ai Ogghiasul, ma occorre un Frugare che ti guidi verso la strada dove abita Dubarelja. Arrivati davanti al Tavullin c'è una Tutunia che vende i souvenir. Ed è la custode della Chiavetta per aprire la Serra animata dai Paghiazzi.

La mia piccola Maria

Eri piccolina e sei andata già via.

Mi manchi da morire ma ora sei con Dio.

Tu dovresti essere con tutti noi.

Ma ora ti diverti con le nuvolette.

Da su mi guardi con l'aria furba mentre gioco

e sei un po' triste

quando mi dispero per te.

Mi viene da piangere mentre scrivo,

ma poi penso che sei triste pure tu

e faccio un sorriso bagnato dalle mie lacrime.

Il mio paese

Adagiata in quella valle

che da monte a monte si espande,

con accanto sua sorella minore che per distinzione ha un diverso nome.

Bagnata da sponde

per cui è un grande onore

è un paese che ha dietro

un monte meritiero

di un paesaggio mozzafiato.

Con le sue chiese e monumenti

infonde cultura anche ai maldicenti.

Da 500 anni è un sogno che si espande

è un paese invitante.

Tutto questo è una sola cosa:

Piana degli Albanesi.

ma dhëboran e mjarkotin që ishtë mushti rrushit i ziar e i firastë, na pëlqej shumë e të mbdhenjat na thojan të mos të hajam shumë anëmos natan përmirjam shtratin. E ndë ato ditë dimri shumë të ftohta, tura u ngrohur ta vatra, pë të shkojan ngenë, piqjan ta pushi e ta hitë: patafat, kështenjat që kishan vluar ndën rerës pë të mos thahshin, dardhat dimri e mollat llimonxhellë shumë të ëmbla të vjerra ma një kërrabë druri ta huri shpisë, lëkënga ndën hisë të rravuluar ma ca kartë xhurnalli, bathë, qiqra të pjekura e koqa ghardhini të plasur si "popkornat". Ma këta të ngrëna të terij

(ec te faqja 32)

Epistollari Arbëresh

E PARA e DIEL e KRESHMEVET

Nga letra e Palit Ebrejvet (11, 24-26, 32-40)

Për besë Moiseu, kur u rrit, nëng dish të thërritej bir i së bilës së Faraonit, dhe zgjohet më shpejt të pësonej bashkë me popullin e Perëndisë, se të kish, për pak mot, gëzimin e mëkatit; gjykoi pësimin e Krishtit një bëgatëri më të madhe se thesaret e Egjiptit. Me të vërtetë ai ruani rrogën e taksur. Dhe çë të thom më? Sepse do të më mungonij moti të flisja për Jedheonin, Barakun e Sampsonin e Jeftin, Davidhin, Samuellin edhe Profitët: të cilët, për besë, mundëtin rregjiëri, vepruan drejtësi, muartin të taksurat, shqyeytin golat e luanëvet, shuajtin fuqinë e zjarrit, i pështuan presjes së shpatës, muartin fuqi ka pafuqia e tyre, u bënë të fortë ndë luftë, reshtin ushtëri të huaja. Disa gra muartin të gjallë të vdekurit e tyre, të tjerë pra u rrahëtin, e s' dishtin lirim, se të kishin një ngjallje më të mirë. Të tjerë pra duruan përqeshje dhe fërshëra, hekure e filaqi, qenë vrarë me gurë, qenë prerë me serrë, qenë torturuar, vdiqin të vrarë me shpatë, vanë këtej e atej të veshur me lëkurë dhensh e dhish; të nëmur, të mjerë, të trajtuar keq; jeta nëng ish e denjë për ata, e shkuan atej e këtej ndëpër shkretira e male e shpella e gropa të dheut. Dhe këta të gjithë, çë bënë martri për besën, nëng muartin të taksurën, sepse Perëndia kish parapërgatitur një gjë më të mirë për ne, se të mos të bëshëshin ata të përsosur pa neve.

E DYJTA e DIEL e KRESHMEVET

Nga e para letër e Palit Ebrejvet (1,10-2,3)

Ti, o Zot, në fillim themellove dheun dhe qielt janë vepra e duarvet të tua; ata grisen po ti qëndron; dhe të gjithë do të vjetërohen si një veshje, dhe do t'i pështielesh si një mandjel dhe do të ndërrohen; po ti qëndron i njëjti, dhe vjetët e tu nëng do të mbarohen. Cilin, ndër ëngjëlit, i tha ndonjeherë: "Ulu ka e djalhta ime, njera sa të vë armiqtë e tu si kumbim i këmbëvet të tua"? Nëng janë të gjithë shpirtra çë shërbejën, të dërguar se t'i shërbejën atyre çë do të kenë shpëtimin? Për këtë duhet të kemi më shumë kujdes për ato çë gjejtim, se të mos të biremi. Se ndëse fjala e thënë me anë të Ëngjëlvet u buthua e vertetë, dhe çdo shkelje e mosgjejtje mori një dënim të drejtë, si do të shpëtohem i na ndëse nëng do të kujdesemi për një shpëtim kësij? Ky zu e u predikua ka Zoti, dhe u vërtetua, ndë mes të neve, ka ata çë e gjejtin.

E TREJTA e DIEL e KRESHMEVET

Nga letra e Palit Ebrejvet (4,14-5,6)

Vëllezër, sepse na kemi një kryepriut të madh, çë përshkoi qielt, Jisuin të Birin e Perëndisë, le të mbajmi fort besimin. Se nëng kemi një kryepriut çë s'mund dhëmbet për sëmundjet tona, po çë qe provuar ndër të gjitha si na, veç se të mbëkati. Prandaj le t'i afrohem i qasemi me besë thronit të hirit, se të marrim lipisi dhe të gjejm i hir për ndihmën, te moti i duhur. Me të vërtetë çdo kryepriut, i marrë ka njerëzit, për njerëzit vëhet për shërbiset ç'i

(puar arbërisht) **protopapasi Emanuele Giordano**

ka Frasnita (Cs)

ngasën Perëndisë, se të japë dhurata e sakrificë për mëkatët. Ai mundën të ndienjë dhëmbje për ata çë janë në padije e në gabim, se edhe ai është i përveshur me sëmundje; dhe për këtë duhet të dhuronjë sakrificë për mëkatët, aq për popullin, sa edhe për vetëhenë. E mosnjëri mund t'e marrë vetë këtë ndërë, po vet ai çë thërritet ka Perëndia, si Aroni. Kështu edhe Krishti s'mendo i vetë të bëhej kryepriut, po e bëri ai çë i tha: "Ti je im Bir, sot unë të leva", si thotë edhe te njetër vend: "Ti je priut për gjithmonë, sipas urdhërit të Melqisedhekut".

E DIELA e KATËRT e KRESHMEVET

Nga letra e Palit Ebrejvet (6, 13-20)

Kur Perëndia i taksu Avramit, sepse nëng kish njetër më të madh mbi kë të bënjë bé, bëri bé mbi vetëhenë e tij e tha: "Me të vertetë, tue bekuar, dua të të bekonj e të të rritënj shumë". E ashtu Avrami me zëmër të madhe, tue pritur, pati të taksurat. Ndërsa njerëzit bëjën bé mbi më të madhin, edhe beja është për provë sa të mbarohet çdo kundështim ndër ata. Kështu edhe Perëndia, sepse dish të buthtonij, atyreve çë kishin të trashëgojnë të taksurat, se vëlma e tij ish e patundshme, bëri bé mbi vetëhenë e tij. Ashtu çë, për dy akte të patundshëm, ndër të cilët Perëndia nëng mund të gënjenjë, na vëmi mbulesën tek ai e mund të kemi shpresë tek bekimi i tij. Tek ai kemi një lidhje të sigurtë për jetën tonë. Ajo hyn njera mbananë tendës shëjtërore, ku Jisui hyri si parëndës për ne, tue u bërë kryepriut për gjithmonë, sipas urdhërit të Melqisedhekut.

E DIELA e PESTË e KRESHMEVET

Nga letra e Palit Ebrejvet (9,11-14)

Vëllezër, Krishti erdhi si kryepriut i të miravet të ardhshme, për anë të njëi tendje më të madhe e më të përsosur, jo të bërë ka dorë njeriu, domethënë nëng ish të kësaj krijesje. Ai hiri një herë për gjithmonë tek tempulli, jo me anë të gjakut cjeptsh e viçrash, po me gjakun e tij të vetë, tue na merituar kështu një shpëtim për gjithmonë. Me të vertetë, ndëse gjaku demash e cjeptsh, e hitë e njëi lopezje, të shprishur mbi ata çë janë të zhyer, i shëjtëron e i pastron tek mishtë, sa më shumë gjaku i Krishtit, - çë, me anë të Shpirtit të përjetshëm, i dhuroi Perëndisë vetëhenë e tij të panjollë - do të pastronjë ndërgjegjen tuaj ka veprat e vdekjes, se t'i shërbeni Perëndisë të gjallë?

E DIELA e DHAFNËS

Ka letra e Palit Filipjanëvet (4,4-9)

Vëllezër, gëzoheni te Zoti gjithmonë; ju e thom njetër herë: Gëzoheni. Mirësia juaj le të njihet ka të gjithë njerëzit. Zoti është afër. Mos llaveni për faregjë. Po, te çdo nevojë, bëni t'i njohë Zoti lypsjet tuaja me lutje dhe me të

(ec te jetra faqe)

Marg Scilippa

nga Hora e Arbëreshëvet (Pa)

ARBËR

Te qetësia e natës
melodi të përmallshme
kitarra i bij
tuke përkujtuar
një dhe të largët e të panjohur
një atdhe të zbjerrë.
Na rreth ulur
tuke kënduar rrijëm
të Bukurën More.
Sytë tanë shkëlqejën
si zyet e atij qielli gushtor,
një dashuri e moçme zgjohej
si për magji,
një flakë e gjallë dhizej
te zëmrat tona:
krenaria të jemi arbëreshë!

ALBANESITA' – Nella quiete della notte / melodie nostalgiche / la chitarra suonava / ricordando / una terra lontana sconosciuta / una patria perduta. / Noi stavamo intorno / seduti cantando / la Bella Morea. / I nostri occhi brillavano / come le stelle di quel cielo d'agosto, / un antico amore si risvegliava / come per incanto, / una viva fiamma s'accendeva / nei nostri cuori: / l'orgoglio di essere arbëreshë!

Epistollari Arbëresh

(vjen ka faqja 16)

falur, bashkë me falënderim, dhe paqja e Perëndisë, që përshkon çdo mendje, do t'i ruanjë zëmrat tuaja te Krishti Jisu. Në të ardhmen, o vëllezër, gjithë ato që janë të vërteta, bulare, të drejta, të pastra, të dashura, të nderuara, ëmërmira, të virtutshme dhe të lavdëruara, këto mendoni. Ato, pra, që mësuat e muartit e gjegjtit e patë tek unë, ato bëni; e Perëndia i paqës do të jetë me ju.

E SHËJTJA dhe E MADHJA E DIEL e PASHKËVET

Nga Punët e Apostulvet (1, 1-8)

O Teofil, të parin fjalim e bëra mbi të gjitha ato që Jisui bëri e mësoi që të parzën herë, njera te dita që, pra që i dha urdhëra me anën e Shpirtit

Giuseppe Gallo

nga Shën Marcani (Ta)

MENDJA

Njori punë ikët
ashtu si ikët
mendja.
Mendja arrën largu
më nxitu se drita
e sheh.
Sheh venda e veta
parë, e herë harehët,
herë namarisë.
Mbase mendja ishte
siu i shpirtëti.
Nga kaq sheh vende
që njori sheh.
Kur e bën të kërkoj
pë të gjej vendët
ku jesën të vdekurët
që shoh ndë gjumë
lodhët kaq se bën
të më flej zëmëra
e nëng i shoh.

LA MENTE - Nessuna cosa corre / come corre / la mente. / La mente arriva lontano / più velocemente della luce / e osserva. / Osserva posti e persone / già viste. E a volte gioisce / e a volte si immalinconisce. / Forse la mente / è l'occhio dell'anima. / Ogni tanto vede luoghi / che nessuno vede. / Quando la invito / a cercare i luoghi / dove sono i morti / che io vedo nel sonno / si stanca così tanto / che mi fa addormentare il cuore / e non li vedo.

Shëjtë Apostujvet që kish zgjedhur, u hip në qiell. Atyre, pra që pësoi, ju buthtua i gjallë me shumë shëngje, për dyzet ditë, tue ju buthtuar e ture i folur mbi rregjërinë e Perëndisë. Dhe si i mblodhi, i urdhëroi atyre të mos të llargohëshin nga Jerusallimi, po të prisjen të taksurën e Atit, "atë që gjegjëtiti ka unë; se Janji pagëzoi me ujë, po ju do të pagëzoheni me Shpirt të Shëjtë pas pak ditësh". Ata, pra, si u mblodhëtën, e pyejtin: "O Zot, te ky mot e ngrën rregjërinë e Izraillit?". Po ai i tha atyre: "Nëng ju nget juve të njihni motet dhe herët që Ati mbajti në zotërinë e tij. Po ju do të mirni fuqi kur të vinjë mbi ju Shpirti Shëjtë; dhe do të më jini martri në Jerusallim e në tërë Judhenë edhe në Samarinë, dhe njera ndër kufinj të më të llargët të dheut".

Tommaso Campera

nga Mashqiti (Pz)

NJË PARKALESJA KRISHTIT

Kurorur ma glëmbe ferrash
e lidhur ma tërkuzua përgjakura
... të qolltin, oj Zoti Krishti
përpara Pillatit, që laj dorat.
Tij, oh i Lartëshim Perëndia
... që t'gjithë na krijova
tura nxjerur arrësirat nga mendjat
na ndeza dritan, të shihjam udhan
të prun përpara popullit që - t'pabesë -
të dënuan: Tijë që na pështova
nga arrësirat ... e nga zarri pisëvat.
Të qolltin mbi mali Kallvarit
ku të ngriqëtën - ma goxhda hekurash -
po Ti, moj Zot, i lipa tit etit ndëlem
për në:
Ti vëdisja, Perëndia, e dheu u hapë
pë ftesan a madha që, përhershim
... na lijtë shpirtin.
Marur nga arrësirat klen qiallat,
u hapëtën kataratat:
e rran shirat - lotë tit etit -
pë ki mbëkat t'madhë.
Të vun, moj Zot, ta vorra
që, ndë t'tretin diti, u hap
e Ti - i ringjalluar - hipa ndë qiallat
ult ta a djathta tit etit:
të jet ashtu adhe për në
ndë heran të vdekja jona.

UNA PREGHIERA A CRISTO -

Incoronato con spine di rovo / e legato con corde insanguinate / ... ti portarono, oh Signore Iddio, / davanti a Pilato, che lavava le mani. / a Te oh Altissimo Iddio / ... che tutti noi hai creato / scacciando le tenebre dalle menti / ci accendesti la luce, per vedere il cammino / ti portarono davanti al popolo che - increduli - / ti condannarono: a Te che ci salvasti / dalle tenebre ... e dal fuoco degli inferi. / Ti portarono sul monte Calvario / dove Ti crocifissero - con chiodi di ferro - / ma Tu chiedesti a tuo padre perdono per noi: / Tu morivi, Iddio, e la terra si aprì / per il nostro grande peccato che, in eterno / ... ci macchiò l'anima. / Presi dalle tenebre furono i cieli, / si aprirono le cataratte: / e caddero le piogge - lacrime di tuo padre - / per questo grande peccato. / Ti misero oh Signore, nel sepolcro / che nel terzo giorno, si aprì / e Tu - resuscitato - salisti nei cieli / seduto alla destra di tuo padre: / sia così anche per noi / nell'ora della nostra morte.

Nebih Bunjaku

nga Prishtina

DHEMBJA IME KRENARE

Rozafë – dhembja
ime krenare
Dil Hirësi
nga murana
Mjaft u krodhe
në flijime
Gjallë të do
ty Barbana
Puthja djalit
në sy lotin
Tre mijë vjet
s'të ka parë
Veç për ty
e ka marrë malli
Loti i shpirtit
iu ka tharë
Ti e rrite
me qumësht guri
Me këmbë të djathtë
e përkunde
Me sy zemre
e shikove
Me dorë t'artë
e ledhatove
Me ninulla
e bekove
Granit është
kështjella ilire
Kurorë lulësh
Iliria
Me tri vajza
si perria
Dardania
Çamëria
dhe Shqipëria

Jusuf Zenunaj

POPULLI DO PRANVERË

Gjaku për karrige pse derdhet sot,
nënat e motrat pse të derdhin lot ?
Pse t' ofshan plaku e të qajë fëmija,
Për qejf të dikujt vendin mbuloi zija ?!

Heshtur kanë zogjët edhe pse s' ka borë,
dhimbja ka pushtuar Çamëri e Kosovë.
Pikëllimi mbërriu kudo në Mërgatë
dita e sotme për ne u bë natë.

Gjaku në Tiranë na zyri frymën,
populli do pranverën,
S'ka nevojë për dimër.

(23 janar 2011)

Zhaneta Ogranaja Habazaj

nga Tirana

JETARBËRESHE - PËRSHËNDETJE

Në fluturimin tënd të të ndjek shpirti im i dliirë i do
Të dliirën rrugë që ke nisur Jetarbëreshe, ti
Shpresa e eterit më solli mua në atë hapësirë. Beso
Që unë ty të të përshëndes me disidenten poezi

Jetarbëreshe të përshëndes nga Tirana jonë magjiplotë, ty
Ty që shkruan ende me gjuhën e bukur shqip
Me nja dyzë vargje sot po të vij në gjirin tënd aty
Duke përshëndetur tërë arbëreshët me nderim këtë ditë

Sidomos përshëndes të dhimbshmen tuaj histori
Ju, mbi pesëqind vjet me atdhe e pa atdhe
Nga rrebeshet e huaja, nga ato stuhi
Ju adhuroj qëndresën gjersa gjuhën shqipe e ruani të shenjtë dhe e flisni ende

Jetarbëreshe, ti dielli që derdh rrezet ujëvarë si flori sot
Tej e tëhu botës ti dritë rrezëllore
Kapërcen fusha, male e det me përsosmërinë, angazhim të programuar
besëplotë
O Mirësevjen fat i bukur arbëresh në Shqipëri në trojet tona arbërore
me përkushtim e dashuri prore

Në fluturimin tënd të të ndjekë shpirti im ka dëshirë
Me zërin që del thellë nga shpirti im
Për përkryerjen e shpirtit e të dinjitetit, për jetën e botën për të përtërirë
Jetarbëreshe Zoti e bekoftë këtë bashkëpunim

Jetarbëreshe e bukur si ditë
Tani kur mbi ty unë hedh vështrimin
Je për mua dielli rezear tërë dritë
Ti më zgjon thellë në gji fantazinë e frymëzimin

Bajame Hoxha Çeliku

nga Tirana

UNË ME TY

Oh, të desha çdo natë mes ëndrrave të të gjeja
Mes ëndrrave të të gjej, i lutem Zotit edhe tani
Se, vetëm në ëndërr të puthja, të prekja, ishe i imi
Veç në ëndërr, kam bërë dashuri, unë me ty.

Aty në ëndërr, ëmbëlsisht, unë njoha prekjen e parë
Nëpër ëndërr kam njohur pasionet e forta stuhi
Ta dish! Në ëndërr kam bërë dashuri si putanë
Në shtrat vërtetë, s'kam qenë kurrë, unë, me ty.

Eh sa bukur! Unë vajzë e re vrapoja
Pranvera më lulëzonte shumë ngjyrshë në sy
Unë isha një vajzë e mitur akoma
kur papritur, rrahjet e zemrës, i njoha në gji.

Natën, gjumi më çonte gjithnjë ndër trazira
dhe zemra më rrihte aq fuqishëm për ty
ëndrrat më fushnin nëpër çudira
Nëpër gjumë, e mora dhe puthjen nga ti.

Pikëpamjet e Kolë Kamsit mbi Italo-Arbëreshët

prof.dr. Imri Badallaj

Universiteti i Prishtinës

Shkollimi dhe qëndrimi i gjatë i Kolë Kamsit në trevat italo-arbëreshe, në mënyrë të veçantë mbolli dashurinë ndaj trashëgimisë gjuhësore, folklorike e letrare të tyre.

Ndihmesat e tij, së paku të publikuara deri më sot, janë fokusuar në mbarë jetën dhe kulturën arbëreshe, por të folmet dhe sidomos leksiku, padyshim paraqet interes të veçantë, siç thoshte ai, sepse brenda tij ruhet një stad i hershëm i shqipësisë, kur edhe ndikimet e gjuhëve të tjera kanë qenë shumë më të vogla seç janë sot.

Në studimin e të folmeve arbëreshe Kamsi ka vërejtur dy dukuri të rëndësishme gjuhësore: përbashkësinë me shqipen dhe njëjtësinë në shumë segmente fonetike, gramatikore dhe në fondin leksikor e frazeologjik.

Ai duke qëmtuar me një zell të pasohq materie gjuhësore kudo që shkeli këmba e tij nëpër ngulimet arbëreshe, ka hetuar fjalë të moçme, të cilat datojnë edhe para Mesharit të Buzukut, që pa dyshim ky fenomen u bë shumë tërheqës për këtë filolog.

Krahas këtij fondi të vjetër fjalësh fort të begatë, ai hetoi në këto mjedise edhe këngë e valle burimore, veshje dhe zakone, që i dukeshin se nuk janë prekur fare nga ndikimet e dheut të huaj. Thellësisht i mahnitur nga kjo larmi etno-folklorike dhe ligjërimore, që posedonte bota arbëreshe, këtë studiues e bëri sa kureshtar, aq edhe të përkushtueshëm, që të eksploronte sa më shumë fjalë, frazeologjizma e shprehje të rralla.

Të gjitha këto aspekte ky i vëzhgoi nga zanafilla, duke u nisur nga veprat e para italo-arbëreshe, që nga *E mbusuame e krështerë* e Lekë Matrëngës (1592), duke i parë në vijimësi edhe veprat e autorëve të tjerë, që panë dritë, kur edhe Kamsi vetë bënte shkollën e tij në Kolegjin e Shën Adrianit.

Kërkimet shkencore, që ky i bënte, i mbështet dhe i krahason me publikimet e autorëve të tjerë arbëreshë dhe të huaj. Kjo mënyrë e punës kërkimore-shkencore ia mundësonte thellimin e analizave të mbështetura në argumente dhe arritje shkencore, që përkonin me kohën kur Kamsi i kishte shtrirë vrojtimet e tij.

Në vështrimet gjuhësore, gjithmonë për bazë pati materialin faktik të të folmeve italo-arbëreshe, por dorëshkrimet e ruajtura nëpër arkiva dhe fonde private, kanë qenë një nxitje e veçantë, që në rezultate të jetë shumë produktiv dhe i saktë.

Dëshmi e kësaj pune hulumtuese janë një mori shkrimesh, por dy vëllimet: *Shqiptarët e Italisë* (2006) dhe *Fjalor arbërisht-shqip* (2000), janë pasqyra më e ngjeshur dhe fort e thelluar në produktivitetin e tij shkencor mbi arbëreshët dhe gjuhën e tyre.

Ai kishte vërejtur se arbëreshët gjithmonë kishin qenë njerëz krenarë dhe të pajisur me një shpirt të fort etnik, që si të tillë në të kaluarën nuk duronin prepotencën e baronëve, dhe nëse pësonin një padrejtësi ose edhe për t'iu mos u nënshtruar tatimeve dhe taksave të rënda, digjinin edhe kasollet e tyre dhe mermin udhë për në toka të reja.

Mirëpo, kah fundi i shekullit XVI dhe nga fillimi i shekullit XVIII formohen bashkësitë e vërteta arbëreshe me ritin e tyre fetar kryesisht greko-bizantin dhe më pak në ato fillime me ritin latin.

Riti i tyre fetar, që e sollën nga mëmëdheu, pa dyshim që ndihmesa më e fuqishme për ta ruajtur gjuhën e të parëve të tyre, por doket, zakonet dhe festat që i përcillnin brez pas brezi, i mbanin fort të lidhur mes vete, duke mos pushuar kurrë së menduari për Arbërinë e lënë këndej deteve.

Të gjitha këto fakte, Kamsi i pasqyroi me dinjitet e pasion shkencor në dy vëllimet e zëna nga një sipër, por *Fjalori i shtrirë në 377 faqe* ngërthen një lëndë leksikore, që jo vetëm të zgjon kërshërinë, por ai të merr e të bën për vete në tërësi, që në asnjë mënyrë pa e studiuar, s'mund t'i ndahesh, nga se kjo vepër gjuhësore është pasqyra më e ndritur dhe më e realtë e integritimeve të mbarë proceseve gjuhësore të komunitetit italo-arbëresh.

Identifikimi i fjalëve nga pikëpamja semantike, Fjalorit i jep dimension sa shkencor, aq edhe tërheqës për përdoruesit e tij, sepse materia leksikore e shtruar mbi faqet e tij është e mbushur me shprehje, fjalë të urta e frazeologjizma, që gjithsesi dukshëm shprehin mrekullinë e arbërishtes.

Lirshëm mund të themi se Fjalori i Kamsit paraqet një thesar gjuhësor fort të çmuar, që për ata të cilët bëjnë punë shkencore në fushat gjuhësore e më gjerë, është një shtysë për hulumtime edhe të tjera në ligjërimet italo-arbëreshe.

Edhe për mbarë shqipen vepra në fjalë paraqet një dhunti të veçantë, aq më tepër, kur dihet mirëfilli se vetë arbërishtja brenda lehdave të saj, edhe sot e kësaj dite me një ambicie të paparë ruan fjalë e shprehje, që gjëkund s'mund t'i gjesh. Prandaj, ky erudit i vyer dhe fort i madh pas vetes ka lënë një produkt shkencor, që për të interesuarit, që të mësojnë mbi arbëreshët dhe gjuhën e tyre, paraqet një begati fort të rrallë shkencore.

La lunga permanenza di Kolë Kamsi nelle contrade italo-albanesi fece nascere in lui l'amore verso la loro eredità linguistica, folclorica e letteraria. I suoi contributi sulle parlate e il lessico arbëresh, poi, sono di particolare interesse. Nelle sue ricerche il Kamsi ha rintracciato parole anteriori al Meshar del Buzuku, canti e ridde originali, costumi e tradizioni, per nulla intaccati da influssi stranieri. Le ricerche scientifiche sul campo il Kamsi poi le ha confrontate con altre pubblicazioni di autori arbëreshë e stranieri. E i manoscritti conservati in archivi o fondi privati l'hanno molto stimolato ed aiutato ad ottenere risultati notevoli e precisi. A testimoniare questo lavoro di ricerca del Kamsi bastano i suoi due volumi "Gli Albanesi d'Italia" (2006) e il "Dizionario arbëresh-albanese" (2000).

Il Kamsi nota come gli Arbëreshë siano sempre stati orgogliosi e dotati di un forte spirito etnico. E il loro rito greco-bizantino, portato con sé dall'Albania, fu senza dubbio il loro aiuto più forte nel difendere la lingua dei loro padri, e usi, costumi e tradizioni, che hanno gelosamente tramandato di generazione in generazione.

Il Dizionario del Kamsi è un tesoro prezioso, un impulso per altre ricerche. Perché la lingua arbëreshe, ancora oggi, conserva parole ed espressioni che difficilmente altrove si trovano.

Mes imazheve dhe mirazheve në poezinë eliptike të Buzëdhelprit

Alisa Velaj M.A.

Universiteti "A.Moisiu", Durres

Të shprehurit lakonik është një koncept që ka mbërritur deri në ditët tona prej krahinës së Lakonisë në Greqinë e lashtë. Plutarku rrëfen në veprën e tij *Jetët paralele* se burrat e kësaj krahine ishin të kursyer në fjalë e kuvend dhe me një fjali të vetme shprehnin thelbin e një ligjërate të tërë. Terma të tillë të teorive moderne letraro-gjuhësore si ekonomizmi gjuhësor apo të shprehurit eliptik nuk janë gjë tjetër veçse reminishenca të largëta të së folmes së famshme të burrave të krahinës së Lakonisë. Shekuj më vonë poezia hermetike italiane e rrokte përgjithësisht thelbin e sendeve dhe dukurive në fare pak vargje, duke i qëndruar besnike të shprehurit eliptik në poezi. Kjo lloj poezie është tepër e vështirë për t'u lëvruar, pasi përmbledh në një minimum vargshes disa shtresëzime kuptimore. Prandaj poetët që pijnë ujë në burimet e saj janë përherë të paktë në numër. Poeti arbëresh Agostino Giordano (Buzëdhelpriti) ofron një nga modelet më të spikatura në këtë drejtim, jo vetëm në poezinë arbëreshe, por në krejt poezinë shqiptare në përgjithësi. (Kujtojmë këtu poetin më të madh arbëresh Jeronim De Radën, i cili në poemën e tij *Këngët e Milosaos na shfaqet si një poet tepër eliptik*). Me të drejtë gjuhëtari i nderuar prof Gjovalin Shkurtaj, tekta analizon tiparet më të qenësishme të poezisë së Buzëdhelprit shprehur: "Me një fjalë mund të themi se Buzëdhelpriti hyn në llojin e poetëve të kursyer që matet shumë e shumë para se të lëshojë vargun në letër, që nuk e fal këmbadoras poezinë e tij". Poezitë eliptike të poetit bashkohor arbëresh trokasin në vetëdijen e lexuesit si shëmbëlltira imazhesh, të cilat në një pjesë të mirë të tyre janë të ngjizura me embrionin mall.

"Je një vetijë që i thërret për mallimet e veta/me të njëjtin tërbim të stuhisë". (Për ty arbëresh)

Mall i lindur prej mungesës së një Itake aq shumë të ëndërruar, të cilën arbëreshët e mbartën përherë në shpirt, ndërsa poetët e tërë brezave i dhanë përjetësinë me vargjet e tyre. Shpirti i arbrit rron kudo në krijimtarinë poetike të Buzëdhelprit. Jo vetëm përmes gjuhës së bukur arbëreshe, që në penën e tij, na ka dhuruar vargje aq të freskët, por edhe përmes dhimbjes therëse që poeti ndjen, kur sheh që kjo gjuha është harruar në ndonjë katund. Në poezinë "Një katundi që nuk flet më arbërisht" poeti nënkupton se një qenie që ka bjerrur kuptimin e dheut të të parëvë, ka humbur tragjikisht një pjesë të vetvetes...

Poezia erotike e Buzëdhelprit mbart gjithashtu në thelbin e saj imazhe të trishta malli. Mall për ëndrra që nuk arrin dot t'i trupëzosh, Dhimbje për vashën që nuk e ka pranë, kujtimin e së cilës e mban të ngjizur përmes ëndrrës. E dashura e zembrës shfaqet përherë si një prani e munguar, duke i dhënë poezisë ngjyresa melankolie dhe aty këtu, klithma të heshtura dëshpërimi. Trishtimi i bukur që ngjiz poezinë e tij erotike të kujton hera-herës, poetin tjetër arbëresh, Zef Seremben. Ashtu si në krijimtarinë e këtij të fundit, dhimbja e dashurisë në poezinë e Buzëdhelprit merr nuanca të forta ekzistenciale. Por ndërsa poezitë e Serembes janë vajtime gati "epike", si për nga denduria e vargjeve, ashtu dhe nga denduria e ndjenjave dhe mendimeve, poezitë e Buzëdhelprit janë thurina imcake, ku dramaciteti mbartet brenda detajit poetik, karakteristikë thelbësore kjo e poezisë eliptike.

"Natën/mall/të gjenj në shtegun e ëndrrave/ditën,/të bjerr në mes të gjindve/ të pafytyrë". (Natën)

Kategori të tilla kohore si e nesërmja, në kuptimin e një të ardhmeje, që një qenie e vdekshme nuk arrin kursesi ta zotërojë, apo e tashmja si e vetmja "pronësi e përjetshme", përplasen tragjikisht në skutat më të thella të ndërgjegjjes së poetit , duke nxjerrë si fitimtare kuptimplote, atë hapësirë kohore që latinët e

kanë pagëzuar me thëniën e famshme *carpe diem*. Në poezitë e kësaj fryme ndihet malli dhe dhimbja ekzistenciale për kohën që kthehet në antikohë. I vetmi tëstament që brezat duhet t'i lënë njëri tjetrit është absolutisht veç e tashmja.

"Shtëllo një pikë vaj/ në bilnar/dhe pyete flakën/ndë e nesërmja/do t' thërresë akoma bir" (E nesërmja është larg)

Plakut/iu thajtin duart/tue kalladhepsur/nga vit/atë dhrinë e egër/që i mban mend të jatit. (Plakut iu thajtin duart)

Imazhet e mallit thirren me aq afsh e dëshirë në kujtesë, përjetohe me dramacitet aq të thellë, sa jo rrallë, në mjaft poezi të Buzëdhelprit ato transformohen në vegime mirazhesh. Vegime shtegtare që e dine mjaft mire se ku e kanë zanafillën e tyre, dhe thyejnë çdo horizont pritjeje të lexuesit, përta si përket drejtim të saktë të rrugëtimit të tyre të pakohë.

"Era troket në dyer/me vajin e zakonshëm/flet për të tjerë trashëgimtarë/zgjon të tjerë trashëgimtarë". (Dhjata e erës)

Këto mirazhe vijnë natyrshëm e pa kurrfarë sensacioni në përjetimet e lexuesit, Ato kanë shkëlqimin e xixëllonjës që i përgjigjet këngës së përballshme të fyellit në erësirë, apo gazit të një vashë në një natë pa hënë. Janë dhjata të shkruara mbi qelq dhe kumte të erërave që ngatërrohen nëpër degët e lisit të baladës. E vërteta qëndron në faktin se këto vegime janë të rrejshme veç në një pamje fluturake, ndërsa në thelb deshifrojnë diç krejt të ndryshme. Me një fjalë kthim sërish në imazhe. Ndoshta për faktin se transformimi i imazheve në mirazhe, e më pas i këtyre të fundit në imazhe, ndodh në një kohë leximi tepër të shkurtër, poeti në mënyrë të pavetëdijshme "i fsheh" këto procese brenda poezive që "shkrepin" sa hap e mbyll sytë, me vargje eliptikë, ku kuptimet dendësohen si ngjyra blu, në thellësitë e atij deti, nga ku shekuj më parë, mërguan dhe stërgjyshërit e poetit Agostino Giordano!

Il poeta arbëresh Agostino Giordano (Buzëdhelpriti) offre uno dei modelli più di spicco dell'espressione ellittica in poesia, non solo nella poesia arbëreshe, ma anche in quella albanese in genere. Le sue poesie bussano alla coscienza del lettore come rappresentazioni di immagini, le quali perlopiù sono modellate sull'embrione-desiderio. La tristezza che modella la poesia erotica di Buzëdhelpriti ti ricorda a volte il poeta Zef Serembe. Così come la sofferenza dell'amore, nella poesia di Buzëdhelpriti, prende forti sfumature esistenziali. Ma mentre le poesie del Serembe sono lamenti quasi epici, come per la densità dei versi così anche dei sentimenti e dei pensieri, le poesie di Buzëdhelpriti sono intrecci dove la drammaticità si trasferisce dentro il dettaglio poetico, caratteristica questa essenziale della poesia ellittica. Le immagini dell'amore si richiamano con tanto calore e desiderio nella memoria, si vivono con drammaticità così profonda, quanto rara, in molte poesie di Buzëdhelpriti esse si trasformano in visioni di miraggi. Forse per il fatto che la trasformazione delle immagini in miraggi, e più avanti questi in immagini, succede in un tempo di lettura molto corto, il poeta in maniera inconscia "nasconde" questi processi dentro le poesie che "scoppiano" in un battere di ciglia, con versi ellittici, dove i significati si addensano come colori blu, nelle profondità di quel mare, da dove secoli addietro, emigrarono anche gli avi del poeta Agostino Giordano.

Mjegulla si pjesë e imazhit poetik të Vorea Ujkos

prof.ass.dr.Laura Smaqi

Universiteti i Tiranës

Poezia e Vorea Ujkos është një ftesë e vazhdueshme drejtuar shkallëve të ndryshme të ndjeshmërisë së çdo lexuesi, që nisnin nga përjetimi i drejtpërdrejtë i bukurisë natyrore, i ndjenjave njerëzore, të përsiatjet mbi jetën dhe vdekjen e deri tek identiteti kombëtar e zëri i etnisë e i tokës shqiptare në të gjitha hapësirat e mundshme të saj. Po ndalemi në një aspekt të ngushtë të paraqitjes poetike të këtyre ndijimeve, që lidhet me një element të pranishëm vetëm në vëllimin e parë Zgjimet e gjakut¹, e shumë pak tek Stinat e mija² – mjegullës, e rolit që ajo luan në imazhin poetik në të cilin ndërftohet. Duke filluar nga imazhi i drejtpërdrejtë i pamjes natyrore (zbriste mjegulla nga kodat / e bashkohej me tymin / e kulmevet lundruese³) – bashkimi i njerëzores – tymi që i bën shtëpitë të duken valëzuese dhe që është produkt i jetës njerëzore – me natyroren, përmes mjegullës që zbret nga kodrat. Bashkë me tufat e zogjve që ikin drejt bregut, ajo është e vetmja lëvizje. Burrat e mbështjellë me mantel pushojnë dhe koha ka ndalur e s'ka as lëvizje, as të nesërme. Në këtë peizazh – natyrë të vdekur, plotësojnë pamjen krahet skeletikë të lisave e të grigjës së zhvarrosur. Vetëm të vegjlit që s'njohin trishtim janë jashtë tablosë.

Në poezinë “Përrallë e vogël”⁴ mjegulla ndonëse në dukje zë vend të kufizuar, është vepruesja kryesore që me paqartësinë e njëtrajtësinë karakteristike krijon izolimin e mungesën e komunikimit. Ajo dhe heshtja janë krijuet e prrallës. Përmes këtyre dy elementeve e figurshma transformon realen, duke arritur të turbullojë ujin e qetë të pusit.

Imazhi i vjeshtës ka si kornizë mjegullën në poezinë “Vjeshtë”⁵. Nis me përshkrimin e shpejtë poetik të mjegullës natyrore që mbështjell ditët me napa të gjata që mbulojnë kodrën, i le vend një përshkrimi të tokës, që prej aromave që shpërthejnë prej saj të ngjyra e “zbehtë” e blerimit që krijon trishtim të ëmbël. Në fillim pamja ndikon mbi gjendjen emocionale, e cila ndien peshën e rëndë të kohës, e më pas është ndjeshmëria ajo që i vesh natyrës pamje të jetës njerëzore. Dielli perëndon mes jastëkësh mëndafshi, kukuvajka hedh thirje vajtuese e jehona e një kënge vjen përmes erës. Dhe tabloja mbyllet me ndjesinë e grisjes së ditëve e ëndrrave, ashtu si mjegulla shtupe. Duke pasur të njëjtin ndërtim me renë, edhe figurativisht jo rrallë reja dhe mjegulla ndërthuren ose i lenë vendin njëra-tjetrës. Një kuptim të tillë të përmbledhur shfaq dhe ky fund poezie, e cila mjegullës që në krye mbështjell ditët, i bashkon mjegullrenë që griset si grisen ditët dhe ëndrrat.

Paralelizmi mes pamjeve reale dhe përjetimeve që përmes asociacioneve lidhen ngushtë me to, është një nga procedimet më të shpeshta në poezitë e Ujkos. Tek “Mall i hershëm”⁶ janë zgjotë që kërkojnë ushqim e menjëherë më pas “boren”, ata që e bëjnë poetin të mendojë se po ashtu, me një fllad e vorbull ere zhduken dhe fjalët e ëndërrat njerëzore, e pastaj vjen menjëherë mjegulla, si sinonim i hiçit që mbulon e përfshin gjithshka.

Frika e ndjesisë së përjetimit të një gjendjeje të ngjashme me natyrën e vdekur mbështjell, me përjashtim të dy vargjeve të fundit, poezinë “Ranishtë”⁷. Vetë era ankohet nga mungesa e reagimit të trupit të përgjumur, ku zemra është si zilja që

tingëllon përtueshëm. Në një shkallë akoma më të zymtë se reagimi tepër i dobët trupor gjendet mendja. Mendimet janë kthyer në shkrepë rëre të mbytura prej mjegullës, mungesa e lëvizjes bashkohet me shterpësinë apo paaftësinë për të gjeneruar diçka të re. Përmbytja e mendimeve prej mjegullës është akti më normal e më i natyrshëm për të plotësuar imazhin e hiçit. Në këtë rast nuk është ajo “fajtores” e gjendjes, por plotësuesja që përmbyll një imazh e atmosferë të dhënë shpirtërore. Në kontrast të plotë me këtë tablo, toka nuk ka qetësi, por nxjerr avuj të ngrohtë jete. Ajo e bën poetin të pyesë veten për aftësitë e tij përtëritëse. Dy vargjet e fundit janë thirrje besimi e shprese se ashtu si një fllad prej detit do të vijë...kush? – burimi i përtëritjes.

Tek “Sonte i vetëm”⁸ poeti është një endacak në mjegull, në ndjekje të aromës së tokës së tij, ndërsa në një tjetër poezi⁹ jeta i shfaqet si një liman dritash e mjegullash, qartësish e dyshimesh, sigurish e ngurrimesh, dështimesh e përjetimesh të fuqishme imagjinare. E gjithë kjo barrë mbrujtur me dhimbje e gëzim duhet mbajtur derisa njeriut t'i vijë koha t'i shkëputet stuhisë së quajtur jetë.

Në të gjitha poezitë e përmendura, përjetimet e autorit krijojnë imazhe që diku arrijnë koncentrim më të lartë poetik, duke e veshur realen me intensitetin tipik të imagjinatës, e diku vetë imazhi poetik që buron prej reales bëhet shkas përsiatjesh e konsideratash mbi jetën e qenien njerëzore. Si në paraqitjet e drejtpërdrejta të pamjes natyrore, ashtu dhe në përshkrimet ku ndihet si pjesë e rëndësishme e tablove të imagjinatës poetike, mjegulla ndihmon poetin t'i vizatojë sa më bukur përjetimet. Ujko do të zerë një vend të veçantë pikërisht prej kësaj ndjeshmërie që spikat në poezitë e tij, e që i japin vlerën e një poeti që ka aftësinë e paraqitjes jo thjeshtë të ngjyrës, por të nuancës.

La poesia di Vorea Ujko è un invito continuo alle diverse scale della sensibilità di ciascun lettore, che partono dall'emozione diretta della bellezza naturale, dei sentimenti umani, delle riflessioni sulla vita e la morte e fino all'identità nazionale e alla voce dell'etnia e della terra albanese in tutti i suoi spazi possibili. Ci siamo soffermati su un solo aspetto della presentazione poetica di queste sensazioni, che si lega a un elemento presente solo nel primo volume “Zgjimet e gjakut” - e molto meno in “Stinat e mia”: alla Nebbia, e al ruolo che essa gioca nell'immagine poetica. Come nelle presentazioni dirette del panorama naturale, così anche nelle descrizioni dove si sente come parte importante dei tablo dell'immaginazione poetica, la nebbia aiuta il poeta a disegnare il meglio possibile le emozioni. Queste ultime creano immagini che qua e là raggiungono un più alto concentrato poetico, vestendo la realtà con l'intensità tipica dell'immaginazione, e altrove la sola immagine poetica che sgorga dalla realtà diventa motivo di riflessioni e considerazioni sulla vita e sulla condizione umana. Ujko occupa un posto speciale nella letteratura albanese proprio per questa sensibilità che hanno le sue poesie, e che danno valore a un poeta che ha la capacità della presentazione non semplicemente del colore, ma della sfumatura.

(ec te faqja 31)

Vangjeli i pjerrë arbërisht

David Young

nga Britania e Madhe

Kam shumë vite (faktikisht qysh prej 1973) që interesohem për gjuhën, kulturën dhe popullin shqiptar, dhe kam vizituar një rradhë trojesh shqiptare duke përfshirë Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Çamëri, si dhe popullin arvanit në Peleponezë dhe në Thraki. Popullin arbëresh kurrë s'e kisha vizituar, pra në vitin 2010 u nisa për në Kalabri dhe Sicili. Punoj si drejtor i një misioni të krishterë që punon ndër shqiptarët, pra si besimtar ungjillor (evangelico) kisha një dëshirë të veçantë të marr kontakt me vëllezërit e mi ungjillorë.

Në Kalabri s'kam gjetur asnjë! Në Shën Mitër, me shoqërimet e saj me shkrimtarin De Rada, gjeta një kishë të vogël me emrin "Chiesa di Gesu Cristo", por për zhgënjimin tim nuk janë fare ungjillorë, por ndonjë degëzim prej Mormonëve. Në Spixanë ekziston një grup protestant, por nuk e gjeta gjatë vizitës në atë qytet. Vetëm pastaj, me anë të telefonit. Mirëpo u gëzova shumë prej një bisede miqësore me peshkopin dhe një prift katolik në Ungër.

Pastaj vazhdova rrugën për në Sicili. Vendbanimi kryesor arbëresh në Sicili është Hora e Arbëreshëve. Atje pata kontakt të gëzimshëm me kishën ungjillore, në të cilën familja udhëheqëse është familja Petta.

Giuseppe Petta lindi në 1932. Kur ishte 9 vjeç, vendi vuan nga uria nën sundimin e Benito Mussolinit dhe Giuseppe qe dërguar për të punuar si bari. Në moshën 17 vjeçare, një bari tjetër, që ishte një besimtar italian pentakostal, erdhi nga një fshat i afërt të punonte me bagëtinë dhe përmes kontaktit të tij me të, Giuseppe gjithashtu u bë besimtar ungjillor.

Në vitin 1957 dy vëllezër italianë, Vittorio dhe Vicenzo Maniscalco, masonë nga Palermo, erdhën për të punuar në Horën për disa muaj. Edhe ata ishin besimtarë pentakostalë. U bënë miq me një robaqepës të quajtur Bellone dhe filluan të flisnin me të për Zotin, si dhe me njerëz të tjerë, dhe i bindën disa për të përqafuar të njëjtin besim dhe përvojë. Me ndihmën e Bellones, ata filuan të mbanin takime. Këta njerëz nuk kishin një status të lartë social, por ishin punëtorë në ferma, inxhinierë e të ngjashme me këto, njerëz të varfër, fshatarë dhe artizanë.

Giuseppe u rrit, studioi dhe u bë një shitës në Horë. Po kërkonte për një komunitet ungjillor në Horë. U njoh me njerëz që ishin bërë besimtarë përmes Maniscalcos, i mblodhi ata së bashku në kishë dhe u bë

drejtuasi i tyre. Atyre po ashtu iu bashkua Giuseppe Pleiscia, i cili kishte dëgjuar predikimin në Gjermani. Prandaj në një kohë të shkurtër, një grup prej afro dhjetë njerëzve u formua.

Giuseppe Petta e ftonte pastorin e kishës së madhe pentakostale në Palermo që të vinte rregullisht për të drejtuar shërbesën, dhe ata filluan të mbanin shërbesat në shtëpinë e një motre të quajtur Pipinia. Giuseppe, me punën që bëri, kishte shumë mundësi për të folur me njerëzit për Zotin në shtëpitë e tyre, kështu në fund të tjerë erdhën tek besimi, mbi tridhjetë njerëz. Aty nga viti 1985, qe vendosur që kisha të ishte e ndarë nga shtëpia ku mblidheshin në mënyrë që të jetë më e dukshme dhe dëshmia më e hapur. Pas shumë kohe, gjatë së cilës ata nuk arritën të gjenin një vend, një grua ofroi një dhomë të vogël, të papërdorur, ku mund të mbanin shërbesat e adhurimit. Që atëherë, kanë ndryshuar vendet katër herë.

Giuseppe Petta vdiq në moshën 72 vjeçare dhe djali i tij Girolamo është tani pastor i kishës. Bashkësia nuk është më e lidhur me kishën mëmë në Palermo, por tani është e pavarur.

Disa anëtarë kanë vdekur, të tjerë kanë emigruar dhe janë transferuar, dhe anëtarësimi ishte afro tridhjetë njerëz në vitin 2000.

Nuk ka Bibël dhe libër himnesh në dialektin arbëresh dhe shërbesat publike e tyre mbahen në italisht; tani është gjithashtu edhe një familje italiane që merr pjesë në shërbesa, që nuk flasin dialektin arbëresh. Në lutjet personale ata i drejtohen Perëndisë në arbërishte. Për këtë arsye u gëzova shumë kur e pashë në bibliotekën e Horës përkthimin e Emanuele Giordanos "Vangjeli i pjerrë arbërisht", se feja duhet të ushtrohet në gjuhën e zemrës, gjuhën amtare.

Në Parathënien zoti Giordano shkruan: Vangjeli është fjala e Perëndisë. I shkruar për njerëzit, se të njohin Jisu Krishtin si njeri e Perëndi të vërtetë. Te Vangjeli xëmë se Perëndia është Dritë e Dashuri, dhe se Jisu Krishti është Udhë, e Vërteta dhe Jeta e njeriut.

Dëshiroja se Libri më i Shëjtë i të Krishterëvevet t'i vej ndër duart e Arbëreshëvevet.

Kjo dëshirë digjet edhe në zemrën time! Katolikët edhe ungjillorët (vangjelich) le ta gjejnë, ta përdorin dhe ta çmojnë këtë libër të rëndësishëm!

Kam parë në Bibliotekën e Universitetit të Cambridge në Angli përkthime arbërishte

të Ungjillit prej shekullit XIX (Arbërishtja siciliane prej vitit 1868, arbërishtja kalabreze prej vitit 1869). Sa të vështira qenkan për të lexuar! Se përdorin jo alfabetin e Kongresit të Manastirit të 1908-it, por shkronja latine, greke, dhe shenja të veçanta. Në të kundërtën, përkthimi i zotit Giordano lexohet pa vështirësi dhe me kënaqësi. Ai shkruan në Parathënie:

Çë ahiera, në Shqipëri u njësuja gjuha kombëtare; të folmet arbëreshe u studjuan thellë, prandaj u mundësua të përpunoheshin Fjalorë, Gramatika e të tjera vepra... mund të lehet, pothuaj, një gjuhë e përbashkët, ose arbërishte standarde... Në këtë gjuhë është pjerrë ky Vangjel.

Për ta ushqyer shpirtin tim, natyrisht e lexoj Biblën në gjuhën time amtare, anglishte; por nganjëherë, për interes e lexoj mbërmeve në gjuhën anglo-saksone ose - tani, falë zotit Giordano - edhe arbërisht.

Gjuha amtare është zemra e çdo populli. Ekziston një fjalë e urtë e lashtë në gjuhën e Cornwallit (kornishte), gjuhën e cila vetveten e quan Kernewek:

An lavar coth yu lavar gwyr... den hep tavas a-gollas y dyr.

(Fjala e lashtë është fjala e vërtetë: burri pa gjuhë e humbi tokën.)

Ata e kanë humbur krejt gjuhën e tyre: askush s'e ka si gjuhën amtare, dhe studjohet vetëm prej antikuarësh. Kjo duhet të mos i ndodhë gjuhës dhe kulturës arbëreshe. Kultura dhe gjuha le të ruhen me vendosmëri dhe me dashuri. Dhe Fjala e Perëndisë le të gjindet në qendrën, si pasuri e çmuar.

L'autore è un pastore evangelico inglese che dirige una missione cristiana in mezzo agli Albanesi. Si interessa dell'Albania e degli Albanesi dal 1973, mentre degli Arbëreshë solo dal 2010. In Calabria non ha trovato evangelici, mentre in Sicilia, a Piana degli Albanesi, ha conosciuto la famiglia di Giuseppe Petta.

A proposito di predicazione evangelica, lo Young nota come la Bibbia non sia stata ancora tradotta in arbëresh, ma, nella Biblioteca di Piana, si imbatte nel Vangelo arbëresh del papas Emanuele Giordano e ne rimane entusiasta. Perché - scrive - "la fede va praticata nella lingua del cuore, nella lingua materna".

Poetika e Kate Xukaro-s

Kate Xukaro spikat për personalitetin e saj poliedrik prej publicisteje, folkloristeje (studiuose, mbledhëse dhe botuese e folklorit arbëresh), po mbi të gjitha prej poetesje. Përveç poezive të ndryshme të shpërndara në shtypin arbëresh (veçanërisht të “Katundi ynë”, ajo ia detyron emrin e fituar si poete vëllimit me vjersha “Gabim” (me kuptimin ambivalent “gabim”, po edhe “ngatërrim”), botuar te “Rilindja” e Prishtinës më 1981.

Vjersha të saj janë përfshire edhe në antologjinë “Dega e blertë”, botuar në atdheun e të parëve të saj më 1980.

Kate Xukaro zë një vend të veçantë në yllësinë disi të rrallë të letrave dhe poeteshave të sotme arbëreshe pranë Leticia Xukaros, Matilde Ferraros nga Katanxaro, Enxa Skutarit nga Bazilikata, Ana mari Lules nga Sicilia etj.

Po atë mund ta përkufizosh edhe si zë tepër origjinal në tërë poezinë arbëreshe bashkëkohore. Dhe që madje mund të rreshtohet pranë zërave të poezisë italiane bashkëkohore, me të cilat ka të përbashkët frymën moderne, po jo gjuhën se i ka qëndruar gjithnjë besnike gjuhës së të parëve.

Individualiteti krijues i Kate Xukaros është afirmuar që në vjershat e saj të para, si një fëmijë i pjekur para kohe.

Në dallim nga poetesha të tjera në krijimtarinë e të cilave ndjenja mbizotëron mbi mendimin, ajo na sjell një poezi mendimi, kryesisht lirike.

Heroina lirike e Kate Xukaros bëhet kritike e rreptë e realitetit bashkëkohor me kontradiktat e veta, madje ajo kalon edhe në revoltë duke shprehur ndjenja vetmie dhe trishtimi.

Trajtimi i një problematike të thellë filozofiko-ekzistenciale nga K. Xukaroja dëshmon për gjerësinë e këndvështrimit të saj ndaj realitetit.

Kontrastet që poetesha zgjedh për t’i vënë në qendër të krijimtarisë së vet, kontrastet individ – shoqëri, ideal – realitet, kanë qenë të parapëlqyera nga poezia romantike, dhe letërsia romantike arbëreshe e shekullit XIX ofron një përvojë të pasur në këtë pikë, veçanërisht në poezinë e Serembes. Po K. Xukaro i shpreh këto kontraste në mënyrë të re në poezinë e vet duke cënuar nga realizmi që në krijimtarinë e saj ushqehet edhe modernizmi. Poezinë e saj e përshkon si një fill (jo i kuq! i errët) ideja e humbjes (bjerresjes si thotë ajo), humbjes së ngadalshme të identitetit të arbëreshëve, humbjes së vlerave etike nga njeriu bashkëkohor.

Në vjershat e saj gufon brenga e arbëreshëve për gjendjen e tyre të vështirë si minoritet, për shqetësimet e ndryshme sociale dhe njëkohësisht dhimbja e thellë e individit me botë të brendshme të pasur në një realitet të vrazhdë ku humbasin vlerat shpirtërore. Te kjo poezi vihen re imtësi të goditura. Poetesha spikat në vargjet e saj për një vetëpërbajtje që shton forcën shprehëse. Ajo ka respekt të thellë për fjalën, të cilën e jep me kursim dhe e ngarkon me mendim të thellë.

Jo rrallë përdoret arma e ironisë, e një ironie të hidhur siç ndodh të vjersha kuptimplote “*Fjalët birren*” ku yjet simbolizojnë idealet dhe poetesha sheh me sy të zhveshur nga iluzionet një botë pa ideale. Këtu ironik dhe i dhimbshëm tingëllon vargu i fundit “*Qielli është i të gjithëve*” që përmban nëntekstin dramatik “*Pse jo edhe yni?/ Cili fat na ka lënë në errësirë?*”

Nganjëherë poetesha anon të vizatojë edhe tablo apokaliptike

prof.dr. Klara Kodra

Universiteti i Tiranës

si të vjersha “*Vera buar sperat e djellit*” ku shohim diellit të ftohet, detin të thahet edhe dheun të dridhet nga të ftohtit. Njëpërmjet këtij peisazhi jepet shkretëtira, shpirtërore në ndërgjegjen e njeriut bashkëkohor që s’beson më as te Perëndia, as te vetja e tij. Po Kate Cukaroja arrin te pesimizmi ekzistencialist, vështrimi i jetës si absurditet. Përkundrazi për heroинën lirike që shpreh mendimet dhe ndjenjat e poeteshës nuk është i huaj optimizmi, si nuk janë të huaja vlerat njerëzore. Ajo e do jetën me pasion, beson te një dashuri humane që mund të çojë te rilindja shpirtërore e bashkëkohësve.

Në mënyrë të veçantë ky besim i autores te jeta e te njeriu shprehet në vjershën “*Të marrim hënëzën*” ku figuracioni kozmik tokë-det-qiell dhe përfytyrimi metodologjik – folklorik japin rrugën njerëzore drejt lumturisë si ideal të simbolizuar nga hëna, ideal që arrihet me luftë dhe sakrificë (Vetëm njeri nga tre djemtë që nisen drejt cakut në dukje të pamundur, e arrin hënën). Peisazhi është i pranishëm në këtë poezi, po gjithnjë në rrafsh funksional, jo si synim në vetvete. Poezia e Cukaros është një poezi simbolesh, metaforash dhe hiperbolash të guximshme, një poezi polivalente me nivele të ndryshme leximi.

Në frymën e protestës dhe ngjyrat dramatike që përshkojnë poezinë e Cukaros duhet të ketë ndikuar edhe gjendja ende e prapambetur e gruas në jugun e Italisë, ndonëse ajo nuk merret në mënyrë të veçantë në frymë feministe me këtë problem, po flet në emër të gjindjes së saj arbëreshe e të njeriut të shqetësuar e kontradiktor të këtij shekulli.

Mprehtësia e problematikës dhe nderimi për fjalën janë tipare të spikatura të poezisë së Cukaros, një poezi tepër origjinale e moderne me nivel të lartë estetik.

Kate Zuccaro è un’ interessante figura di poetessa arbreshe che spicca per la sua lirica di pensiero, meditativa e filosofica.

La sua è una poesia dell’inquietudine e della tragicità che affonda le radici nell’humus della tradizione popolare degli Albanesi d’Italia; ha la sua base in quelle strutture mitiche e mitologiche, ma è indiscutibilmente moderna.

In questa poesia ci sono le antitesi fra l’individuo e la società, l’ideale e la realtà care alla tradizione romantica, ma lette in chiave realistica e contemporaneamente modernistica.

Tutta la poesia della Zuccaro è pervasa dal senso di perdita: perdita graduale dell’identità degli Albanesi d’Italia, perdita dei valori etici nella società moderna.

La poetessa alterna pathos drammatico ed ironia dolorosa. La drammaticità però non sfocia in un pessimismo esistenziale, ma è prevista una possibile catarsi attraverso l’amore nel senso di agape.

La poesia della Zuccaro si distingue per una profondità di pensiero ed un rispetto per la parola che si manifestano attraverso un’ammirevole concisione. È una poesia assai ricca di simboli (popolari e cosmici), metafore ed iperboli che può essere letta a diversi livelli.

La Zuccaro è una delle voci più originali dell’odierna poesia italo-albanese.

De Rada në rreshtat e një novele

Florika Bushi

bibliografe në Universitetin e Tiranës

28 shkurti na sjellë në mend çdo vit kujtimin e poetit arbëresh Jeronim De Rada. Kjo datë në të vërtetë është e lidhur me ditën e vdekjes së poetit të Makit, 28 shkurtin e vitit 1903. Por këtu nuk duam të tregojmë sesi u fik ky atdhetar dhe Poet i madh, por nëpërmjet kujtesës historike do ta sjellim këtë personalitet të botës arbëreshe jo nëpërmjet aktiviteteteve ndryshme, që tashmë është bërë traditë që në Shqipëri të bëhen për nder të tij, por do ta paraqesim nëpërmjet një vepre të letrarizuar, të shkruar prej studiueses, përkthyeses dhe poeteshës së talentuar Klara Kodra.

Profesoreshë Klara Kodra, kësaj here, paraqitet përpara lexuesit shqiptar jo me një vepër studimore apo me një vëllim me poezi, por me një novelë për lexuesit e vegjël të shkollës 9- vjeçare, pse jo edhe për ata të viteve të para të shkollës së mesme.

“Erdhi dita e Arbrit” e shkruar nga kjo autore me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së Poetit, e botuar nga Shtëpia botuese Erik-u, më 2003, është një novelë ku ndërthuret arti me shkencën letrare. Kjo vepër është një novelë biografike, për krijimin e së cilës autorja ka ndërthurrur të dhënat reale nga jeta dhe vepra e Jeronim de Radës me fantazinë, për të cilën i ka ardhur në ndihmë puna e saj shumë e gjatë si studiuese e letërsisë arbëreshe.

Në këtë novelë autorja i njeh lexuesit e vegjël nëpërmjet përshkrimeve të bukura artistike, të cilat janë dhënë në vepër me një gjuhë të bukur poetike, me jetën e vogëlisë së Poetit, me çastet e bukura të fëmijërisë së tij. Kështu, me ngjyra të gjalla që të emocionojnë, autorja tregon për çastet e lumtura të poetit kur ai ishte fëmijë i vogël dhe luante me shokët e vet dhe njëherazi ëndërronte edhe për zanat; kur shkoi në shkollë për herë të parë në moshën 8- vjeçare; kur shkroi vjershën e parë dhe ndan gëzimet e shqetësimit me shokët e shkollës. Gjithashtu ajo u rrëfen fëmijëve për Jeronimin 20- vjeçar që tashmë është një djalë i ri në Napoli dhe boton në një nga gazetat e qytetit dhe më vonë librin e parë, poemën “Këngët e Milosaos”.

Por autorja nuk le pa përshkruar edhe momentet e dhimbjes së Jeronimit të vogël, apo vuajtjet e tij të moshës 25- vjeçare. Me një emocion të thellë ajo i përcjell lexuesit të vogël dhimbjen e madhe që ndien poeti kur humben të ëmën: “...Pa e kuptuar as vetë djali shpërtheu në ngashërime, duke u kapur fort pas fustanit të gjyshes, ...e cila vuri dorën e saj të rrudhur mbi flokët e djalit. Burrat nuk qajnë. A ishte burrë ai? I kishte mbushur të njëmbëdhjetat. Duhej të mendonte për familjen, të mbështeste të atin...Mëma s’ ishte më aty dhe s’ do të ishte kurrë më...Mëma kishte fluturuar në qiell-në të vërtetë ajo ishte e bukur dhe e mirë si engjëjt, kurse ai tani kishte përpara një tjetër hapësirë, tokën e pafund...”. Por autorja nuk le pa rrëfyer edhe për gjendjen e rënduar shpirtërore të poetit, tashmë në moshë madhore kur atë e pengojnë të botojë librin e dytë dhe që jeton në një vend të shtypur ca nga mbreti, ca nga pushtuesit austriakë. Poeti shkruan për dy vendet, për vendlindjen e tij dhe për Shqipërinë, vendlindjen dhe atdheun e stërgjyshërve të vet, e cila vuan nën shtypjen osmane.

Shkrimtarja nuk le pa rrëfyer edhe disa fakte jetësore nga jeta e Poetit, siç është rasti i pjesëmarrjes së djaloshit Jeronim në

kryengritjen për të luftuar robërimin e vendlindjes së tij, madje sesi ai u burgos; por tregon njëherazi që asgjë nuk e ndau atë nga poezia dhe dashuria për liri. Madje edhe në çastet e fundit të jetës së tij, në një dhomë të varfër ku edhe mbylli sytë, fjalët e fundit të poetit janë: “Gjaku ynë i shprishur”. Ndoshta Poeti i madh sot do të ishte ndër të shumtë keq kur të shihte sesi “fisi ynë i shpërndarë” është shpërndarë sot nëpër botë, duke u larguar nga vendi i vet për arsye ekonomike.

Novela dallon për imtësi të hollësishtme nga jeta e De Radës dhe i jep lexuesit një informacion të pasur nga jeta dhe vepra letrare e Poetit. Përveç se i ndarë në 15 kapituj të vegjël, libri është i pajisur me shënime biografike dhe në pjesën e fundit nën titullin: “Poezi dhe fragmente poemash të shkruara nga De Rada “ janë botuar sonete, pjesë nga poema”Këngët e Milosaos”(Kënga I, Kënga V, Kënga XI, Kënga XIII-Valle, Kënga XXX). Gjithashtu, janë botuar fragmente nga Kënga a Parë –Odiseu. Këngë për vdekjen e Skënderbeut e etj.

Sikurse “Testamenti politik”, të cilin De Rada e ka shkruar pesë muaj para vdekjes, më 1902, edhe autorja e kësaj novele në fund të parathënies të hartuar prej saj shkruan: “...Letërsia është si shkopi magjik i zanave: mund largësinë, kohën, vdekjen”. Poeti, sërish i gjallë, po vjen tek ju. Pranojeni me mikpritjen e ngrohtë Shqiptare”.

Botimi i këtij lloji zhanri ndihmon në njohjen e personaliteteve të mëdha të periudhave të ndryshme historike. Kjo novelë mund të përmbante bërthamën e një romani biografik.

Klara Kodra nel 2003 scrisse una novella dedicata ai ragazzi della scuola primaria, “E” arrivato il giorno dell’Arbër”, in occasione del 100mo anniversario della morte di Girolamo De Rada. Una novella dove si intrecciano arte e scienza letteraria. La Kodra descrive, con accenti emozionanti, i momenti più belli della fanciullezza del De Rada, quando giocava con i compagni e sognava le fate, quando cominciò a frequentare la scuola, quando scrisse la prima poesia; quando, ventenne, a Napoli già pubblicava un giornale e poco più tardi scriveva il poema “I Canti di Milosao”.

L’autrice ricorda anche i momenti di dolore del Poeta, quando a 25 anni perse la madre. Il De Rada scriveva per l’Arbëria, sua terra natale, e per l’Albania, la Patria dei suoi antenati, la quale soffrì sotto la dittatura ottomana.

Klara Kodra scrive della partecipazione del De Rada alla rivolta contro i Borboni e della sua incarcerazione, ma soprattutto della sua grande opera poetica. E della sua infelice vecchiaia, in povertà e solitudine.

La Novella della Kodra, nei suoi 15 capitoletti, dà informazioni esatte e accurate sulla vita e l’opera del De Rada, ma è anche arricchita da una bella Antologia con frammenti significativi delle sue opere.

La Kodra, nella Prefazione alla sua Novella, conclude così:”La letteratura è come la bacchetta magica delle fate: vince la lontananza, il tempo, la morte. Il Poeta, nuovamente vivo, viene a voi: accoglietelo con la calda ospitalità albanese”.

Zef Skirò Di Maxho, individualitet dhe krijues i fuqishëm

prof.dr.Hamit Xhaferi

Universiteti i Tetovës, Maqedoni

Në konceptin e angazhimit në letërsinë tonë kombëtare veprojnë një sërë penash krijuese letrare, vërehen përpjekje të jashtëzakonshme bashkërendimi krijimesh poetike, letrare dhe estetike, që janë vënë në shërbim të artit letrar shqiptar. Ndër këto pena është dhe Zef Skirò di Maxho, i cili harton dhe krijon art poetiko-letrar në arbërisht dhe shqip, duke pasur burim frymëzimi në shpirt e zemër thelbin e talentit. Krijimtaria e tij është e natyrshme dhe e begatë, ruan në vetvete elementin e ndjenjës etnike, të cilën e përcjell fillimisht para lexuesit arbëresh dhe atij mbarëshqiptar. Poeti jep të kuptohet periudha e tij kohore e veprimtarisë letrare, ndërsa poezia popullore arbëreshe ruan thellë në shpirtin e tij gjallërinë poetike, e cila është baza e themelit prej ku ngrihet këstjella e artit arbëresh. Rrjedha krijuese e tij flet dhe këndon spontanisht, me një dhunti të mirëfilltë në kuadër të opusit të vet poetik, që na duket si mehlemi i barit shërues që mbin në mjediset e tokës arbëreshe, që rrëfen për arritjen dhe gadishmërinë e shpirtit formues, me një shpirtëzim poetik ndaj Arbërisë, ndaj figurës së mrekullueshme të vashës arbëreshe dhe për dashurinë dhe lirinë e njerëzishme. Di Maxho dëshmohej se është bashkudhëtar i krijimtarisë së sotme poetike arbëreshe, së pari duke iu përkushtuar me guxim e vetëmohim, me angazhim dhe devotshmëri morale, botës së brendshme arbërore, që nuk është pa shqiptime e zëra të fortë dhe pa plagë të fuqishme shqetësuese. I tillë na duket aktualisht poeti, etnia e të cilit, pak a shumë vjen duke u dobësuar nga degdisjet fizike, megjithëse arbëreshët tanimë kanë hyrë në qindvjetorin e gjashtë të ekzistencës dhe jetës. Poeti për të treguar se shpirti i Arbërit rron ende, pareshtur kuvendon e këngëton në të folmen e Arbërisë, jeton e gëzohet me të, rritet e krenohet me fjalën artistike. Konstatimi se Di Maxho i dedikon fjalës, dimensionin domethënës dhe funksionin që ia cakton asaj në kuadër të poetizimeve të veçanta gjatë këngëtimt poetik me anë të ligjëritimit karakteristik arbëresh, ne më së miri e kuptojmë përmes vjershave: Botë, Plaku yt filloi vajtimet, Armëpushimi, Ky krua fshatar, Kllapa katrore etj. Poetizimet e Di Maxhos mbartin gjallëri të ndjeshme me plot frymëmarrje e gëzim. Për të vërtetuar këtë vlerësim tonin, ne ndër poezitë më të rëndësishme veçojmë: Kthimi, Gëzuar, Për Kosovën, Kosova lule, Në sheshin e Prishtinës, Sallata e nuses, Lexim, Busti bronzi, Shqiptarja, Martesa etj. Këto vlerësime na shfaqen vetvetiu sa herë që i lexojmë poezitë e magjishme dimaxhiane me artin e fjalës me përshkrime të bukura dhe origjinale. Sigurisht që na lindin dhe ndijme tjera të ndezura, kur e lexojmë dhe e kuptojmë të plotë këtë art, kur e njohim për së afërmi shembëlltërynë e këtij shpirti të ndjeshëm të udhërrëfimit poetik të bashkëkohësisë sonë, që del nga plëngu i moçëm arbëresh. Di Maxho kur flet për të kaluarën dhe të tashmen, pa marrë parasysh largësinë e ngulmimeve stërgjyshore, thotë se arbëreshët atëherë dhe sot bartin prejardhjen e njëjtë, shprehin të njëjtën ndjenjë të ngrohtë të tyre, flasin me të njëjtën të folme, ngase janë zëri i të njëjtës përkatësie të vjetër kombëtare. Jehona dhe fryti i krijimtarisë së Di Maxhos bëhen produkti i mirëfilltë i modelit të ndërtimit të shprehjes, kurse qenia është e mjedisëve të shtrira midis jetës dhe përjetësisë nëpër rrethujzën e Horës. Një hapësirë etnike arbëreshe me histori dhe karakteristikë të veçanta arsimore të të parëve, ku lindi, u kalit dhe u shtrua si virtyt poeti modern i ditëve të sotme.

Krijimtaria letrare në vargje e të cilit udhëton nëpër qindvjeçarë, duke synuar majën e mjeshtërisë së poezisë me tërësinë e mjeteve artistike dhe veçoritë e stilit. Si poet dhe krijues me prirje, aftësi e shprehi të shumta, karakterizohet me veti e zotësi natyrore, me shpirt të ndjeshëm, me frymën lirike dhe kulturën e gjerë letrare. Me zërin poetik arriti të ngjitet në kulmin e fjalës sublime artistike, duke iu afruar brezit, që shpërtheu në poezinë e sotme arbëreshe dhe duke bërë kthesën e madhe të përtëritjes së mjeshtërisë artistike, plot freski e lirinë. Me trillin e tij poetik do të zë vend ndër figurat krijuese më të fuqishme të vargjeve lirike, epike e satirike, duke i gdhendur për mrekulli me thelbin e talentit dhe duke u dalluar me mjeshtërinë autentike dhe vokacionin e begatë të visareve poetike. Janë këto arritjet e gjithmbarshme të vlerës së penës së këtij poeti vital me aftësi të rralla shprehëse në poezinë bashkëkohore arbëreshe dhe në mbarë kulturën poetiko-letrare shqiptare. Di Maxho do të hartojë përveç poezisë lirike (vëllimet "Sunata" dhe "Më parë se të ngriset"), poemën epike të natyrës rrëfimore ("Nëpër udhët e Parrajsit shqiptar dhe arbëresh" dhe "Fatosat"), që konsiderohen ndër poemat me arritje të mbara dhe të konceptuara mjaft mirë artistikisht. Fillimisht Di Maxho këndon me detin e thellë të dashurisë njerëzore së bashku me poetët e brezit të kohës së tij, duke ndjekur thesarin e trashëgimisë epike të De Radës, Darës e posaçërisht atë të Zef Skiròit. Madje më vonë, duket se u largohet këtyre karakteristikave të përgjithshme të shkrimeve, kur harton e publikon përmbledhjen "APKLPS" (Fotofjalë), duke shpalosur mjeshtërinë e të shkruarit bukur, për të dëshmuar arritje më kulmore në formën moderne të poezisë sonë, me domethënie konvencionale, ku shpërthimet lirike, peizazhet, portretet dhe tablotë formojnë lidhjet e ndikimit dhe ndërhyrjes duke analizuar thelbesoren në jetë. Poeti do t'i kushtoj vëmendje të veçant poezisë lirike, të ngritur mbi motive dhe mjete të qensishme të përcaktuara qartë me përplot larmi, gjallëri dhe lirinë.

L'aspetto tematico, come soggetto principale, di Schirò Di Maggio è la sopravvivenza e la vita arbëreshe, il desiderio di vedere e vivere la vita, lo stoicismo della comunità che vince sui momenti dell'epoca in ambiente illimitato. Il mito del confronto vive come legame stretto degli Arbëreshë con la Morea di una volta, con il mito delle disgrazie, con quello della caduta, del crepuscolo del Tempo Arbëresh, con il mito degli sforzi per il rinnovamento degli Arbëreshë nelle circostanze di oggi. La storia resta la radice della vita della realtà arbëreshe, Di Maggio non si occupa di essa, si batte perché questa si senta per quanto glielo richieda l'obbligo etnico avito. Il mito dell'epoca passata si segue sotto l'aspetto dello sguardo all'oggi, la storia si riflette nello spazio della contemporaneità. L'attenzione del poeta si stabilizza nell'epoca nella quale vive, nel mondo naturale odierno della comunità arbëreshe, un'etnia piena di difficoltà e sofferenze. I tempi moderni hanno inciso come la tignola e la ruggine sul sangue sparso arbëresh. La globalizzazione, la terra straniera, l'esilio, la lingua, la creatività, la vita spirituale, il tesoro, l'eredità degli arbëreshë, è necessario tramandarlo e rinnovarlo nella respiro sano nazionale etno-linguistico arbëreshe.

Inaugurimi i politikës Ballkanike të Italisë dhe Shqiptarët

Francesko Krispi ishte shqiptar i cilësuar

dr. Denisa Tare

Universiteti "A.Moisiu", Durrës

Shqipëria me pozitën e rëndësishme që zinte në Ballkanin Perëndimor, në detin Adriatik dhe mbi kanalin e Otrantos, kishte tërhequr prej kohësh vëmendjen e fuqive evropiane. Një ndër fuqitë më të interesuara ndaj Shqipërisë ishte Italia, interes që ishte shfaqur prej kohësh që me bashkimin e saj. Shqipëria gjithnjë e më shumë po kthehej në boshtin e politikës italiane. Qarqet sunduese italiane synonin të vinin dorë mbi Shqipërinë dhe detin Adriatik e ta kthenin në një det italian. Epoka e të madhit Garibaldi duket se kishte përfunduar dhe kishte marrë me vete premtimet për një ekspeditë ballkanike në ndihmë të popujve ballkanikë. Ngjarjet në Ballkan dhe nevoja e Italisë për të rifituar disa nga viset që kishte humbur në gjirin e Venecias dhe të gjitha ato që kishte pasur në "mare nostrum" e detyruan të formulonte një politikë kundrejt Shqipërisë. Francesco Krispi qe nismëtar i kësaj politike. Ai ka dhënë një kontribut të madh në rritjen e prestigjit të Italisë dhe në realizimin e projekteve italiane. Francesco Krispi ishte nismëtar i politikës italiane në Ballkan, Krispi ishte njeriu më popullor i Italisë së fund shek XIX. Jasthtë vendit krahasohej me Bismarkun dhe Meternikun. Lindi në Ribera të Sicilisë, në 1819, dhe jetoi një kohë të gjatë në fshatin Palazzo Adriano (Sicili). Krispi qe nga një familje e madhe shqiptare. Është provuar nga dokumentat dhe traditat shqiptare të ruajtura që familja e tij ka origjinën nga Shqipëria. Ajo ka emigruar në Itali pas vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut. Në 1467 gjendej në Sicili dhe në 1482 u vendos përfundimisht së bashku me familje të tjera shqiptare në Palazzo Adriano, provincë e Palermos. Puna e tij e bëri një nga më të fortët e më të mëdhenjtë e Italisë së Lirë dhe të Bashkuar. Kontributi i tij edhe sot vlerësohet në rangjet e kolosëve të Italisë. Ndoqi studimet e para në kolegjin Italo-Albanese në qytetin e Palermos dhe në 1841 u shkrua në Librin e gjykatave të Napolit. Krispi punoi si avokat por dhe qe pjesëmarrës aktiv në lëvizjen revolucionare të drejtuar kundra Burbonëve. Themeloi gazetën "Apostulli" me prirje maxiniste dhe njëherazi u zgjodh deputet i Palermos. Krispi ish tenxites, përkrahës i ekspeditës Siciliane dhe forca themelore në qeverinë e Garibaldi. Në 1860 Krispi u zgjodh deputet i Parlamentit Italian. Pas zgjedhjeve të 1877 Krispi u zgjodh president i Parlamentit Italian në shkurt 1891, dhe e rimori sërish vendin e Kryeministrit nga 1891 – 1893. Krispi udhëhoqi për 8 vjet me rradhë qeverinë italiane. Ai kreu një politikë të jashtme në favor të Italisë dhe frikësoi Francën sepse realizoi një aleancë tripalëshe Itali-Gjermani-Austri. Kjo bëri që Krispit t'i kthehen shumë toka italiane të banuara nga Italianë në Francë. Kjo politikë e ndjekur nga Krispi po e bënte Italinë një fuqi të madhe evropiane. Politika e jashtme e Krispit favorizonte rritjen e prestigjit të Italisë. Kriza Lindore, e cila preku dhe Ballkanin, po zgjerohej dita ditës. Kriza lindore çëronte edhe Shqipërinë e cila në këto vite u bë pre e politikave të fuqive të mëdha. Por çfarë qëndrimi mbajti Francesco Krispi ndaj Shqipërisë në këtë periudhë? Qëndrimi i Krispit ka qenë kontradiktore në lidhje me Shqipërinë dhe ka patur mjaft diskutime për vetë figurën e Krispit dhe rolin e tij ndaj Shqipërisë. Në vitet 1875 – 1878 dukej qartë se Perandoria Osmane nuk ishte në ditët e saj të shkëlqimit. Kjo rënie e prestigjit të Perandorisë Osmane i hapte rrugë politikave të dy fuqive të Adriatikut Austro- Hungarisë

dhe Italisë.

Ngjarjet në Ballkan i dhanë mundësi Austro – Hungarisë të zgjerohej në Ballkan dhe të kthehej njëherë e mirëzot i Adriatikut dhe pjesërisht i Mesdheut. Kjo politikë e Austro – Hungarisë në Ballkan çëronte interesat ekonomikë të Italisë. Kjo qe arsyeja e parë që bëri të mendojë Krispin të merrte një politikë kundrejt Shqipërisë. Së dyti tendenca për ta kthyer Italinë në një fuqi të madhe dhe për të siguruar viset që kishte humbur në gjirin e Venecias dhe ato që kishte pasur në "Mare Nostrum", bënë Krispin të ndërmerre një politikë ndaj Shqipërisë. Cështjen Shqiptare Krispi e shikonte të lidhur ngushtë me forcimin e Italisë në Adriatik për të penguar dhe luftuar Austrinë. Këtë fakt e pohon dhe deklarata e Krispit në Parlamentin Italian në mars 1880. Ai deklaroi : "Me traktatin e Berlinit, Austria mori tokë duke formuar kështu në Bosnjë dhe Hercegovinë kufi të pacënueshëm përballë Lindjes dhe për këtë duhet të jetë e kënaqur. Ne, pa ia lakmuar këto prona të marra padrejtësisht, duhet të kërkojmë që ata të qëndrojnë atje, dhe të mos kërkojnë më shumë se ç' u jep traktati. Ne në interesin tonë dhe në përputhje me parimet e revolucionit tonë të madh, duhet të jemi protektorët dhe miqtë e shteteve të vegjël në Ballkan". Politika e Krispit për të lejuar autonominë e Shqipërisë brenda Perandorisë Osmane nuk sillte kushte të përshtatshme për Shqipërinë për t'u zhvilluar. Vendimet e Kongresit të Berlinit çënonin projektin e Krispit në Shqipëri, shtonte rivalitetin Austro – Italian dhe nuk favorizonte aspak cështjen Shqiptare. Krispi ishte për autonominë administrative të Shqipërisë sepse kjo politikë ishte në favor të projektit të tij për të siguruar influencë në Adriatik dhe godiste Mbretërinë Austriake. Krispi shkruante në një artikull të gazetës *L'Ora di Palermo* nën titullin "Festat e Berlinit" më 5 maj 1900. Ai shkruan: "Shqipëria ka të gjitha elementët për të qenë shtet autonom, më mirë seç mund t'i kenë shtetet e tjera Ballkanike; Evropa do të realizonte një vepër qytetërimi nëse lejonte autonominë. Lidhjet e një miqësie intime të kultivuar për më shumë se pesë shekuj, e bëjnë më të afërt me ne (Italinë) se me Perandorinë Austriake". Vendimet e Kongresit të Berlinit i jepnin përparësi Austrisë dhe politikës së saj në Ballkan dhe pengonin projektet e Krispit. Megjithatë Krispi nuk u ndal në realizimin e projektit për sundimin politik në Shqipëri. Propaganda në favor të planit të tij realizohej mjaft mirë në gazetën e tij "La Riforma". Ndjekja e një politike "miqësie" me Shqipërinë do të sillte një afirmim të ngushtë me Shqipërinë e gradualisht do mund të realizohej ëndrra e Krispit për një bashkim të plotë me të. Kjo politikë e ndjekur nga Krispi do t'e afronte me Shqipërinë dhe do godiste synimet Austriake. Po në artikullin e gazetës *L'Ora di Palermo* Krispi shkruan: "T'i japësh sot Shqipërinë Austrisë, nuk do ishte përparësi për këtë mbretëri dhe do ishte në dëm të Italisë, kështu do eliminohej çdo gjurmë influence në Adriatik". Në lidhje me figurën e Krispit dhe politikës së tij të ndërmarrë në Shqipëri ka mendime të ndryshme deri diku kontradiktore. Rilindasit shqiptarë mbështesin tek Krispi shpresa të mëdha për të përkrahur cështjen shqiptare. Sami

Francesko Krispi ishte shqiptar i cilësuar

Frashëri shkruante në “Kamus-ul Alam”: Në Itali kanë ardhur nga giaku shqiptar shumë dijetar, poet e shkrimtar; ...kujtoj se është mjaft të përmendim se është bir i këtij kombi edhe Krispi që sot ka në dorë frenat e administratës së Italisë”.

Të njëjtin qëndrim pro figurës së Krispit mban dhe Naim Frashëri. Në një përmbledhje shkruar në Bukuresht 1894, në të cilën janë kujtuar emrat e më të mëdhenjve Shqipëtar, në këtë përmbledhje qëndron edhe emri i Krispit. Aty citohej:

Zoti Krispi, burrë i lëvduar / I ndërë dhe i dëgjuar / Qe jep sot nder Italisë / Është bir i Shqipërisë.

Por Krispi nuk i meritoi shpresat dhe fjalët e mira. De Rada kishte kuptuar shumë mirë dëshirën e borgezisë italiane dhe të Krispit për të pushtuar Shqipërinë. Shpresat që kishin tek Krispi ishin zhdukur tashmë patriotikët Shqiptarë i kishin njohur synimet e vërteta të Krispit dhe politikës italiane. Ishte tashmë e largët koha e të madhit Garibaldi, Italia e luftës për liri e Risorxhimento, Politika imperiale e Italisë mbështetej në faktin se Shqipëria ishte pikë strategjike nga e cila Italia mund të godiste influencën Austriake në adriatik. Koha e të madhit Garibaldi i kishte lënë vendin politikës imperialiste të Krispit i cili frymëzohej nga Franca politika e të cilës në vitet 1870 ishte e tillë që e kishte shndërruar në një fuqi të madhe koloniane. Politika italiane binte ndesh me interesat austriake në Shqipëri, përplasje e cila forcoi rivalitetin dypalësh. Rivaliteti Austro – Italian po forcohej si rezultat i përplasjeve të interesave. Kjo përplasje dypalëshe binte në kundërshtim me projektet e shqiptarëve për sigurimin e pamvarësisë nga Turqia. Mesa duket Shqipëria tashmë po rrezikohej të binte nga sundimi osman nën sundimin italian apo austriak. Po a mundi Francesko Krispi të realizonte projektin e tij pushtues në Ballkan? Si qëndronte raporti me Shqipërinë? Një politikë e tillë binte ndesh me interesat shqiptare të cilët i kundërshtuan projektet italiane të Krispit. Nga ana tjetër siç thekson Antonio Gramshi: “Krispi ishte fjalëmadh, oratorik, pa baza ekonomiko – financiare. Italia jo vetëm që nuk kishte kapitalet e saj për të eksportuar, por detyrohej të importonte kapitale të huaja për nevojat e saj urgjente”. Antonio Gramshi jep konfirmim se situata financiare e Italisë që e rëndë dhe kjo bëhej pengesë për realizimin e politikës imperialiste të Krispit. Nga ana tjetër edhe brenda qarqeve Italiane kishte kundërshtime për ndërmarrjen e një politike pushtuese kaq të shpejtë në Ballkan. Këto kundërshtime lidheshin me faktin se Italia ishte tepër e dobët ekonomikisht dhe politikisht. Sipas të djathtëve Italia duhet të kishte një periudhë paqeje dhe sigurimi për të rimarrë forcat.....Me pak fjalë nuk që gati për të ndërmarrë një fushatë të tillë në Ballkan. Të gjithë këto faktorë çuan në dështimin e politikës Italiane në Shqipëri, megjithatë Italia nuk hoqi dorë aq lehtë nga planet e saj në Ballkan e kryesisht në Shqipëri. Po le të rikthehemi tek figura e Krispit. Francesko Krispi është lakuar shumë dhe në lidhje me figurën e tij ka mendime shpesh kontradiktore. Për Italinë Krispi ka qenë një njeri i madh për rolin e tij në politikën Italiane, është vlerësuar shumë. Madje parlamentri italian on. D’Arco i është drejtuar Krispit në Parlament: “Krisp, Ti je shumë i madh për Italinë”. Kjo tregon respektin e fituar në Itali nga të mëdhenjtë e politikës. Megjithatë Francesko Krispi ishte Shqiptar dhe është cilësuar “ Albanese di sangue e di cuore ”.

Po çfarë bëri Krispi në Shqipëri, si vlerësohet politika e tij

kundrejt saj? Në lidhje me këtë pikë pati shumë shpresa se Krispi do mund të realizonte ëndërrën Shqiptare për pavarësi. Vetë vëllezërit Frashëri mbështetën këto shpresa të ai por pati të tjerë si Dora D’Istria apo De Rada që ishin skeptikë. Por vetë Krispi në 1900 në parlamentin Italian bëri publik idenë e tij se: “Shqipëria, ky vend i ashpër dhe me burra trima që ka ndihmuar Italinë sa herë ajo ka patur nevojë, sot ndodhet në udhëkryq.... Edhe ajo si gjithë vendet e tjera të Ballkanit i ka të gjitha elementët për të patur një qeveri autonome e më mirë se ato nuk i patën Bullgaria dhe Serbia. Une mendoj se duhet të luftojmë për të drejtat e këtij kombi në Europë... Ne ua kemi borxh...”. Kjo politike e Krispit për të siguruar autonominë e Shqipërisë sipas Koli Xoxit shihet si hap drejt sigurimit të një shkëputje nga sundimi osman për të kaluar nën protektoratin Italian. Megjithatë unë nuk do dëshiroja ta shikoja thjesht në këtë plan. Sigurimi i autonomisë nga ana shqiptare e ndihmuar nga pala italiane do të ishte një hap i mirë për të siguruar një shkëputje nga Perandoria Osmane dhe do i hapte rrugë sigurimit të pamvarësisë. Përhapja e arsimit në gjuhën italiane tek të rinjtë do bënte që të siguronte pikë më shumë në politikën e tij ndaj Shqipërisë. Ndonëse Krispi dha kontribut në përhapjen e arsimit italian nuk duhet harruar rolin e tij në përhapjen e gjuhës shqipe në mjaft shkolla apo institute italiane. Vetë Krispi në gazetën e Sicilisë të 18 janarit 1898 shkruante: “I nderuar Krispi, shprehte shpresën që sa më shpejt Shqipëria të shkundte ndikimin mysliman, dhe rekomandoi nxënësit në mënyrë të vecantë studimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, duke premtuar se qeveria të ngrejë një Chatetra në Institutin Lindor të Napolit”. Gjithashtu Krispi nuk e mohoi origjinën e tij. Origjinën e tij Shqiptare e deklaronte në mënyrë të qartë sa herë që i jepej rasti. Krispi mbështeti dhe hapjen e Kongresit të parë gjuhësor Shqiptar të mbajtur në Kalabri ditë e para 1895. Krispi me funksionin e ministrit të Mbretërisë Italiane dërgon një telegram përgëzimi kongresit. Ndonëse Francesko Krispi ndoqi një politikë në favor të imperializmit italian në Shqipëri i kushtëzuar ndoshta dhe nga rrethanat, nuk e mohoi origjinën shqiptare ndonëse kontributi i tij në favor të çështjes Shqiptare nuk që ajo që pritej. Për kontributin e dhënë në Revolucionin e 1860 në Mbretërinë e dy Sicilive për bashkimin e Italisë Krispi iu ngrit një monument, si simbol i unitetit të Italisë.

L’Albania, per la sua posizione strategica, nell’area occidentale dei Balcani, da tempo aveva attirato l’attenzione delle potenze europee. Tra queste, l’Italia. Francesco Crispi dette un grande contributo alla crescita del prestigio dell’Italia e alla realizzazione dei progetti italiani. Fu proprio lui l’iniziatore della politica italiana nei Balcani. Di origini arbëreshe, Crispi, mazziniano, prese parte attiva al movimento rivoluzionario contro i Borboni e preparò la spedizione siciliana di Garibaldi. Nel 1860 fu eletto deputato al Parlamento Italiano; nel 1861 presidente del Parlamento italiano, e per ben 8 anni fu presidente del consiglio dei ministri. La politica di Crispi era quella di lasciare l’autonomia all’Albania, all’interno dell’Impero Ottomano. Il perseguimento di una politica di amicizia con l’Albania avrebbe portato ad un avvicinamento stretto dell’Italia con l’Albania e gradualmente si sarebbe potuto realizzare il sogno di Crispi, cioè di una loro piena unità. Alcuni Albanesi, come Sami e Naim Frashëri, riponevano grandi speranze in Crispi. Ma De Rada no, era sicuro che l’intento di Crispi fosse quello di voler occupare l’Albania.

Fishta në dokumente të panjohura

dr. dom Nikë Ukgjin

Instituti Filozofik dhe Teologjik - Shkodër

Fishta, figura më e shquar e letërsisë shqiptare, edhe pse do binte në harresë për 50 vite me radhë nga sistemi komunist, sado që koha kalon, vepra dhe personaliteti i tij, sikur tërheqin më tepër vëmendjen e lexueseve dhe studiueseve vendas dhe të huaj.

Misioni françeskan në Shqipëri, për shkak të shtrirjes gjeografike, në këtë kohë ishte shpërndarë në pesë prefektura, deri kur Selia Shenjte më sugjerimin e kurjes qendrore françeskane, më bulën Apostolike "Felicitate quadam" (moment gëzimi) më 31 janar 1897¹, shpalli bashkimin e të gjithave prefekturave, gjë që qoi, në riformimin e provincës së re shqiptare, me 6. qershor 1906 në krye se cilës ishte, At Lovro Mihaçević².

Themeluesit e Kolegjit Françeskan në vitin 1880, në Troshan të Zadrimës: At Mariano Pizzochini prej Palmanova, (Udine) dhe At Gian Piero Ferrari, prej Bergamo³ duke qenë të nxitur nga porrosia papnore për edukimin e brezave të rinj, nxorën nga ky Kolegj, pas pesë viteve shkollim, gjeneratën e parë, prej gjashtë nxënësve shqiptarë, të cilët në vitin 1886, qenë dërguar për studime të mëtejshme, në Bosnje për t'u bërë meshtar të urdhrit Françeskan.

Dallëndyshtet e para që fluturuan nga Shkodra për në rishtari (noviciat) në Guçja Gora, afër qytetit të Travnikut, sipas dok. 573, dt. 15, tetor, 1886, ishin: vëlla, Anton Nënshati me emrin e pagëzimit, Martin; Jozef Blinishti, me emrin, Mëhill; Pjeter Gjadri, me emrin Simon; Lorenc Mitrovic (Mazreku) me emrin, Pashko; Ëngjëll Paliçi me emrin Sebastian dhe Gjon (Johannes) Fishta me emrin e pagëzimit, Jozef⁴ i cili sipas Gurakuqit dhe Malajt, qe pagëzuar nga At Leonardo De Martino⁵.

Studiuesit dhe lexuesit, duke u mbështetur në literaturën e botuar për poetin tonë kombëtar, qoftë edhe në jetëshkruesit e tij më të njohur, si: At Pashkë Bardhi, At Benedikt Dema, At Marin Sirdani, At Daniel Gjeçaj, me të drejtë do shtronin pyetjen, se cili nga emrat e studentëve të lartpërmendur do të ishte At Gjergj Fishta?

Përgjigjja e saktë rreth kësaj, të ashtuquajtur enigme edhe informacione të tjera me interes për Fishtën, do zbardhen duke shfletuar dokumentacionin e tij studentor, të marrë nga Arkivi Qendrore e Provincës Françeskane të Bosnjës, në Sarajevë.

Në dokumentin fillestar, nr. 573, të dt. 15 tetor 1886, nënshkruar nga eprori i rishitareve të Kuvendit në Guçja Gora, At Juraj Kosiç, mësojmë për emrat dhe mbiemrat e gjashtë kandidatëve të ardhur nga Shqipëria. Në krye të listës gjejmë emrin e parë më këto shënime: Fra Ivo, (në shqip Gjon), Fishta i lindur me 23 tetor, 1871, pagëzuar 24 tetor, me emrin Jozef (në gjuhën kroate Josip)⁶. Kjo do të thotë se Fishta, me rastin veshjes së zhgunit françeskan me 28 gusht 1886 dhe pranimit të kushteve të përkohshme të dt. 23 tetor 1887, sipas ligjeve rregulluare, kishte bërë ndryshimin e emrit nga Jozef në Gjon (Johannes), si emër i përmotshëm i një rregulltari.

Emri në gjuhën kroate, Ivo (Josip) apo në trajtën latine Johannes, hebraike Jôsëppon, që do të thotë, Zoti jep mirësi⁸, në dokumente shkollore, vazhdon të jetë, emërtim zyrtar i Fishtës, gjatë gjithë kohë së studimeve dy vjeçare filozofike, në Kraljevo Sutjeska, 1888-1889, dhe atyre teologjike në Livno, gjatë viteve 1889-1893⁹. Jetëshkruesi i tij më i njohur At Pashko Bardhi, në shkrimin e tij, "A. Gjergj Fishta" (Me rastin e 25 vjetorit të meshtarisë së tij) botuar në "Zani i Shna Nout" më 1919, rreth emrit të tij thotë: "Vjeten e provës e bani në kuvend të Guçja Gorës afer Travnikut e në këtë rasë, sipas zakonit të Fretnevet, ndërroi emnin e muer Gjergj". Shënimi i sapo cituar, i bashkohësit të Fishtës, At Bardhit, nuk mendohet se është i gabuar, dhe se ai nuk ishte në dijeni për emrin të cilin Fishta e mbante si rregulltar gjatë jetës studentore, por, arsyeya e vetme mund të ishte se personi në fjalë me

emrin Gjergj (Georgos, në greqishte "bujk") si poet, shkrimtar, diplomat etj., tashmë kishte bërë emër tek bota shqiptare dhe ndërkombëtare.

Shtrohet pyetja: Kur e mori Fishta emrin Gjergj? Përgjigjen e gjejmë në librin, Pal Duka-Gjini, "Gjergj Fishta, Jeta dhe Vepra", Assisi, 1992, ku ndër të tjera shpjegon se në letrën e dt. 2 shtator 1892, dërguar eprorëve, për krijimin e një shoqërie të vogël letrare shqiptare, Fishta qe i pari ndër dhjetë që e ndjekin e nënshkruhet, Enea-Silvio-Giorgio Fishta. Pa dyshim, dy emrat e parë si të tillë u zhdukën, duke i mbetur vetëm i fundit, Giorgio, në gjuhën kroate Jure, ndërsa, në shqip Gjergj, emër më anë të cilit ne sot e njohim poetin tonë kombëtar.

Emrat e lartpërmendur të Fishtës, janë personifikues, të njerëzve të mëdhenj, si të humanistit, Papa Pio II, me emrat Enea dhe Silvio (Piccolomini)¹². Ky Papë në historinë tonë kombëtare njihet si ai, i cili nisur për në Raguzë për ta kurorëzuar Gjergj Kastriotin si Atlet i Krishtit, dhe vdiq në vitin 1464 në Ankona të Italisë pa arritur ta finalizonte misionin e tij¹³. Apo, Aenëas, personazhi të Iliada e Homerit, mit heroik e Troades¹⁴ dhe Silvio, emër i rilindasit të shquar kroat, Silvie (Strahimir Kranjçević), mik i ngushtë i Fishtës etj.¹⁵ Ndërsa, emri i fundit Gjergj, në aspektin fetar, personifikim i Shën Gjergjit, martir i shek. V¹⁶, dhe në anën kombëtare, emri i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti.

Për shkak të ngjashmërisë, për kah robërimi, qe kishte Bosnja më Shqipërinë e pushtuar, në shpirtin e Fishtës, në Bosnje u ndez ajo shkëndijë e cila do të shpërthente me kthimin e tij në Shqipëri, në vitin 1893 dhe shugurimit meshtarak në vitin 1894, me një zjarr të madh dashurie e veprimi për liri e përparim të Atdheut.

Shënime

- 1) Po aty, f. 149; 2) Mihaçević Lovro, Njëpër Shqipëri, (1883-1907) Parathënjë, Enti botues Gjergj Fishta, Lezhë, 2006; Barun Adello, Svjedoci i učitelji, Povjest franjevacca Bosnje Srebrene, Sarajevo-Zagreb, 2003, f. 511; 3) Kurti Donat, Provinca Françeskane Shqiptare, botime Françeskane, Shkodër, 2003, f. 18; 4) Arkivi Qendror i Provincës Françeskane të Bosnjës, në Sarajevë, (dorëshkrime) dok. 573, dt. 15, tetor, 1886; 5) Gurakuqi, Karl, Jeta e vepra e Fishtës, Shkëndia, sht. Botuese, Lluarsis, Tiranë, 1940, 11; Malaj, P. Vincenz, Apostolsko i kulturno djelovanje franjevacca među vjernicima albanskog naroda, në: Të dhanat Albanologjike, nr.2, Shoqata, Don Gjon Buzaku, Ulqin-Tuz, 1999, f. 155; 6) Arkivi Qendror i Provincës Françeskane të Bosnjës, në Sarajevë, (dorëshkrime) dok. 573, dt. 15, tetor, 1886; 7) Kurti Donat, Provinca Françeskane Shqiptare, botime Françeskane, Shkodër, 2003, f. 123; 8) Enciclopedia Cattolica, Cita del Vaticano, voll. VII, Firenze, 1951, f. 585; 593; 9) Barun Adello, Svjedoci i učitelji, Povjest franjevacca Bosnje Srebrene, Sarajevo-Zagreb, 2003, f. 383 (refe.93), 384-385; 10) Dema, Benedikt, At Gjergj Fishta (1871-1940), Shkodër, 1941, f. 23; 11) Duka-Gjini, Pal "Gjergj Fishta, Jeta dhe Vepra", Provinca Françeskane Shqiptare, botuar në, S. Maria degli Angeli, pranë Assisi-t, shtator, 1992, f. 29; 12) Enciclopedia Cattolica, Città del Vaticano, voll. IX, Firenze, 1952, f. 1492; 13) Ukgjin Nikë, Albanci Katolici u Sjevernoj Albaniji i u Današnjoj Crnoj Gori za vrijeme Turskog Gospodstva (XV-XIX) Albanska katolička misia, Zagreb, 2002, f. 28; 14) Enciclopedia Italiana, (Treccani) vol. XIII, Roma, 1949, f. 962; 15) Duka-Gjini, Pal "Gjergj Fishta, Jeta dhe Vepra", Provinca Françeskane Shqiptare, botuar në, S. Maria degli Angeli, pranë Assisi-t, shtator, 1992, f. 23; 16) Enciclopedia Cattolica, Città del Vaticano, voll. VI, Firenze, 1951, f. 441.

Konferenca e Ale-së

Prej datës 23 deri më 27 qershor u zhvillua, në Krakov të Polonisë, Konferenca vjetore e Komitetit ndërkombëtar të ALE-së (Atlas Linguarum Europae).

Konferenca e organizuar nga Kryesia e Komitetit të ALE-së pranë Akademisë Rumune “Jorgu Jordan - Aleksandër Rosetti” dhe Instituti i Gjuhësisë në Bukuresht, që është e 43-ta e radhës, kësaj here u zhvillua në Krakov të Polonisë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhës Polake, Akademinë e Shkencave të Polonisë dhe Fakultetin e Filozofisë “Jagiellonian University” të Krakovit.

Në seancat e zhvilluara në Rezidencën “KraKowiak” morën pjesë gjuhëtarë nga shumë vende të Evropës, kryesisht dialektologë dhe studiues të historisë së gjuhës: nga Polonia, mikpritësjat e radhës, nga Rumania, ku është edhe qendra e drejtuar nga Nikolae Saramandu, president i ALE-së; nga Gjermania, Anglia, Suedia, Holanda, Franca, Italia, Spanja, Rusia, Greqia, Bosnja e Hercegovina, Sllovenia, Serbia, Maqedonia, Lituania, Malta, Estonia, Portugalia, Norvegjia etj. Në Konferencë ishin të ftuar edhe anëtarët e Komitetit kombëtar shqiptar të ALE-së (E. Hysa, S. Mansaku, K. Topalli, Gj. Shkurtaj), prej të cilëve morën pjesë në punime me referate e diskutime studiuesit Kolec Topalli nga QSA-ja dhe Gjovalin Shkurtaj nga Universiteti i Tiranës.

Ne seancën hyrëse përshëndetën autoritetet drejtuese të Universitetit të Krakovit: Piotr Zmigrodski, drejtor i Institutit të Gjuhës Polake; Marcela Swiatkowska, dekanë e Fakultetit të Filologjisë; Janusz Siatkowski i Universitetit të Varshavës, në emër të Komitetit të Gjuhës Polake; si edhe Nikolae Saramandu, president i Atlasit Linguistik të Europës. Në vijim, Piotr Zmigrodski paraqiti projektin e “Fjalorit të madh të polonishtes”, vepër që shpie më tej punën e filluar qysh më 1900 e të kurorëzuar me botimin e shtatë vëllimeve të tij. Mbi atë bazë, por me përmirësimin e metodës shkencore dhe duke vënë në përdorim edhe botimin në CD dhe në faqe elektronike “on-line”, referuesi kumtoi dhe tregoi se studiuesit polakë i kanë hyrë një ndërmarrjeje të lakmueshme e shumë të vyer me vlera të mëdha studimore e praktike.

Kumtesa e dytë, me shumë rëndësi, u mbajt nga Ejup Kruijsen, ish-president i Komitetit të ALE-së për disa vjet dhe njëri nga bashkëpunëtorët më të hershëm e më të ngushtë të nismës ndërkombëtare për realizimin e një atlasit gjuhësor në shkallë evropiane, ideuar që në fillim të viteve ‘80 nga A. Wijnen e Mario Alinei. I lartpërmenduri, me dijet, përvojën dhe ndihmesat konkrete gjatë periudhës tashmë dyzetvjeçare të ALE-së, bëri një paraqitje të krejt historikut të Atlasit Linguistik Evropian, qysh nga ideimi i tij fillestar prej A. Wijnen. Ai foli për hartimin e pyetësorëve dhe realizimin e marrëveshjeve me shtetet përkatëse për krijimin e komiteteve kombëtare për secilën gjuhë, duke vlerësuar e përmendur udhën jo të lehtë për gjetjen e mirëkuptimit, vështirësitë financiare për organizimin e Qendrës dhe Arkivit të saj, si edhe për Komitetin Ndërkombëtar të ALE-së. Ai theksoi gjithashtu nevojën e hartimit të pyetësorëve të përgjithshëm e të veçantë dhe të bashkërendimit të punës me Komitetet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse, të cilat, me kohë, do të bënin edhe përkthimin e tyre në gjuhët përkatëse kombëtare duke organizuar anketimin e mbledhjen e materialeve gjuhësore në pikat e caktuara nga specialistë dialektologë.

akademik Kolec Topalli
prof.dr. Gjovalin Shkurtaj

Universiteti i Tiranës

Theksojmë, me këtë rast, se në ALE gjuha shqipe përfaqësohet me lëndë të mbledhur në dhjetë pika brenda Republikës së Shqipërisë dhe disa të tjera nga hapësirat shqiptare ballkanike dhe nga diaspora. Anketimet në pikat e caktuara në Shqipëri janë bërë në vitet ‘80 nga grupi i dialektologëve që punonin për ADGJSH-në (J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani). Puna e dialektologëve shqiptarë për anketimin në terren dhe plotësimin e skedave përkatëse e dorëzimin me kohë të materialeve në qendrën e ALE-së, u përmend në referimin e Ejup Kruijsenit, duke theksuar se Shqipëria ka qenë nga të parat vende që ka aderuar në këtë nismë dhe ka treguar seriozitet për kryerjen e anketimeve, skedimin e shkencorizimit e të dhënave dhe dorëzimin e tyre me kohë në Arkivin e ALE-së në Niemegen. Po ashtu, në referat u përmend edhe organizimi me nivel shumë të lartë i njerës nga konferencat e radhës (e 41-ta në Durrës, në qershor të vitit 2008), ku nga grupi i dialektologëve shqiptarë u paraqit vepra madhore “Atlasi Dialektologjik i Gjuhës shqipe”, Tiranë-Napoli, vëll.I, 2007, vëll.II, 2008

Në Konferencën e 43-të të ALE-së, sipas programit dhe tematikës së caktuar, nga Komiteti Kombëtar Shqiptar e mori fjalën Gjovalin Shkurtaj, i cili kumtoi rreth hartës me temë “il danse” (kërcej, vallëzoi), kurse në seancat e tjera, sipas temave që lidheshin me leksema të shqipes Kolec Topalli diskutoi për termin plantain “gjethe deli”.

Në seancën e fundit u bënë konkluzionet rreth punimeve të Konferencës së 43-të, u miratua botimi i disa prej hartave të përfunduara, që u shqyrtuan dhe u diskutuan aty e do të përfshihen në vëllimin e tetë të ALE-së. Gjithashtu u caktuan detyrat konkrete për t’u kryer nga komitetet kombëtare gjatë periudhës njëvjeçare deri në Konferencën e radhës, që do të organizohet në qershor të 2011-ës në Frysland të Hollandës.

Pjesëmarrja aktive e studiuesve shqiptarë, jo vetëm me referimet e paracaktuara, por edhe me diskutimet e lira e vërejtjet e tyre me frymë ndërtuese për hartat në përpunim e sipër, u mirëprit dhe u vlerësua nga pjesëmarrësit dhe nga presidenti i ALE-së, Nikolae Saramandu, i cili vuri në dukje se, ashtu si në konferencat e mëparshme të zhvilluara në Strugë të Maqedonisë (2007), në Durrës (2008) dhe në Glasgow të Skocisë (2009), studiuesit shqiptarë kanë qenë nga pjesëmarrësit më aktivë dhe më të interesuar për të dhënë ndihmesën e tyre. Ai kujtoi, gjithashtu, organizimin shumë të mirë dhe pritjen e veçantë dhe punën e mirë të kryer nga QSA-ja dhe Komiteti Shqiptar i ALE-së për mbledhjen e 41-të të organizuar në Durrës, në qershor të 2008.

Dal 23 al 27 giugno 2010 si è svolta a Cracovia, in Polonia, la Conferenza annuale del Comitato Internazionale dell’ALE (Atlante delle Lingue d’Europa). Vi hanno preso parte linguisti da ogni parte d’Europa, specialmente dialettologi e studiosi della storia della lingua. Erano presenti anche i componenti del Comitato Nazionale Albanese dell’ALE (E. Hysa, S. Mansaku, K. Topalli, Gj. Shkurtaj): tra questi, hanno preso parte attiva ai lavori, con due differenti relazioni, l’accademico Kolec Topalli e il prof. universitario Gjovalin Shkurtaj.

Epika gojore shqiptare

Zymer Neziri

Instituti Albanologjik i Prishtinës

Simpoziumi shkencor ndërkombëtar të Universitetit të Harvardit, Kembrixh, SHBA: «Këngëtarët dhe rrëfenjat në shekullin e 21-të: Trashëgimitë e Milman Parry-t dhe të Albert Lord-it», u mbajt më 3-5.12.2010, ku u shqyrtua edhe epika gojore shqiptare në kumtesën e Nicola Scaldaferrit, profesor në Universitetin e Milanos, dhe të Zymer Nezirit, profesor i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Me kumtesa u paraqiten 32 studiues nga SHBA dhe nga qendrat e njohura dhe universitare të botës dhe u trajtuan këto grupe temash: Formula e tema, Homeri, Epika e Ballkanit, Qasje krahasuese I dhe II, Teknologji, Traditave skandinave, Kujtesë, Muzikë dhe performancë, Qasje bashkëbisedore, Epika dhe shoqëria.

Profesori i Universitetit të Jellit (Yale), Egbert Bakker, mori i pari fjalën dhe paraqiti kumtesën "Formulat homerike dhe vazhdimësia e intertekstualitetit." Në vijim, Minna Skaft Jensen, profesoreshë nga Danimarka, lexoi kumtesën "Menelau në Odisea: Një studim për treguesin si model." Studiuesi i folklorit dhe i traditës gojore, profesor në Akademinë e Shkencave Sociale të Kinës, Chao Gejin, pati për kumtesë "Trendet aktuale në folkloristikën kineze: Një perspektivë nga zbatimet e lokalizuara të Teorisë gojore formulaike." Profesor David Bouvier (Universiteti i Lozanës) lexoi kumtesën "Shprehje formulaike dhe kujtime të Homeri."

Zgjuan interesim edhe kumtesat, në rrafshin krahasues, të studiuesve Anna Bonifazi (Universiteti i Hajdelbergut) dhe David Elmer (Harvard): "Vizualiteti në epikën sllave të Jugut dhe në epikën homerike", si dhe ajo e profesorit Joseph Falaky Nagy (Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos), mitolog, studiues i kulturës kelte dhe i traditës gojore: "Gjarpërinjtë e zemrës në tregimet heroike serbe dhe irlandeze."

Me interes qenë edhe kumtesat e paraqitura nga: Holly Davidson (Universiteti i Bostonit), Karl Reichl (Universiteti i Bonit), Carlo Severi, (antropolog i njohur), Lotte Tarkka, (Universiteti i Helsinkit). Në kuadër të traditave skandinave lexuan kumtesa: Lars Lönnroth (Universiteti i Götteborgut), Gísli Sigurdsson (Universiteti i Islandës), Thomas A. DuBois (Universiteti i Pensilvanisë). Me kumtesa të tjera u paraqiten: Karl Lindahl (Universiteti Indiana), Françoise Léotoublon (Universiteti Stendal, Grenobël), Nikolay Grintser (Universiteti Shtetëror Rus i Shkencave Humane), Olga Levaniouk (Universiteti i Uashingtonit), Casey Dué (Universiteti i Hjustonit), Mary Ebbott (Kolegji Holy Cross), Anna Stavropoulou (Universiteti i Aristotelit, Selanik), Susan Niditch (Kolegji Amherst). Nga fusha e muzikës së sllavëve të Jugut dhe e muzikës arabe u paraqiten John Franklin (Konservatori, New England), Dwight Reynolds (Universiteti i Kalifornisë, Santa Barbara).

Në grupin e temave për Ballkanin u paraqitën këto kumtesa: profesor John Miles Foley (Universiteti i Misurit), "Epika gojore në Stollac: Tradita kolektive dhe arti individual"; Mirsad Kunić (Universiteti i Tuzllës), "Vdekja e heroit Mustaj Beg i Likës në këngët e Koleksionit të Millmen Perit"; profesoresha Ronelle Alexander (Universiteti i Kalifornisë, Berkeley), "Përcjellja e regjistrit epik të sllavët e Jugut"; Nicola Scaldaferrit dhe Zymer Neziri, "Nga Arkivi në terren: Hulumtim i ri për këngët epike shqiptare." Tema nga Ballkani trajtuan edhe: studiuesja e epikës, Margaret Beissinger, sllaviste në Universitetin e Prinstonit (Princeton), "Shkelja, turpi, dhe ruajtja e shoqërisë tradicionale: Incesti në epikën gojore të Ballkanit"; Aida Vidan (Harvard) "Balada e vëllait të humbur: Burimet gojore të dramës të Rilindjes kroeate"; Peter McMurray (Harvard), "Nuk ka media gojore? Perceptimet dëgjimore dhe pamore të poezisë epike të sllavëve të Jugut."

Pra, në kuadër të epikës gojore të Ballkanit, u shqyrtua edhe epika jonë. U tha se tradita epike legjendare e Eposit të Kreshnikëve është një pjesë e rëndësishme e identitetit ku-lturor shqiptar, e mbledhur kryesisht në anën veriore të Shqipërisë, në Kosovë, në viset shqiptare në Maqedoni, në Serbi e në Mal të Zi; hulumtime të rëndësishme janë kryer në kaluarën në këtë traditë: ku veçohet edhe puna e Milman Parry-t Albert Lord-it, krahas mbledhësve të tjerë ndërmjet dy luftërave botërore, si dhe më vonë, të nxitur nga institucionet vendore. Sot, u tha në këtë kumtesë, këngëtarët janë ende aktivë në rajonet e përmendura, veçanërisht në disa vise specifike, sidomos në Rugovë dhe në disa krahina të Malësisë; në kërkimet e reja, që zbatohen në këtë fushë gjatë viteve të fundit, duke pasur parasysh edhe koleksionet e vjetra, si dhe me mbështetjen e teknologjive të reja, po bëhen përpjekje për të arritur rezultate të reja të rëndësishme, duke u përqendruar veçanërisht në pikat e mëposhtme: informacione të reja dhe të dhëna etnografike lidhur me rapsodët e tashëm; debati për Listën e UNESCO-s të trashëgimisë kulturore; konferenca shkencore ndërkombëtare për Eposin e Kreshnikëve, në Prishtinë, më 2010 etj.

Në punimet e simpoziumit kanë qenë të pranishëm edhe pasardhës të Parry-t e të Lord-it: Marian Parry, Nate Lord etj. Mori pjesë edhe rapsodi ynë Shaban Lajçi, i veshur kombëtarisht. Pjesëmarrja jonë në këtë simpozium në Universitetin e Harvardit, në shkollën më elitare në SHBA dhe në botë, mendoj, është nder i madh për epikologjinë dhe për studimet albanologjike.

Dal 3 al 5 dicembre 2010 si è tenuto, all'Università di Harvard, negli Stati Uniti, un simposio su "I cantori e i racconti nel sec.XXI: le eredità di Milman Perry e di Albert Lord". 32 sono state le Comunicazioni di altrettanti studiosi provenienti da molte Università degli Usa e da altri centri universitari internazionali (Danimarca, Cina, Svizzera, Germania, Finlandia, Islanda, Francia, Inghilterra, Grecia, Russia). E' stata analizzata anche l'Epica Orale Albanese nella comunicazione di **Nicola Scaldaferrit**, professore all'Università di Milano e di **Zymer Neziri**, professore dell'Istituto Albanologico di Prishtina: "Dall'archivio al campo: nuova ricerca per i canti epici albanesi". Temi balcanici sono stati trattati anche dai proff.: John Miles Foley, Mirsad Kunić, Ronelle Alexander, Margaret Beissinger, Aida Vidan e Peter McMurray. E' stato rilevato come la tradizione epica leggendaria dell'Epos degli Eroi sia una parte importante dell'identità culturale albanese, raccolta specialmente nella parte settentrionale dell'Albania, in Kosova, nelle zone albanesi della Macedonia, Serbia e Montenegro. Nel passato, nelle ricerche su questa tradizione si è distinta l'opera di Parry e Lord.

Scilippa Marg, *Re me rreze dielli - poezi dygjuhesh / Nuvola con raggi di sole - poesia bilingue*, Pitti Edizioni, Palermo 2010

Si çdo grua, autorja s'na thot vitrat e saj, por poezitë janë të bukura; e këtu këtë, ndë mes të fjalëve, zbulohet prejardhja e saj nga Hora e Arbëreshëve. Një zë i freskët që nderon poezinë arbëreshe.

Pugliese Basilio, *K'shtu a fjasmi na - proverbi, canti e poesie*, a cura di Costantino Bellusci e Franco Pugliese, col patrocinio del Comune di San Basile, Grafica Pollino, Castrovillari 2011

Një libër i Vasilit Pugliese, i vdekur parë motit, ku gjën fjalë t'urta e idiomatizme, vjershe, poetët popullorë, gjuhë e fjalor. Katundi është Shën Vasili, i nderuar me këtë libër për 500vjetorin e themelimit të tij.

Bruni Pierfranco (a cura di), *Scanderbeg tra letteratura e radici mediterranee - La sua presenza a Gravina in Puglia*, per conto del Comitato Nazionale Minoranze etnolinguistiche del Mibac, L.Pellegrini Editore, Cosenza 2006

Janë Aktet e nji Kuvendi të mbajtur në Gravina (Ba), ndë janar 2006. Referuesit e Kuvendit qenë: P.Bruni, (Il nazionalismo mediterraneo di Skanderbeg – il confronto tra storia e letteratura), I.C.Fortino (G.C.Skanderbeg tra storia e letteratura), Fedele Raguso (Una Castriota nel Ducato di Gravina del XVI secolo), Marisa D'Agostino (Mausoleo funebre di Angela Castriota-Orsini).

Bruni Pierfranco (a cura di), *...Nga njëri breg a tjetri i këtij deti - ...D'una o dell'altra riva di questo mare.../ Zëra e rrugëtime të poezisë italiane bashkëkohëse-Voci e percorsi della poesia italiana contemporanea I*, per conto del Comitato Nazionale Minoranze etnolinguistiche del Mibac Tiemme srl., Manduria (Ta) 2006

Është një libër poezish italiane, të zgjedhura ka P.Bruni, dhe të pjerra në gjuhë shqipe nga Caterina Zuccaro. Te ky libër gjenden poezi të këtyre poetëve arbëreshë: Franco Esposito nga Maqi (Gra Sibarite, Fjalë Arbëreshe, Nënës) e

Francesco Fusca ka Spixana (Guaska jote e trendafiltë, Si relike a hajmali, Përpara pagëzimores).

Bruni Pierfranco (a cura di), *Sui passi della Magna Grecia*, per conto del Comitato Nazionale Minoranze etnolinguistiche del Mibac, L.Pellegrini Editore, Cosenza 2006

Te ky libër gjenden shkrime të: P.Bruni (Lungo la storia, i paesaggi della Basilicata; Le identità della Magna Grecia; Comunità italo-albanesi; I Grecanici tra Calabria e il Salento); M. Bruni (I luoghi e il territorio, La Calabria verso la grecità); R. Patitucci (Da Padula ai Trulli – la valle d'Itria, tra grecità e medioevo); M. Zanoni (Tra gli Occitani, un'isola occitana in Magna Grecia); M. Zuccaro (Civita e Laupoli in provincia di Cosenza), A.Giordano (L'Eredità arbëreshe nel Tarantino); G.Mazzarino (Aspetti dell'Arberia tarantina – un antico territorio della Magna Grecia).

Bruni Pierfranco, *Dall'indifferenza alla nostalgia – i segni e le etnie tra linguaggi, letteratura e beni culturali*, per conto del Comitato Nazionale Minoranze etnolinguistiche del Mibac, L.Pellegrini Editore, Cosenza 2006

Ky libër folën mbi kontaktet që dica shkrimtarë ose piktorë patëtin me terri-toret e me kulturat e Pakicavet etno-gjuhësore te Italisë. E kështu kemi, për shembull, Ibrahim Kodra me Arbërinë, Tomizza me Istriën, Mistral me Provençalët, Pasolini me Friulanët, Pavese me Grekanikët. Qëllimi i Brunit është ai të dilet ka indiferenca për të hyhet tek historia e pëstaj te nderimi i kujtesës.

Mjegulla, si pjesëz ...

(vjen ka faqja 21)

- 1) Ujko, V., Zgjimët e gjakut, Castrovillari, 1971.
- 2) Po ai, Stinat e mia, Corigliano Stazione, 1980.
- 3) Ujko, V. "Unë kam shkuar", Zgjimët e gjakut, marrë nga Vorea Ujko, Opera letteraria, Edizioni Il Coscile, Castrovillari, 2004, f. 78.
- 4) Po ai, po aty, f.73.
- 5) Shih Shën. 4, f.76.

Bibliografi Arbëreshe

(kërkoi) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

Nga revista

“**STUDIME FILOLOGJIKE**”

(1964-1965)

- **Xhuvani Aleksandër**, Parafjalët, nr.1/1964, faqe 7;
- **Çabej Eqrem**, Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe (XII) -K-, nr.1/1964, faqe ...; (XIII) -L/LL- nr.2/1964, faqe 11; (XIV) -M- nr.3/1964, faqe 15; (XV) -N- nr.4/1964, faqe 81; (XVI) -O- nr.1/1965, faqe 3; (XVII) -P- nr.2/1965, faqe 7; (XVIII) -R- nr.3/1965, faqe 41; (XIX) -Rr/S- nr.4/1965, faqe 41.
- **Daka Palok**, Kontribut për Bibliografinë e Gjuhësisë shqiptare (I), (1883-1898), nr.2/1964, faqe 181; (II), (1899-1904), nr.3/1964, faqe 179; (III), (1905-1909), nr.4/1964, faqe 215; (IV), (1910), nr.1/1965, faq e 183; (V), (1911-1918), nr.2/1965, faqe 181; (VI), (1919-1925), nr.3/1965, faqe 189; (VII), (1926-1928), nr.4/1965, faqe 177.
- **Stratigò Viçenc**, Shqiptari, përktheu shqip nga italishtja Z.Kodra, nr.3/1964, faqe 174.
- **Kodra Ziaudin**, Jeronim De Rada si folklorist e poet dhe ndikimi i tij tek shkrimtarët arbëreshë të shek.XIX-XX, nr.4/1964, faqe 51.
- **Kastrati Jup**, Veprat gjuhësore të Jeronim De Radës, nr.4/1964, faqe 65.
- **Sokoli Ramadan**, Kangët rituale në të kremtet vjetore të popullit tonë, nr.4/1964, faqe 163.
- **Kodra Ziaudin**: Francesco Crispi Glaviano, Mbi malin e truntafilevet/Sul monte delle Rose, Testo e traduzione dell'Autore, Introduzione, Commento e note di Matteo Sciambra, Palermo 1963; nr.1/1965, faqe 171 (Kritikë e Bibliografi).
- **Kodra Ziaudin**, Vinçenc Stratigò (1822-1885), nr.4/1965, faqe 71.

(1 – ka më)

- 6) Po aty, f. 79.
- 7) Po aty, f. 90.
- 8) “Sonte i vetëm”, Stinat e mia, f. 204.
- 9) “Jeta ime”, po aty, f.205.

Albanesi, Italo-albanesi e Regno di Napoli

Tirana. Una città che ha i tagli della storia e si intreccia tra strade che hanno l'Occidente lungo il cammino e le apparenze tra i palazzi nuovi e decifratissimi dalla storia. Una città non immersa nel mondo balcanico. Ma una città che risente di quelle sponde adriatiche che si tuffano in un Mediterraneo che ha il fuoco dell'anima. Tirana è questa città nell'Adriatico del Mediterraneo e la sua eredità non è un "tamburo di pioggia", come direbbe lo scrittore Kadaré, ma è piuttosto una città che ha saputo reggere l'equilibrio delle lingue e delle appartenenze. E perché questo? C'è una Tirana albanese, francamente ancorata ad una Albania storica dove però Scanderbeg è l'eroe Occidentale e Cristiano, e c'è una Tirana che ha saputo raccogliere completamente il mito di una romanità – latinità che è riuscita ad incontrarsi con una grecità bizantina. E tutto questo lo abbiamo vissuto, in tempi passati, anche in quelle comunità Italo – albanesi che hanno caratterizzato quello che è stato il Regno di Napoli, prima, e il Regno delle Due Sicilie successivamente. Tirana è stata una città risorgimentale sin dal 1912 e il Risorgimento vissuto come un vero e proprio Rinascimento (si pensi al passaggio culturale e non solo politico; si pensi alle tappe letterarie post-deradiane in un contesto che nonostante la monoliticità linguistica ha assorbito modelli di contaminazione) ha dato dei segnali forti anche alla evoluzione storica vissuta all'interno dello stesso Regno di Napoli. La presenza della storia albanese in Italia non è da "classificarsi" soltanto in merito alle diaspore e alle fughe dall'Albania a cominciare dal 1400, ma sarebbe da ricontestualizzare in un tessuto che interessa il rapporto tra la presenza della storia albanese nella storia italiana post-unitaria. E le città hanno avuto, e continuano ad avere, una loro particolare importanza soprattutto se si collega in termini geo-politici l'identità di una città come Tirana con un Mediterraneo che ha specificato il Sud d'Italia. Questa Italia Mediterranea è l'Italia che ha saputo incontrarsi e difendersi dai tentativi di militarizzazione da Paesi come la Turchia da una parte e le sponde del nord-Africa dall'altra. L'Albania è cerniera nell'Adriatico e diventa chiave di lettura nel Mediterraneo cosiddetto altro. C'è un pensiero meridiano anche in una linea balcanica che costituisce la rappresentazione di una divisione e di una unione geograficamente interpretativa sul piano storico. Tirana è una città dall'aspetto geo-politico al centro dell'incontro tra l'Albania o le Albanie (considerate in termini propriamente di radicamenti storici) e ciò che resta del sentire spirituale del Regno di Napoli. Davanti ad una tale premessa sorge spontanea una domanda: con quale identità e con quale sentire spirituale gli albanesi presenti in Italia, o gli Italo-albanesi, hanno aderito alla rottura del Regno di Napoli e alla decisione dell'Unità d'Italia secondo il criterio cavouriano, sabauda, nelle mani di Garibaldi? È una domanda che dovrà trovare una risposta, o una riflessione, sia dal punto di vista storico che spirituale. Gli Italo-albanesi che hanno partecipato alle imprese garibaldine, quindi prima del ruolo avuto da Francesco Crispi, erano consapevoli che la spedizione dei cosiddetti Mille puntava a spezzare le radici e il potere regnante di Ferdinando e di Francesco II? Un Regno che li aveva ospitati, anzi un territorio che aveva dato loro asilo e costituzionalità? Erano consapevoli che Cavour e Vittorio Emanuele II avevano bisogno di una tracciata precisa per penetrare nel Mediterraneo e per riagganciare il Regno di Sardegna al mondo balcanico attraverso proprio le sponde adriatiche? Sono interrogativi che hanno un loro senso ben definito oggi, perché anche la storia dell'Albania moderna è inconcepibile senza il legame tra Tirana da una parte, Napoli dall'altra e Roma come punto nevralgico di una storia cattolico-cristiana. Il punto nodale, di cui si discute parlando di Unità d'Italia, non può essere dissolto senza comprendere fino in fondo il ruolo del rapporto tra Napoli, Tirana e il Mediterraneo. Perché la storia risorgimentale circoscritta soltanto alla fase pre, e immediatamente post, 1861 non avrebbe senso se non si collega ad una visione geo-politica tra gli Stati del Nord (i Savoia e i Francesi) e le Nazioni del Mediterraneo, sia nella geografia italiana sia in quella balcanica e nord-africana. Tirana, come centro nevralgico, era la città di una Albania che puntava a non scollegarsi con le capitali del Sud d'Italia: da una parte Napoli e dall'altra Palermo. Grazie comunque al Regno borbonico. La Rivoluzione Napoletana del 1799 vede protagonista, tra gli altri, un Italo-albanese, ovvero Agesilao Milano. Antiborbonico certamente, ma non sappiamo fino a che punto avrebbe potuto accogliere una Unità d'Italia imposta dai Savoia. Il fatto è che la figlia di Agesilao Milano, cerca di vendicare il padre tentando di uccidere Francesco II; ma

Pierfranco Bruni

ka Sullarënx (Cs)

questi, riconoscendola, la invita a fuggire e non denuncia la donna. Anzi la troveremo come una delle confidenti addirittura di Maria Sofia, la consorte di Francesco II. Siamo in un momento cruciale della storia dell'Unità d'Italia, in un Risorgimento che non può essere ridotto soltanto alle spedizioni garibaldine, ma bisognerebbe raccogliere quella lezione spirituale gentiliana che indicava in Mazzini e Gioberti come i profeti del Risorgimento. E questo Risorgimento è un Risorgimento etnico non solo dal punto di vista linguistico e antropologico, ma profondamente radicato nella storia delle contaminazioni e dei rapporti tra Nazioni e civiltà. Credo che gli Italo-albanesi dovrebbero rileggere questa temperie e interrogarsi sul ruolo che l'idea di Patria ha avuto nella loro identità e nella loro coscienza. Perché si continua a parlare di una funzione strategica degli Italo-albanesi ai "moti" garibaldini e non si contestualizzano i legami tra il mondo borbonico e la presenza degli Italo-albanesi nel Regno di Napoli?

Të ngrënat e njëhershëm

(vjen ka faqja 15)

ë të thahij grika e gluha të ngjittj sa ti nëng bē t'folja ndē nëng a lagēja ma një pikë verē si do ishē, adhē ndē ishē "strēnxhētūrē"(turqatē) o akuatē o ca uthullē (spundu), po jo ujētē se ma kētē gluha nëng të sqittij fara! Frutat nëng vijan nga jasht katundit nga vëndā tē huaj e llargu si sod, e, veç ndonjë narēnzē o mandarinē o qitēr, ishēn gjithē tē vëndit: fiq tē thara tē vēnur ndē një "jet" i bēnē ma kelmra tē prera o fiq tē mburnur e tē ndara dishē ma brēnda mendul o arra; nespulit tē mbajtur e tē maturuar ta kashta, vathzit, rrush i thar, bērdiqi i mbajtur brēnda uthullēs sa kur disha tē a hāja kish a laja mirē mirē pē tē i nxirja uthin, arra, mendul, lthi, kēshtenja, ftonjë, shgē, dardha, molla, thane e garrica. Mē sa ndonjë here bëjan ma miallt ghardhini "farnatan" (polenta) ma lēng tē kuq, djathē e lēkēnka (tē bēgatet) o ma lēng tē bardhē vetēm ma kripē , val, ca djathē tē dhēgratuar e ndonjë fritull (tē vepkat).